Rruga Arbërit



www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (68). DHJETOR 2011. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

OPINION

VDEKJET NË BULQIZË:

Krim apo statistikë?

Nga: **ARTAN LAME** - FAQE 5

DEBAT

Fusha e Torviollit apo Fusha e Tri Vjolleve?!

Nga: **AVNI ALCANI** - FAQE 8

REFLEKSIONE

Bekuar qofsh o Naim Plaku...

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 20

BOTIME

"Dëshmia e Gjeneralit"

Nga: **SHPËTIM CAMI** - FAQE 12

Lura, një histori e harruar apo një realitet suksesi

Zhveshja e plotë e Nezhdës dhe e Kunorës, Grifës dhe Pllaut nga mbulesa pyjore jo vetëm nga prerjet, por edhe djegiet masive të përvitshme, pamjet e shëmtuara të shkatërrimit e shkretimit të plotë të pyjeve, duhet të bëjnë me turp tërë ata që janë marrë me administrimin e kësaj pasurie.

Bilanci i shkatërrimit i kalon ato të një katastrofe natyrore. Janë shfarosur përfundimisht drurët dy – treqindvjeçarë të arrnisë së bardhë, me mijëra hektarë pishe, bredh dhe ah. Dëmtimet masive, sidomos rreth liqenit të famshëm të luleve por dhe liqeneve të tjerë i kanë kthyer këta në karrikatura të shëmtuara, në këneta të mbushura me trungje, duke lënë të shokuar me shëmtinë e tyre gjithkënd që i ka vizituar kohët e fundit...

GJASHTË PROPOZIMET PËR RIGJALLËRIMIN E LURËS:

1 - Të ndalohet urgjent shkatërrimi i mëtejshëm i pasurisë pyjore.
2 - Hartimi i një dokumenti për zhvillimin afatshkurtër, afatmesëm dhe strategjik të Lurës
3 - Fillimi i përpjekjeve për ti dhënë zgjidhje problemit të pronësisë.
4 - Ngritja e një forumi virtual dhe të përhershëm komunikimi, ku të sillen ide e të debatohet mbi projekte
5- Nxitja dhe promovimi i turizmit shtëpiak
6- Ngritja e një shkolle profesionale me orientim nga turizmi

Nga: **XHAVIT DEDA**

SPECIALE NË FAQET 2-3



23 vjeçari Lundrim Paçuku, me zërin e tij të mrekullueshëm po korr sukses në spektaklin "Voice of Albania", duke bërë për vete shumë admirues dhe duke bërë krenar vendlindjen e tij. Pacuku deri më tani, me zërin e tij, u ka dhënë shumë emocione dasmorëve, por me pjesëmarrjen në spektaklin e Top Channel ka treguar se me talentin e tij do të jetë në të ardhmen një përfaqësues dhe kultivues i muzikës shqiptare. Ai ka ëndërruar gjithmonë të marrë pjesë në koncerte të ndryshme. "Ëndrra ime më e madhe ishte që të paktën një herë të këndoja me orkestren e Top-Channelit, por që të isha në finalen e "Voice of Albania" nuk e ëndërroja kurrë". Kjo ëndërr e djaloshit dibran është bërë realitet, por me votat tona ai mund të bëhet edhe fitues i këtij spektakli. Prandaj, të gjithë së bashku duhet ta votojmë dhe ta mbështesim ëndrrën e tij!

PORTRET

"Elez Isufi, mor ku je..."

Nga: **NAIM PLAKU**

FAQE 19

KRIJIMTARI

Krushqit e çuditshëm - nga XHAFER MARTINI
Poemë për qytetin tim - nga ISLAM ÇENGA
Elegji për Dibrën - nga MENTOR HOXHA
Pikëtakim "Rruga e Arbërit" - nga DRITE ADEMI
Fabula - nga ILJAZ BOBAJ

SPECIALE NE FAQET 14,15,16,17

BOTIME

Amanetin s'e tret dheu...

Nga: **HAMIT VATA**

FAQE 18

cyan magenta yellow black 1

Bilanci i shkatërrimit i kalon ato të një katastrofe natyrore. Janë shfarosur përfundimisht drurët dy –treqindvjeçarë të arrnisë së bardhë, me mijëra hektarë pishe, bredh dhe ah. Dëmtimet masive, sidomos rreth liqenit të famshëm të luleve por dhe liqeneve të tjerë i kanë kthyer këta në karrikatura të shëmtuara, në këneta të mbushura me trungje, duke lënë të shokuar me shëmtinë e tyre gjithkënd që i ka vizituar kohët e fundit...

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (68). 1 - 31 Dhjetor 2011

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Nikollë Kola, Mevlud Buci, Hajri Mandri, se shkrimet e tyre jane planifikuar për numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Artan LAME
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Hysen LIKDISHA
Shpëtim CAMI
Avni ALCANI
Xhavit DEDA
Xhafer MARTINI
Hamit VATA
Mustafa TOLA
Dita TORTE
Zabit LLESHI
Islam ÇENGA
Mentor HOXHA
Iljaz BOBAJ
Drite ADEMI
Naim PLAKU
Halil ROBI
Rustem DEVA
Dukagjin HATA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Gjashtë propozimet për rigjallërimin e Lurës:

1 - Të ndalohet urgjent shkatërrimi i mëtejshëm i pasurisë pyjore.

2 - Hartimi i një dokumenti për zhvillimin afatshkurtër, afatmesëm dhe strategjik të Lurës

3 - Fillimi i përpjekjeve për ti dhënë zgjidhje problemit të pronësisë.

4 - Ngritja e një forumi virtual dhe të përhershëm komunikimi, ku së sillen ide e të debatohet mbi projekte

5- Nxitja dhe promovimi i turizmit shtëpiak

6- Ngritja e një shkolle profesionale me orientimi nga turizmi





Lura, një histori e

Nga **XHAVIT DEDA**

Lura, një emër i njohur për gjithë shqiptarët por jo vetëm. Është krahina që e përbërë prej 10 fshatrave të vendosura në lartësitë nga 700 -1200m mbi nivelin e detit, me tetë liqenet e saj akullnajore të vendosur në 2000m mbi nivelin e detit, me florë dhe faunë të pasur dhe të rrallë, me ujin e ftohtë të burimeve apo të dy lumenjëve të vegjël malor; Seta dhe Malla, të pasur me troftë, me përrenjtë malor që burojnë nga liqenet dhe zbresin gurgullueshëm në shpatet e pjerrëta të malit Nezhde, me një reliev të jashtëzakonshëm, me pllaja të bukura alpine por dhe me rrëpira të thepisura dhe interesante, është quajtur me të drejtë nga të gjithë perlë e bukurisë shqiptare. Kanë shkruar për të me admirim dhe udhëtar vendas dhe të huaj, të mahnitur nga bukuria e zonës dhe mikpritja, veshja dhe zakonet. E vendosur midis tri krahinave të mëdha Mat, Mirditë dhe Dibër historia e saj ka qenë e lidhur ngushtë me ta, por nga ana tjetër ka prodhuar në vazhdën e shekujve vlera të spikatura traditash e zakonesh, bashkëjetese të shkëlqyer midis besimeve të ndryshme fetare edhe brenda familjes, përfaqesim dinjitoz në evenimente të rëndësishme të historisë kombëtare duke e shëndërruar në njësi unike për nga vlerat etno- kulturore dhe interesante për t'u studiuar dhe promovuar. Është folur shumë për të, është shkruar shumë për të, është kënduar për të. Dëshira e Dom Nikollë Kaçorrit për të hedhur një urë imagjinare, për të lidhur Zvicrën me Lurën apo thënia e Gjergj Fishtës: "Kush se ka parë Lurën nuk ka parë Shqipërinë" janë monumentale. E me të drejtë Hilmi Kolgjegja e krahasonte Lurën si Hirushja e përrallës. Udhëtarja angleze Edhit Durham shkruan me dashamirësi dhe e mahnitur nga bukuria e Lurës dhe mikpritja e vendasve. Studiues të ndryshëm kanë bërë punime të karakterit shkencor apo historik për Lurën. Janë bërë edhe kërkime të pakta arkeologjike por për mendimin tim të pamjaftueshme. Në Guidat turistike që të huajt kanë bërë për Shqipërinë Lura zë një vend të konsiderueshëm. Ka dashamirësi në to dhe grishje për turistët e huaj për ta vizituar atë. Janë bërë kohët e fundit edhe histori fisesh. Por deri më sot për fat të keq nuk ka patur përpjekje të mjatueshme për të prodhuar një libër për Lurën ku të përmblidhen në mënyrë organike të gjitha edhe historia edhe tradita e zakonet. Një libër(më tepër se një guidë turistike) që do t'u vinte në ndihmë jo vetëm brezit të ri të lurianëve por dhe turistëve vendas dhe të huaj të interesuar për të vizituar Lurën dhe për të njohur historinë e saj. Lurianët dhe unë si pjesë e tyre u jemi mirënjohës tërë atyre personave luras apo dashamirë e miq të saj, që kanë dhënë e japin në kohë të ndryshme, kontribute të konsiderueshme për ta paraqitur e promovuar Lurën si një realitet me vlera të jashtëzakonshme jo vetëm mjedisore e gjeografike, apo turistike, por edhe si një realitet unik etno-kulturor, me vlera të spikatura, traditë dhe me trashgimi interesante historike që nga lashtësia e deri më sot. Mund të duket shumë e fryrë, por kam bindjen e plotë se me studime më të thelluara, sidomos të karakterit arkeologjik dhe historik por edhe etimologjik, do të shihet se është thënë shumë pak për të. Njëzet vjet më parë kur sistemi ndryshoi, ne 22 vjeçarët e atëhershëm, (që natyrisht kishim dhe një dozë optimizmi më të tepruar) por dhe të tjerët, kishim të gjithë të drejtën e zotit dhe arsye të mjaftueshme të besonim, se Lura me potencialet e saj turistike (jo pak të promovuara nga regjimi i mëparshëm), në kushtet e iniciativës së lirë private, nxitjes së ivestimeve të kapitaleve të huaja, kujdesit të qeverive që pasuan sistemin komunist, do ta kthente Lurën (brenda një periudhe jo të gjatë), në një burim të ardhurash jo vetëm për komunitetin e Lurës por dhe të fshatrave përreth të Dibrës si dhe të Mirditës. Sot e gjithë ditën kam bindjen e plotë që nuk kishte asnjë arsye që të mos ndodhte kështu. Ajo çfarë ndodhi me Lurën pas 1990 e sidomos pas 1997, është një histori tjetër pastaj, një histori që vazhdon edhe sot. Jo vetëm unë, por çdo i'luras, çdo vizitor shqiptar, apo i huaj do ta quante me te drejtë " Historia e shkatërrimit të Lurës" apo " Lura një katastrofë mjedisore "dhe ata më pesimistët mund ta titullonin, " Lura një shans i humbur jo vetëm për ekonominë lokale por dhe atë kombëtare". E ndoshta edhe më keq historia e saj mund të fillonte me "Na ishte një herë"... Ajo që ndodhi me pasurinë pyjore është një histori më dhe tepër e dhimshme. Ndërmarrja e shfrytëzimit e ndarë tashmë nga ajo pyjore filloi "të punojë për hesap të vet" duke hapur variante për të tërhequr lëndën drusore jo vetëm jashtë parkut kombëtar por m'u në zemër të tij. Më vonë u krijua një tjetër ndërmarrje fantazmë" Ndërmarrja e prodhimeve të dyta"që i dha mundësinë gjithkujt të pajisur me një makinë dhe një motosharrë të futej në park kombëtar të priste lëndë drusore, sidomos drurin e rrallë të arrnisë së bardhë e të mos i hynte gjemb në këmbë. Nuk kam dëshirë të ndalohem në detaje këtu, por ajo që dua të them është se, në periudhën fill pas rënies së komunizmit, organet përgjegjëse për administrimin e pasurisë së Lurës nëpërmjet një sërë vendimesh e praktikash të pamend si: Dhënie leje shfrytëzimi për firma e kompani private për shfrytëzim parcelash në kufijt e Parkut Kombëtar, duke u dhënë mundësinë këtyre "kompanive fantazmë", (i quaj të tilla, sepse kapitali i tyre i vetëm ishte lënda drusore që rritej në pyll), që të shfrytëzonin pikërisht parkun kombëtar madje pjesën më të mirë të tij dhe më të lehtë për tu shfrytëzuar, apo krijimi i Ndërmarrjes së prodhimeve të dyta etj., i hapën derën shkatërrimit të plotë të pasurisë së Lurës. Po kush e çante kokën për Lurën në ato kohë. Nuk merrej kush me pasurinë e të gjithëve, ajo kohë kishte perënduar. Me pasurinë e të gjithëve bëhej politike. Personat përgjegjës për administrimin dhe ruajtjen e pasurisë pyjore ishin militante në radhë të parë, që nuk u interesonte shumë pylli, se kishte për të gjithë, por vota??? Vota për deputetin e Partisë së tij, vota për Kryetarin e komunës të krahut të tij politik. Por duhet t'u japim dhe pak hak. Nëse do të bënin të kundërtën (nuk do të pyesnin për votime e politike), do të humbisnin vendin e punës, ashtu siç ndodh edhe sot e kësaj dite. Gati gjithë kandidatët për deputet që kanë ardhur në Lurë, por dhe deputët e ministra, duke u lexuar lurianëve dëshirën por dhe entuziazmin për të bërë gjëra të mëdha për Lurën si: zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës deri tek liqenet (e nisur që nga Tirana kuptohet), ndërtimin e fshatrave turistik, hoteleve, zhvillimin e turizmit elitar (a nuk e meriton Lura?), ndërtim teleferikësh pse jo ndërtimin e një piste dimërore skish, pikërisht këto gjëra kanë premtuar. Madje kanë shkuar dhe më tej, dukë thënë se projektet janë të gatshme dhe me financime të garantuara. Kaq entuziast janë lurianët në periudha fushatash elektorale për këto tema, sa është e kotë t'u mbushësh mendjen se këto gjëra të mëdha mund edhe të jenë të vështira për t'u bërë në një kohe të shkurtër. Si kandidatët për kryetar komune të të dy krahëve politik, ashtu dhe kandidat për deputet apo deputetët dhe kryetarët e komunës, që në, kohë fushata zgjedhjesh, vendore apo të përgjithshme në mënyrë alternative kanë mbështetur njeri- tjetrin, nuk është se kanë patur apo kanë ndonjë ide serioze për zhvillimin e kësaj treve, përveç atyre ideve "të mëdha", që herë pas here, i kanë skicuar me nxitim në letra xhepi dhe i kanë paraqitur ato si projekte të miratuara dhe me fonde të garantuara, me bazë fantazinë e tyre të nxitur më tepër nga dëshira e mirë për të fituar zgjedhjet me çdo kusht, se sa nga dashja për të bërë ndonjë gjë të mirë për zonën. E thënë më shkoqur, nuk ka patur dhe nuk ka deri më sot një projekt serioz për zhvillimin afat shkurtër apo strategjik të zonës dhe kjo është për të ardhur keq. Është vërtet për të ardhur keq që askush që u mor me administrimin dhe punët e kësaj zone pas 1990, nuk patën mençurinë apo dashjen të kuptonin disa të vërteta të thjeshta: Së pari pavarësisht nga jehona e asaj si perlë turistike shqiptare në kushtet e halleve të mëdhe që kishte shteti shqiptar menjëherë pas rrëzimit të komunizmit, pamundësisë për investime madhore në infrastukturë, nuk kishte si të ishte në qendër të zhvillimit të turizmit. Ata që i llastuan apo akoma llastojnë lurianet me këtë ide absurde, i kanë borxh të madh të ardhmes së saj. Së dyti, ka patur dhe ka ide, për zhvillimin e turizmit kulturor aty. Pse jo. Por hipotezat për Lurën si kryeqendër e Ilirisë së shkretuar, si residencë verore e perandorëve romak apo më vonë si qendër e zhvilluar në periudhën e Bizantit, vendmbrojtjeje në periudhën e Skënderbeut, bazuar në kërkime sipërfaqësore të karakterit arkeologjik apo gjuhësor, kërkojnë studime të thelluara, ekspedita arkeologjike të gjata, të mirë organizuara e të mirë financuara si dhe kohë. As njërën prej tyre, nuk kishim dhe nuk kemi komoditetin për t'i patur. Së treti, pasuria pyjore e Lurës, me shumë llojshmërinë e drurëve qindravjeçare (ahun, pishen, bredhin, e sidomos arrninë e bardhë), kjo shtëpi e kafshëve të shumta të egra, sidomos të ariut të murrmë, kullotat e mrekullueshme alpine, me lule që në pranverë të dehin me bukurinë dhe aromën e tyre, burimet natyrore me ujë të ftohtë bashkë me ujrat kristal të dy lumenjëve të vegjël malor Setës dhe Mallës, të pasur me peshq sidomos me troftë, malet e thepisura dhe kanionet e thella gëlqerore(që të ftojnë për aventurë), të Gur-Lurës, bashkë me të famshmit, 8 liqenet karstike të pashoq për nga bukuria e tyre, këto janë elementet që e bëjnë Lurën perlë. Ky është magneti që ka tërhequr e tërheq turistët, (vendas apo të huaj). Kjo është pasuria e vërtetë e saj. Hiqi një nga elementet e mësipërm Lurës dhe sidomos pasurinë e saj pyjore që kërkon dhjetra apo qindra vjet që të rigjenerohet dhe Lura nuk mbetet më asgjë. E ardhmja e saj vihet në diskutim. Nuk janë pasuritë nëntokësore, për të cilat para viteve '90 bëheshin kërkime me sonda e galeri e tashmë bëhen gropa me ekskavator për të zhvatur ndopak krom, aty-ketu. Nuk është as bujqësia apo blegtoria, për faktin e thjeshtë se toka e punueshme është e pakët, në terren të thyer dhe joproduktive dhe dimri është i gjatë duke pamundësuar mbajtjen e një numri të konsiderueshëm të gjësë së gjallë. Edhe pasuria hidrike e lumenjëve apo përrenjëve malor, që po përdoret ko-

Zhveshja e plotë e Nezhdës dhe e Kunorës, Grifës dhe Pllaut nga mbulesa pyjore jo vetëm nga prerjet, por edhe djegiet masive të përvitshme, pamjet e shëmtuara të shkatërrimit e shkretimit të plotë të pyjeve, duhet të bëjnë me turp tërë ata që janë marrë me administrimin e kësaj pasurie.







harruar apo një realitet suksesi

hët e fundit për ndërtim hidrocentralesh me koncension (dhe që është gjë pozitive dhe një e ardhur e konsiderueshme për ekonominë kombëtare), me punësimin për një periudhë të shkurtër (gjatë ndërtimit të tyre), apo zënien me punë të vazhdueshme të 7-8 vetave, nuk garanton të ardhmen e Lurës. Pra askush nuk pati mençurinë apo dashjen për t'u marrë me atë, që ishte e mundur për t'u bërë por dhe jetike për të ardhmen e Lurës, ruajtjen me çdo kusht të pasurisë pyjore, në pritje të ditëve më të mira, të investimeve lumë të ndërtimit të fshatrave turistike, hoteleve pistave dimërore të skive, zgjerimit dhe asfaltimit te rrugëve lidhëse të nisura nga Tirana apo Peshkopia (për të cilat është folur e po flitet, po me sa duket do të mbeten thjesht projekte të shkruara bukur e të thëna e stërthëna me pasion edhe për një kohë të gjatë). Edhe nëse rruga e asfaltuar do të shkojë tek të gjitha liqenet, edhe sikur të gjenden kompani ambicioze dhe të gatshme për të investuar, është vështirë të realizohet gjë, për shkak të problemeve akoma të pazgjidhura të pronësisë, sidomos në zonën e parkut kombëtar, (pronësisë mbi livadhet dhe kullotat, zabelet). Problemi i pronësisë në këtë zonë është i ndërikuar jo se ka përplasje mes individësh, por mes shtetit dhe individit, sepse gjitha çështjet e pronësisë para 1945 janë zgjidhur mbi bazën e të drejtës zakonore. Pra, ka mungesë dokumentacioni ligjor, por nga ana tjetër, askush nuk heq dorë nga një pronë që e ka blerë, trashëguar, shfrytëzuar për shekuj, bazuar në të drejtën zakonore e cila nuk ka vlerë në kushtet e sotme. Është problem që do të dalë që në investimin e parë dhe është provuar në investimin e një rruge të brendshme që mbeti për gati dy vjet e bllokuar, në radhë te pare nga fakti se nga organet pergjegjese ishte injoruar si problem. Këtij problemi do t'i kthehem më poshtë në këtë shkrim. Sidomos pas vitit 1997, në kushtet e rënies së plotë të shtetit, intensiteti i shkateërrimit të pyjeve ishte i jashtëzakonshëm. Disa përpjekje për ta shpëtuar këtë pasuri duke u mbështetur në të drejtën zakonore qenë të pasuksesshme. Midis "vezës sot a pulës mot"banorët vendës zgjodhën "vezën sot". Kjo, jo vetëm prej halleve të shumta ekonomike, por edhe sepse nuk shihnin asnjë dritë në fund të tunelit, veç premtimeve boshe që filloi shpejt t'u dalë boja. Mungesa e interesit të shtetit, investimeve, perspektivës, çoi në demoralizimin e vendasve, të cilët filluan ta shihnin pasurinë pyjore jo si mjet për të garantuar të ardhmen e kësaj zonë , por si burim i shpejtë financiar për bërë të mundur largimin sa më parë nga ky vend pa të ardhme. Largimi i lurasve nga vendbanimet e tyre, më i madhi i 100 viteve të fundit, bëri më në fund, që pasuria e tyre të mbetet mall pa zot dhe të shkatërrohet plotësisht. Bilanci i shkatërrimit i kalon ato të një katastrofe natyrore. Janë shfarosur përfundimisht drurët dy –treqindvjeçarë të arrnisë së bardhë, me mijëra hektarë pishe, bredh dhe ah. Dëmtimet masive, sidomos rreth liqenit të famshëm të luleve por dhe liqeneve të tjerë i kanë kthyer këta në karrikatura të shëmtuara, në këneta të mbushura me trungje, duke lënë të shokuar me shëmtinë e tyre gjithkënd që i ka vizituar kohët e fundit, por që nuk do të kishte dëshirë të shkonte më. Zhveshja e plotë e Nezhdës dhe e Kunorës, Grifës dhe Pllaut nga mbulesa pyjore jo vetëm nga prerjet, por edhe djegiet masive të përvitshme, (Të cilat kanë çuar edhe në shfarosjen e kafshëve të egra, që s' kanë ku të fusin kokën me), pamjet e shëmtuara të shkatërrimit e shkretimit të plotë të pyjeve, të cilat të dalin parasysh sapo të futesh në Lurë e sidomos kur rrugëton për tek liqenet, duhet të bëjnë me turp tërë ata që janë marrë me administrimin e kësaj pasurie. Deputetët apo administratorët lokal, që u kanë kërkuar vota këtyre njerëzve duhet të ndihen keq. Gjithëkush i luras që ka vënë dorë apo ka marrë pjesë në këtë maskaradë, duhet të ndihet me faj. Edhe ata luras që kanë heshtur para këtij shkatërrimi përfshi edhe mua, duhet të ndihen me faj. Në mënyrë propocionale, sejcili ka pjesën e tij të fajit. Është jo vetëm mendimi im, por sidomos i vizitorëve të huaj dhe vendas, që grishja e turistëve për të vizituar Lurën në këtë gjendje dhe sidomos dërgimi i tyre të liqenet, (që janë larg të qenit të mrekullueshëm dhe më afër të qënit pellgje moçalore pa shije dhe pavlerë), është antireklama më e mirë që mund t'i bëjmë të ardhmes së turizmit atje. Unë i mirëkuptoj tërë ata që hedhin pamje mahnitëse të Lurës në internet, madje edhe zemëratën e atyre që nuk janë dakord me pamjen realiste (në dukje pesimiste), që sjell ky shkrim për Lurën. Por më duhet t'ju them diçka: Vetëkënaqësia nuk i bën mirë askujt, as krenaria e tepruar. Duhet t'i themi gjërat ashtu siç janë, që të mundemi të përmirësojmë diçka. Ndërkohë që unë shkruaj motosharrat punojnë në Lurë, shkatërrimi vazhdon. E nëse nuk ndalon, shpejt do ta shohim Lurën të braktisur, si Kurbneshi , Kami i Tropojës, apo qyteza të tjera, të cilat, sapo i la ajo pasuri mbi bazën e të cilës qenë ngritur, falimentuan dhe u braktisën plotësisht. Ky është reliteti, pjesa tjetër është ëndërr pastaj. Nuk e meriton Lura këtë. Nuk është vetëm vlera financiare që i kalon miliona dollarët e që nuk kthehen më, por dëmtimi i të ardhmes turistike të Lurës që mund të shtyhet edhe për 20 vjet të tjera në kohë. Natyrisht është koha për të reflektuar, por, me qarje, muhabete kafenesh ose fantazi të pabaza nuk zgjidhen problemet e saj. Përtej këtij realiteti të zymtë unë besoj, se ekzistojnë akoma mundësitë që Lura , në një të ardhme të afërt, të zhvillohet ashtu si zona të tjera malore të vendit, me të njëjtën problematike dhe drejtim zhvillimi (Turizmin) e ndoshta edhe më mirë. Ose më saktë e dëshiroj këtë. Ato që unë kam mendimin mund të bëhen e mund të ndihmojnë në zhvillimin e kësaj zone po i radhis më poshtë:

Së pari duhet të ndalohet urgjent shkatërrimi i mëtejshëm i pasurisë pyjore. Është jashtë çdo lloj logjike që të kërkosh fonde për të mbjellë fidane pishe apo arrnie dhe makina të ngarkuara me pisha të reja të sapo prera të lëvizin papushim në drejtim të Tiranës apo qyteteve të tjera. Një tabelë për mbjellje arrnie më ka rënë në sy në qendër të Lurës, që ka qëndruar aty për vite të tera. Në mos gabofsha jepte vlerën e fondit dhe numrin e fidaneve të mbjellë. Çuditërisht asnjë banor nuk ishte në gjendje të tregonte, se kur dhe ku janë mbjellë këto fidane. Një moratorium për ndalimin e shfrytëzimit të çdo lloj lëndë drusore është i domosdoshëm. Për këtë duhet së pari vullneti i mirë dhe bindja e plotë që kjo duhet dhe mund të bëhet. Të hiqet dorë nga të bërit politikë e grumbullim votash me grisje procesverbalesh, proçedime për ato që s'janë me mua, apo presionet për largime nga puna nëse nget dëmtuesit në periudha fushatash elektorale. Dëmtuesi është dëmtues. Duhet të ndëshkohet se s'bën. Lura është shkatërruar kaq shumë sa që nuk mund të vazhdojë me tej. Nuk mund të këtë fillese ndryshimi nëse nuk ndalon shkatërrimi i mëtejshëm i saj. Kjo mund të shoqërohet me një memorandum mirëkuptimi midis gjithë organeve të zbatimit të ligjit, dhe palëve të interesuara, midis Komunës, Policisë pyjore, Policisë së Rendit, Prokurorisë, Gjykatës etj. , me persona të ngarkuar për të ruajtur kontakte të vazhdueshme për të bërë të mundur zbatueshmërinë korrekte të ligjit. Kjo fillon që me policin pyjor, procedimi i të cilit për dëmin e shkaktuar duhet të jetë ligjor, i argumentuar dhe i dokumentuar, me dëshmitar dhe pamje filmike. Kjo është plotësisht e mundur, dhe do të krijonte mundësinë, që procedimet e bëra të ekzekutohen në mënyrë korrekte në të gjitha hallkat e zbatueshmërisë së ligjit. Nuk do shume mend për të kuptuar se pa ndëshkim nuk mund të vendoset rregull, por askush nuk mund të ndëshkohet me procedura të paligjshme, me procesverbale paçavure dhe të paargumentuara ligjërisht, duke u lënë shteg pastaj, pse jo, edhe interpretimeve apo vendimeve korruptive, e duke dalë i palagur dëmtuesi. Një fushatë intensive paraprake informuese për banorët dhe jo vetëm, do të ishte e domosdoshme dhe jo e kushtueshme.

Së dyti, një dokument për zhvillimin afatshkurtër, afatmesëm dhe strategjik të Lurës është i domosdoshëm. Ky dokument me prioritetet bazë, me plane e programe të detajuara, me objektiva të përcaktura qartë, do t'i jepte jo vetëm Kryetarit në detyrë të Komunës, por dhe atyre që do të vijnë më vonë, mundësinë për t'i parë gjërat më shkoqur dhe do të krijonte mundësi për ta integruar këtë në rrjedhën e zhvillimeve kombëtare, rajonale dhe evropiane të turizmit malor. Kjo është një punë madhore, por jo e pamundur. Një konferencë e përgatitur me shumë kujdes mund t'i paraprinte dhe ndihmonte shumë në realizimin e këtij projekti. Nuk e kam fjalën për konferencë të tipit "Show", që fillon me fjalime servile për partinë dhe udhëheqësin e lavdishëm, për të mirat që i janë bërë zonës me shkolla, spital, shëtitore, e që përfundon në dehje me raki thane e ngrënje me koka deshësh të pjekur e mish në hell. Kjo nuk ka ndihmuar e nuk ndihmon gjë. E kam fjalën për organizimin e një konference serioze, që të shërbejë jo vetëm si forum për të thënë fjalën e tij për zhvillimin e Lurës, gjithkush ka diçka për të thënë, (duke përfshirë edhe shoqatat për Lurën që janë numëroze, por përtej regjistrimit në gjykatë nuk kanë zhvilluar ndonjë aktivitet në dobi të saj), por sidomos për të vjelë e shënuar ide e praktika nga ekspert vendas e të huaj për problemet e zhvillimit të turizmit malor, ekspert të mjedisit dhe të pyjeve, për të gjetur rrugët e ruajtjes dhe shtimit të pasurisë pyjore. Kryekomunar komunash të vendit, rajonit apo Evropës, më problematike apo drejtim zhvillimi të përafërt apo të ngjashme , të ftuar aty, me referatet e tyre mund të jenë një burim i jashtëzakonshëm idesh dhe ndihmë e çmuar, gjithashtu. Organizimi i kësaj konference mund të shërbente si rast shumë i mirë për Komunën e Lurës për të promovuar me një panair, edhe ushqimin tradicional me bazë bio, edhe veshjet karakteristike, edhe folklorin. Do të ishte një rast i mirë për ti njohur ato me historinë e saj, ndërtimet interesante të shtëpive të banimit, me gurë dhe dru (disa prej të cilave i kalojnë 200 vitet, janë akoma të banueshme dhe u ngjajnë fortesave), bukurinë e saj, problematikat e saj etj.

Së treti, Fillimi i përpjekjeve për ti dhënë zgjidhje problemit të pronësisë, duke e konsideruar atë si problem serioz dhe bazë për zhvillimin e saj. Kjo mund të fillonte me një fushatë informuese e nxitëse, por dhe ndihmë për banorët vendas për kryer regjistrimin hipotekor të pasurive, ara, pyje, kullota, zabele, për të cilat ka bazë ligjore për regjistrimin e tyre. Tjetër, duhet të fillojnë përpjekjet ligjore për zgjidhjen e problemit të pronësisë private mbi livadhet e kullotat në zonën e shpallur Park Kombëtar. Edhe për një pjesë të kullotave, zabeleve, tokave joproduktive, të cilat, në të drejtën zakonore janë quajtur " kojri", ose prona të përbashkëta fisesh, që janë shfrytëzuar në shekuj, duhet gjetur zgjidhja ligjore për t'jua kthyer banorëve dhe puna duhet të nisë që tani, madje është shumë vonë. Do të jenë pikërisht banorët, që me të drejtën historike, janë pronarët faktik të këtyre pronave, që do të bëhen pengestare në realizim projektesh te ndryshme. E thënë me shkurt, koncepti i të drejtës historike mbi pronësinë duhet të jetë baza për zgjidhjen e këtij problemi hap pas hapi dhe sipas rastit. Injorimi i këtij problem sot, do t'i kushtoje shumë kësaj zone nesër.

Se katërti, Ngritja e një forumi virtual dhe të përhershëm komunikimi, me tërë të interesuarit ku të jepen ide, të merren ide, të pranohen e të shënohen kritika, komente e vërejtje, të prezantohen projekte, të publikohen realizime, vendime, apo udhëzime të qeverisë lokale e qendrore është i domosdoshëm. E kush më mirë do ta bënte këtë se Faqja Zyrtare e internetit e Komunës. Nuk kushton shumë për ta bërë apo për ta mbajtur dhe është një burim dhe urë e jashtëzakonshme komunikimi të vazhdueshëm, jo vetëm me banor dhe të interesuar, por edhe me investitor potencial, ekspert, komuna simotra të vendit dhe të huaja. Nëse punohet me kujdes e trajtohet me seriozitet, është një medium i pakrahasueshëm për nga fuqia e shpejtësia e komunikimit me mediumet e tjera.

Së pesti, Nxitja dhe promovimi i turizmit shtëpiak apo i llojit " Farm house"duhet të bëhet sa më shpejt. Investimet në këtë lloj turizmi janë të mundshme dhe të ardhurat prej tij të konsiderueshme. Gati shumicave e shtëpive të tanishme që ndodhen në Lurë, mund të bëhen të gatshme me pak investime për të pritur turist vendas e të huaj për pak ditë. Promovimi i tij, sidomos në ditët e dy festave të krahinës, Shën kollit dhe Shën Marisë, do të ishte një mundësi për bizneset aty, por dhe banorët e tjerë, për të prezantuar ushqimin tradicional bio, veshjet, folklorin e pasur etj.

Së fundi, por jo e fundit për nga rëndësia, jo mbyllja e shkollës së mesme, por insistimi për ta orientuar atë si shkollë turizmi, investimi në arsimin 9-vjeçar për t'i rikthyer atij cilësinë që meriton, është zgjidhja që në terma afatmesëm dhe afatgjatë do të siguronte personelin e domosdoshëm, të kualifikuar, për të drejtuar e punuar në këtë sektor. Pa hequr dorë nga e drejta, për të ëndërruar, projektuar apo përpjekja për të bërë realitet gjëra të mëdha, kujdesi për të filluar ndryshimin nga gjera në dukje të vogla, por të prekshme dhe të mundshme, do t'i rikthente gjithkujt (veçanërisht banorëve, por dhe miqve e dashamirëve të saj) shpresën, se Lura (kjo perlë që është shkatërruar dhe po shkatërrohet dita - ditës nga dora jonë), nuk do të shndërrohet në një histori të harruar, por në një realitet suksesi dhe zhvillimi.

"METE nuk lejon 75 minatorë të ACR-së të punojnë për mosplotësim të kushteve të sigurisë në punë dhe nga ana tjetër lejon dhjetëra firma private të shfrytëzojnë galeritë në atë zonë. Kjo na ka detyruar të konsiderojmë qëndrimin tonë sindikalist për rinisjen e një greve të dytë..."

Vdes minatori

Bajram Dalipi, 43 vjeç, nga fshati Fushë-Bulqizë, babai i katër fëmijëve ishte minatori i radhës që ndërroi jetë në galeritë e Bulqizës. Institucionet shtetërore rinisin kontrollet. Sindikatat paralajmërojnë nisjen e grevës. Partia Socialiste akuzon Ministrinë.



VDEKJA E MINATORIT NË GALERITË E MINIERËS, SHOQËROHEN KATËR PERSONA

Një tjetër aksident i paralajmëruar ka ndodhur në njërën prej galerive private të së ashtuquajturës Zona D e minierës. Burime nga vendi i ngjarjes bëjnë të ditur se minatori Bajram Dalipi, 43 vjeç, ka gjetur vdekjen teksa ka mbetur i bllokuar 1000 metra në thellësi të një galerie private, e cila nuk administrohej nga kompania koncesionare ACR. Burimet policore konfirmojnë se gjatë punës në galerinë nr. 58 të Zonës D, ka humbur jetën minatori Bajram Dalipi, 43 vjeç, nga fshati Fushë-Bulqizë, babai i katër fëmijëve. Mësohet se ngjarja e rëndë ka ndodhur teksa viktima po punonte i vetëm në thellësinë 1000 metra. Ai ka qenë duke punuar me një levë, kur është shembur tavani i galerisë dhe një masiv i madh gurësh e kanë zënë poshtë. Shokët e tij të punës dhe ata të avaro-shpëtimit janë përpjekur t'i japin ndihmën e parë, por me gjithë përpjekjet e tyre nuk është bërë e mundur që minatori të shpëtojë. Trupi i pajetë i 43-vjeçarit Bajram Dalipi është nxjerrë pas dy orësh nga galeria. Mësohet se ai punonte si minator, të paktën prej 15 vitesh.

Ndërkohë, policia dhe prokuroria e rrethit ka ngritur menjëherë një grup pune për zbardhjen e aksidentit që i mori jetën babait të katër fëmijëve. Mësohet se janë shoqëruar për të dhënë sqarime për ngjarjen, pronari i galerisë private, Rasim Dedja, drejtuesi teknik dhe dy inxhinierë. Ende nuk ka një variant zyrtar të ngjarjes, nëse bëhet fjalë për një gabim njerëzor nga ana e viktimës apo kanë munguar kushtet e sigurisë teknike.

SIGURIA

Miniera e Bulqizës është kthyer në një "grackë" për jetët e minatorëve, të cilët, të detyruar nga kushtet e vështira ekonomike, punojnë jashtë kushteve të sigurisë teknike. Vetëm në harkun kohor të dy muajve, në këtë minierë kanë ndodhur tre aksidente të rënda me pasojë vdekjen e tre minatorëve dhe plagosjen e tetë të tjerëve. Kujtojmë se në datën 18 tetor, nga shpërthimi i gazit të hidrogjenit në nivelin e 16-të të minierës që administrohet nga kompania ACR, humbi jetën minatori Naim Shyti dhe u plagosën tetë të tjerë, tre prej të cilëve në gjendje të rëndë. Pa kaluar as një muaj, në datën 11 nëntor, në brendësi të galerisë private nr. 66, të Zonës D, gjeti vdekjen minatori Fetah Shehu. Minatori 56-vjeçar ishte i shkëputur nga shokët e tij që punonin në të njëjtin front, kur një masiv i madh dheu është shembur nga tavani i galerisë, duke e shtypur poshtë pa i dhënë asnjë shans shpëtimi. Ndërkohë, dje 43-vjeçari Bajram Dalipi humbi jetën teksa punonte në një galeri private, e cila ka qenë e licencuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kjo e fundit nisi një inspektim në të ashtuquajturën Zona D, pas aksidentit të ndodhur në 18 tetor. Pas kontrollit të ushtruar nga specialistët e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), u vendos marrja e masave administrative për 64 shoqëri private që veprojnë në minierën e Bulqizës, pasi nuk kishin paraqitur planin vjetor të punës si dhe informacionin vjetor financiar.

PUNOHET PA RREGULL TË SIGURIMIT TEKNIK, NUK ZBATOHET AKTMARRËVESHJA MES PALËVE

Pezullohet puna në Zonën D të minierës së njohur për shkallën e lartë të rrezikshmërisë. Aksidenti i ditës së shtunë, i ndodhur në minierën e Bulqizës, ku gjatë punës në një galeri private në të ashtuquajturën Zona D, e cilësuar si e pasigurt nga specialistët e RISHM-it, humbi jetën minatori Bajram Dalipi, 43 vjeç, ka detyruar METE-n të pezullojë punën në të gjitha galeritë ku nuk janë kryer investime dhe punohet pa respektuar rregullat e sigurimit teknik. Këtë e konfirmoi për "Shqip" kryesindikalisti Taf Koleci, sipas të cilit në të ashtuquajturën Zona D punohet pa rregull të sigurimit teknik në punë për minatorët dhe investimeve sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar mes qeverisë shqiptare dhe firmave private të nxjerrjes së mineralit të kromit. Si gjithmonë për aksidentet me humbje jete në minierën e Bulqizës edhe për aksidentin e fundit të ditës së shtunë, ku nga shembja e galerisë 58 në Zonën D të minierës humbi jetën 43-vjeçari Bajram Dalipi, nuk ka asnjë të ndaluar, pasi tradicionalisht "fajet" i merr viktima.

RREZIKU

Në të ashtuquajturën Zona D e minierës, e cilësuar si tejet e pasigurt për punë, nga METE dhe strukturat e saj të specializuara RISHM-i e AKBN-ja, u dha urdhri për pezullimin e punës për kompaninë koncesionare ACR, por jo për kompanitë e vogla private të kësaj zone në njërën prej të cilave ndodhi edhe aksidenti i ditës së shtunë të javës së kaluar, ku humbi jetën minatori Bajram Dalipi, 43 vjeç. Sipas kryesindikalistit Koleci, firmat e shumta private që veprojnë në zonën e shumëpërfolur D të minierës, operojnë brenda territorit të ACR-së. Në lidhje me këtë problem, kryesindikalisti Koleci deklaron se është biseduar me ministrin e METE-s, Nasip Naço, që së shpejti të pezullohet puna për firmat që nuk kanë kryer investime për të operuar brenda territorit që ata disponojnë. Kjo, sipas lejes së dhënë nga ana e METE-s.

REAGIMI

Partia Socialiste rikthen në vëmendje të publikut situatën e vështirë në minierën e Bulqizës. Përmes një letre, një grup deputetësh të saj, teksa kanë parashtruar kushtet e vështira, i kërkojnë ministrit të Ekonomisë, Telekomunikacionit dhe Energjetikës, Nasip Naço, informacion të detajuar mbi gjendjen aktuale në minierë. "Sa janë minatorët që kanë humbur jetën në galeritë e minierave nga viti 2000 deri sot? Cila është pozita ligjore e kompanisë ACR në raport me shtetin shqiptar? Cili është kontraktori i vërtetë? Vazhdon "Darfo" me nënkontraktor ACR apo është ACR që zëvendëson "Darfo" me ndryshim emri? "Darfo SRL" dhe "Darfo SPA" janë e njëjta kompani apo dy të ndryshme? Sa është prodhimi i mineralit të kromit në minierën e Bulqizës?", pyesin në letrën e tyre deputetët socialistë. Përveç përmbajtjes me natyrë disi hetimore për nga theksi i pyetjeve, deputetët opozitarë kanë parashtruar edhe një kërkesë që lidhet me zbatimin e ligjit dhe kontratave ekzistuese. "Bazuar në marrëveshjen koncesionare të miratuar në Parlament 10 vite më parë, sa është totali i investimeve të realizuara nga koncesionari për secilin nga zërat e marrëveshjes? METE, dhe ju si ministër i METE-s, i njihni vlerë ligjore dhe detyruese marrëveshjes së nënshkruar më 9 korrik 2009 ndërmjet ministrit Ruli dhe ACR-së, marrëveshje që modifikonte marrëdhënien koncesionare, por që ende sot e kësaj dite nuk është miratuar në Parlament, siç e kërkon ligji?", vijon letra që nuk mungon të përmendë sërish ministrin aktual të Bujqësisë, Genc Ruli. Për të mbetur sërish këtu, duket se një hetim parlamentar është në horizont, meqenëse për marrëveshjen në fuqi, socialistët shtrojnë edhe pyetjen për bazën kushtetuese. "Cili është arsyetimi institucional bazuar në Kushtetutën e RSH dhe legjislacionin në fuqi, sipas të cilit kjo marrëveshje, edhe pse e pa miratuar në Parlament, ka fuqi ligjore?", thuhet në letër, e cila i kërkon ministrit Naço edhe dokumentacionin përkatës që disponohet nga ministria që ai drejton.

AKUZA METE-S: LEJON PUNËN PËR FIRMAT E VOGLA, BLLOKON ACR-NË

Sindikata e Minatorëve të Bulqizës kanë paralajmëruar se do të iniciohet një tjetër grevë e përgjithshme, e cila pritet të ketë të njëjtat përmasa si e para.

Kreu i Konfederatës së Sindikatave të Industrisë së Shqipërisë, Taf Koleci ka deklaruar për "Shqip" se, situata e krijuar në minierën e Bulqizës, ku vetëm në më pak se dy muaj janë shënuar tre aksidente të rënda me humbje të jetëve të tre minatorëve dhe plagosjen e tetë të tjerëve, lë të kuptosh se zgjidhja përfundimtare për kushte të sigurta pune që kërkuan minatorët në grevën e tyre tremujore mbetet më larg se kurrë, ndërkohë që rreziku për humbjen e jetës së minatorëve është më afër se kurrë më parë.

Sipas Taf Kolecit, mbetet shqetësues fakti që në të ashtuquajturën Zona D punohet pa respektuar rregullat e sigurimit teknik dhe nuk janë kryer investimet sipas akt-marrëveshjes së nënshkruar mes qeverisë shqiptare dhe firmave private të nxjerrjes së mineralit të kromit.

Mungesa e sigurisë në punë në pjesën jugore të minierës, e njohur ndryshe si zona D, është pranuar edhe nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE). Pas aksidentit të rëndë të regjistruar në datën 18 tetor 2011, ku në nivelin 16 minierës, nga shpërthimi i hidrogjenit një minator humbi jetën dhe tetë të tjerë u plagosën rëndë, METE urdhëroi ndërprerjen e punës në galeritë që menaxhoheshin nga kompania ACR, derisa të plotësoheshin kushtet e sigurisë teknike.

Ndërkohë, dy ditë më parë, METE urdhëroi pezullimin e punës në të gjitha galeritë ku nuk janë kryer investime dhe punohet pa respektuar rregullat e sigurimit teknik. Urdhri më i fundit i METE-s erdhi pas aksidentimit për vdekje të minatorit 43-vjeçar Bajram Dalipi, në njërën prej galerive private të kësaj zone. Minatori humbi jetën duke punuar rreth 1000 metra në thellësi të tokës. Tavani i galerisë u shemb dhe 43-vjeçari u bllokua nga një masiv gurësh, duke gjetur vdekjen brenda pak minutash.

Por sipas kryesindikalistit Koleci, METE mban dy qëndrime të ndryshme për Zonën D. Megjithëse dy ditë më parë Koleci deklaroi për "Shqip" se është biseduar me ministrin Nasip Naço, që së shpejti të pezullohet puna për firmat që nuk kanë kryer investime sipas lejes së dhënë nga ana e METE-s, dje ai ka folur me tone të ashpra dhe ka paralajmëruar protesta të reja.

"METE nuk lejon 75 minatorë të ACR-së të punojnë për mosplotësim të kushteve të sigurisë në punë dhe nga ana tjetër lejon dhjetëra firma private të shfrytëzojnë galeritë në atë zonë. Kjo na ka detyruar të konsiderojmë qëndrimin tonë sindikalist për rinisjen e një greve të dytë dhe së shpejti do ta bëjmë publik qëndrimin tonë", - është shprehur kryesindikalisti Koleci. Ndërkohë, ai ka theksuar se do të kërkohet me insistim pranë METE-s që puna në minierë të rinisë në të gjitha frontet ku operon ACR-ja, pra edhe në Zonën D, që 75 minatorët të mos diferencohen nga minatorët e firmave të vogla private të Zonës D.

Bashkia, dhurata për 60 fëmijë jetimë

Bashkia e Bulqizës, me rastin e festave të fundvitit, shpërndau dhurata për 60 fëmijë jetimë. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast ka marrë pjesë kryetari i bashkisë, Roland Keta, i cili uroi fëmijët jetimë dhe familjet e tyre për një vit të mbarë. "Bashkia Bulqizë nuk mund ta prishte traditën e festimit me ju, por gjeti mundësi në bashkëpunim me biznesmenët e qytetit, të cilët gjej rastin t'i falënderoj, që t'ju gjendet pranë", - tha Keta. Shumica e vogëlushëve jetimë të këtij qyteti janë fëmijët e minatorëve që ndër vite kanë humbur jetën gjatë punës në galeritë e thella të nëntokës, në minierën e Bulqizës. 60 fëmijët jetimë të këtij qyteti, që kaluan momente vërtet të këndshme në këtë ceremoni të organizuar enkas për ta, falënderuan bashkinë dhe kryetarin e saj, që në çdo fundviti kujtohet të festojë me ta.

opinion



Krim apo statistikë?

Nga: **ARTAN LAME**

Para tri ditësh, një grup deputetësh të Partisë Socialiste i nisën një letër ministrit të Minierave Nasip Naço ku i kërkojnë llogari për situatën në minierat e Veriut dhe, ndër të tjera, bënin edhe dy krahasime të situatës në to

I pari ishte ku e krahasonin punën në këto miniera me punën e skllevërve të dikurshëm. Me gjithë qëllimin e mirë, detyrohem të them se ia kanë futur kot!

Po t'u hysh ligjeve të Romës së lashtë, do shohësh se ato e ndalonin futjen e grave në miniera; ligjet romake parashikonin që në rast fatkeqësie, pronari i minierës ishte i detyruar të mjekonte të plagosurit dhe të mbante me bukë të gjymtuarit (këtë romakët e bënin me qëllim që skllevërit të pranonin të punonin edhe në rrezik, duke u siguruar që në rast aksidenti nuk do të brak-tiseshin). Në ato ligje, për të nxitur skllevërit që të punonin, u premtohej atyre çlirimi nga skllavëria pas një numri vjetësh pune. Këta ishin Romakët. 1800 vjet më parë.

Shkoni të shihni atë që ndodh në Bulqizë, në Krastë a në Klos dhe do të bindeni se shteti shqiptar i mijëvjeçarit të tretë, është dy mijëvjeçarë prapa zhvillimit të Perandorisë Romake. Nëpër vrimat e minierave tona gjen fëmijë 10-12 vjeç, që zvarriten nëpër galeri pa asnjë mbrojtje personale, pa e patur idenë se ku po hyjnë dhe se ç'i pret aty. Gjen gra që hyjnë bashkë me fëmijët e tyre për të mbledhur copra minerali. Gjen burra që thërmojnë shkëmbinj që u varen sipër kokës, duke shpresuar se kur shkëmbi të shembet, të kenë ato dy a tri sekonda kohë që t'ia mbathin përpara pirgut që u shembet nga sipër.

Është gjë e thënë që në këtë vënd çdo gjë funksionon së prapi. Natyrisht që së prapi do funksionojë edhe puna në galeritë e braktisura të minierave që në vitet '90. Nëse gjatë ndërtimit, galeritë janë hapur dhe hap pas hapi janë vënë armaturat prej betoni, tani bëhet procesi i kundërt. Shkohet në fund të galerisë dhe hiqen pjesë-pjesë armaturat. Kështu shembet një copë galerie dhe minerali mblidhet. Pastaj vihet disa metra të tjera së prapi dhe hiqen ca armatura të tjera, e kështu derisa arrihet në hyrje të galerisë. Nuk ka gjë më të rrezikshme në botë, sesa një galeri që nuk mirëmbahet. Mendoni pastaj, galeri të braktisura prej shumë vjetësh. Mendoni pastaj, t'u heqësh armaturën që u ka mbetur dhe t'u provokosh shembjen. Mendo pastaj, të hysh atje, pa asnjë përgatitje e mjet dhe babë e bir. Duhet të jesh në shkallinën e fundit të mizerjes dhe fukarallëkut, që ta bësh një gjë të tillë. Skllevërit e Romës nuk e bënin një gjë të tillë, se askush nuk qe në gjendje t'i detyronte. Skllevërit e kohëve moderne e bëjnë.

Në kohë të vet, me një dekret që ka mbërritur deri në ditët tona, perandori Trajan, urdhëron shpërngulјen e disa minatorëve të fisit ilir të pirustëve dhe vendosjen e tyre në Transilvani, për të punuar në minierat e atjeshme, meqenëse ata ishin minatorë me përvojë. Trajani romak bëhej merak për minierat e Transilvanisë dhe çonte atje pirustë, për të shmangur aksidentet me njerëz të paditur. Shteti i sotëm i shqiptarëve, i zënë me integrimin dhe asocimin, nuk ia ka ngenë të merret me stërnipërit e sotmë të pirustëve.

Krahasimi i dytë që bëhej në letrën e deputetëve socialistë, fliste për minierat, duke e quajtur punën në to si kampet e përqendrimit të kohëve moderne. Albert Speer ka qenë ministri i armatimeve në Gjermaninë e Hitlerit. Për të nxitur prodhimin, ai përdorte me mijëra punëtorë nga vende të ndryshme të Europës si edhe robër lufte, të cilët detyroheshin të punonin nëpër minierat e Rajhut. Në gjyqin e Nurembergut Speer-i e kishte në aktakuzë edhe këtë fakt. Speer-i u mbrojt duke deklaruar se nuk e dinte që ata ishin të tillë dhe se sidoqoftë ai ishte përpjekur ta përmirësonte jetën e tyre me qëllim që ata të ishin eficientë në punë. E kuptoni apo jo!? Përfundoi në Nuremberg pasi shfrytëzonte punën e robërve të luftës në kushte të vështira!

Tunelet kanë një pronar që ka një licencë në dorë, apo që e ka zënë me zor, kjo nuk bën shumë dallim. Pronari i galerisë (term ky i zhdukur me zhdukjen e njeriut të shpellave, por i ringjallur në Shqipërinë e internetit), zakonisht është një burrë në të 40-at, i fuqishëm, me bark të fryrë dhe qafë të trashë, që nuk e bën kabull të hyjë vetë në tunelin e errët. E ka blerë shtrenjtë liçencën ose i është dashur të bëjë të fortin për të zënë minierën dhe nuk e lë barku të hyjë vetë në tunel, ndaj vë të tjerët, ata të pafuqishmit, të hyjnë, ndërsa ai, bosi, pret jashtë të marrë mineralin me para në dorë. Ai nuk detyron kënd të hyjë aty me zor. Thjesht rri te hyrja dhe paguan fatkeqin që për pak para hyn e rrezikon kokën brënda.

Ky sistem ka edhe një të mirë tjetër. Duke mos i pajtuar punëtorët vetë, pronari nuk mban asnjë përgjegjësi për ç'ka ndodh brenda ferrit të nëntokës. U rrëzua tuneli, u vra njeri, la brënda ndonjë këmbë a dorë, atij s'i intereson. Ky lloj sistemi është shumë më mizor edhe se sistemi i romakëve, të cilët të paktën mbanin përgjegjësi për ç'ndodhte në minierë.

Le të bëjmë një llogari të thjeshtë. Nëse në këto miniera do të punonin skllevër të vërtetë nga ata të lashtësisë, skllavopronarëve modernë do t'u duhej t'i sillnin ata që nga larg, gjë që kushton. Pastaj do të duhej që t'u jepnin edhe të hanin, në mos tre, të paktën dy vakte në ditë. Pa duhej t'u jepnin edhe veshje, se po të sëmureshin, do t'u duhej të harxhonin para për t'i shëruar. Po të qenë skllevër, bosi do të duhej të paguante edhe për ta mbajtur skllavin me bukë, edhe pasi ai të mos punonte dot. Nuk më thoni dot që në pleqëri mund ta flakte në kanal, se po të bënte kështu, gjithë skllevërit e tjerë do t'ia mbathnin sa kishin ende këmbë të forta. Pa pastaj, në rast aksidenti, do t'i duhej që ta mjekonte se, për këtë vërtet nuk të detyrojnë ligjet e Shqipërisë moderne, po të detyronin ligjet e Romës antike. E shikoni sa bela do të ishte, nëse bosët e sotëm të minierave do të përdornin skllevër dhe sa lirë ju del hesapi të fusin atje në pus qytetarë të lirë? E kuptoni pra, se sa pak është t'i krahasojmë këta të mjerët tanë të Bulqizës, me skllevërit e qëmoçëm apo me kampet e përqendrimit?

Para disa ditësh vdiq minatori i radhës në Bulqizë. Më 11 nëntor kishte vdekur një tjetër, ndërsa në 18 tetor dy të tjerë. Stalini thoshte se "të vrasësh një njeri është krim, të vrasësh një milion është statistikë". I njëjti fenomen është institucionalizuar tashmë me Minierat e Veriut. Kur u vra i pari minator vite të shkuara, vrapuan të gjithë, presidentë, kryeministra, kryetarë partish, kryebashkiakë, e lloj-lloj kryesh të tjerë. Pastaj vdiq i dyti, e pastaj tjetri, e tjetri, e tjetri. Me kohë, pas çdo vdekjeje zuri të pakësohej edhe prezenca e të mëdhenjve, filluan të dërgonin vetëm përfaqësues të tyre, pastaj vetëm telegrame, pastaj ... hiç. Tashmë, shtypja e një minatori nën pirgun e gurëve, është thjesht një njoftim disi i sikletshëm ndërsa dëgjon lajmet, duke ngrënë drekë. Ky është suksesi i politikës së papërgjegjshme të një palo shteti po aq të papërgjegjshëm

(Marrë nga gazeta "Shqip", 22 dhjetor 2011)

Ka ndodhur nje ngjarje? Keni ndonje shqetesim
per te ndare me komunitetin?
Keni ndonje propozim per zhvillimin e zones suaj?
Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

Personat me invaliditet të ndihmohen më shumë

Nga: **Mr. DITA TORTE**

Në shumë vende të botës u shënua 3 dhjetori - Dita ndërkombëtare e personave me invaliditet. Kjo ditë reflekton mesazhin e humanizmit, fisnikërisë dhe ngrohtësisë së ndërsjellë mes njerëzve. Tashmë disa dekada në agjendën e aktiviteteve në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në institucionet e tjera ndërkombëtare, në vëmendje janë vënë të drejtat e personave me invaliditet. Më 4 tetor 1992 në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së 3 Dhjetori u shpall Ditë nderkombetare e personave me invaliditet.

SECILIT MUND T'I NDODH TË BËHET PERSON ME INVALIDITET

Asnjë njeri pa marë parasysh gjendjen e tij momentale të volitshme shëndetësore, ose pozitën apo funksionin në shoqëri, nuk mund t'i lejojë vetes të mendojë se, ai ose anëtarë të familjes së tij, nuk do të preket nga sëmundja me pasoja invaliditeti. I vetmi garancion për shpëtimin nga kjo e keqe, është që të ngritet vetëdija e jonë për zbulimin, parandalimin, mjekimin dhe rehabilitimin e personave me invaliditet që ndodhen rreth nesh. Kjo do të ishte ndihma më e mirë, më produktive dhe më e domosdoshme e jona, që kësaj kategorie të njerëzve tu ofrojmë kujdesin dhe dashurinë tonë aq të domosdoshme.

Në Maqedoni jeton një numër i konsiderueshëm i personave me invaliditet, i moshave dhe gjinive të ndryshme. Për fat të keq këtyre personave nuk u kushtohet vëmendja dhe ndihma e nevojshme, në familje për shkak të mospasjes së kushteve, ndërsa në shoqëri për shkak të faktit se kjo ndihmë nuk meret me seriozitetin e duhur. Maqedonia e ka nënshkruar Konventën ndërkombëtare për të drejtat e personave me invaliditet..

Shënimi i kësaj dite ka për qëllim të ngritet shkalla e njohjes dhe e mirëkuptimit për problemet me të cilat ballafaqohen personat me invaliditet, për të ngritur vetëdijen tonë që këta persona të ndihmohen e integrohen në jetën shoqërore dhe ekonomike.

DEFEKTOLOGJIA HUMANE POR E VËSHTIRË

Defektologjia për shkak të kompleksitetit të saj është degë e vështirë dhe specifike. Në këtë profesion lypset dëshirë, vullnet dhe gatishmëri shumë e madhe, lypset përkushtim, përgatitje psikike maksimale dhe guxim profesional. Kjo mu për faktin se gjatë studimeve, punës praktike dhe ushtrimit të profesionit, defektologu përkundër dëshirës për të ndihmuar domosdoshmërisht ballafaqohet me shumë vështirësi. Për fat të keq te na defektologu nuk e ka fituar vendin e merituar në shoqëri.

Prindërit që kanë fëmijë me invaliditet, duhet të gjejnë forcë për të mos e mbajtur fshehur. Ata sa më parë duhet ta kërkojnë ndihmën e specialistëve defektologë. Kjo ndihmë fëmijëve duhet tu jepet që në momentin kur vërehen anomalitë, e jo t'i fshehim ato për arsye të mentalitetit, duke ua kufizuar dhe vonuar mundësitë e mjekimit dhe të rehabilitimit. Kështu do tu ndihmojnë më së miri fëmijëve me invaliditet për t'i kapërcyer pengesat dhe për të arritur që ata të bëhen të paktën përafërsisht të barabartë me tjerët, për vijuar edhe shkollat speciale, sepse te të gjithë njerëzit ekziston dëshira për ta jetuar jetën sa më afër normalitetit. Në këtë drejtim lypset të bëhen përpjekje dhe angazhime për të krijuar kushte dhe për tu ndihmuar maksimalisht personave me invaliditet.

QENDRA REHABILITIMI NEVOJITEN EDHE NË RAJONET SHQIPTARE

Në Maqedoni ekzistojnë disa qendra të rehabilitimit për personat me invaliditet, por ato mungojnë në vendbanimet shqiptare. Duhet ndërtuar më shumë qendra të reja rehabilitimi, të pajisura me personel përkatës dhe me defektologë, ku do të rehabilitohen personat me invaliditet. Me këta njerëz duhet punuar me kohë, përndryshe gjithnjë do të mbeten barë e rëndë e familjeve ku jetojnë, por edhe e shoqërisë. Nuk duhet anashkaluar edhe faktin se nga jeta shumë dinamike, dhe ndotjet kontaminuese të ambientit, të cilat sëbashku me traumat, përbëjnë vatra rreziku për lindjen e fëmijëve me invaliditet.

SHOQATAT HUMANITARE DUHET TË MBIKËQYREN

Shumëzimi si këpurdha i shoqatave të ndryshme humanitare, që deklarojnë se janë themeluar për të ndihmuar personat me invaliditet përbën brengë më vete. Ka të dhëna se, me përjashtim të atyre që punojnë me ndershmëri, ka edhe shoqata humanitare që ndihmojnë shumë pak, që aktivitetet e tyre i bëjnë në mënyrë joadekuate, joprofesioniste e në të shumtën e rasteve vetëm për interesa materiale personale.

Do të ishte më e dobishme po qe se krijoheshin mekanizma ligjore, që të gjitha shoqatat humanitare që merren me personat me invaliditet, të kenë mbikqyrje dhe kontrolle inspektimi të shpeshtë për punën që bëjnë. Pa përfshirjen e ekspertëve profesionistë - defektologëve dhe pa mbikqyrje të këtyre aktiviteteve, nuk mund të presim që tu ndihmohet sa duhet personave me invaliditet.

ASKUSH NUK MUND TA ZËVENDËSOJË DEFEKTOLOGUN

Kohëve të fundit në Maqedoni flitet me të madhe për aplikimin e mësimit inklusiv edhe nëpër shkollat tona. Lidhur me këtë duhet theksuar se për mësimin inklusiv ka mendime të ndara. Disa mendojnë se kjo është pozitive dhe se mund të realizohet, ka edhe mendime që janë kundër mësimit inklusiv, duke argumentuar se vështirë mund të vendosen në të njejtin pozicion një fëmijë me invaliditet dhe një fëmijë pa invaliditet. Mësimi inklusiv nuk është



punë aqë e lehtë, por është punë komplekse, për suksesin e së cilës lypset infrastrukturë e veçantë shkollore, mjete didaktike specifike, angazhim profesionist dhe mjete të konsiderueshme financiare. Nëse në shkollat tona vendoset të aplikohet mësimi inklusiv, atëherë është e domosdoshme që Ministria për Arsimi dhe Shkencë, t'i ndërmerr të gjitha masat që në çdo shkollë të punësojë nga një defektolog, sepse në të kundërtën kurrë nuk mund të arrihet suksesi i dëshiruar. Tani për tani zgjedhja e vetme dhe më adekuate ku fëmijeve mund tju jepet ndihma më e mirë mbeten shkollat speciale, ku punojnë defektolog me përvojë.

INSTITUTI I DEFEKTOLOGJISË SHËNON 3 DHJETORIN

Me rastin e 3 Dhjetorit - Ditës ndërkombëtare të persovave me invaliditet, si çdo vit, në Fakultetin Filozofik të Universitetit « Shën Cirili dhe Metodi », Instituti i Defektologjisë në Shkup, e shënon këtë dite të rëndësishme. Këtë ditë e shënojnë edhe shkollat speciale në Maqedoni. Do të ishte mirë që 3 Dhjetori të përjetohet në 365 ditët e vitit , dhe jo të pritet vetëm dita e sotme për të kujtuar peronat me invaliditet.

Autorja është magjistre e Defektologjisë nga Dibra e madhe, aktualisht jeton e punon në Shkup

Dokumentar

"Me dibranët e Tiranës, një histori rrugëtimi"

Diten e shtune ne ambjentet e Akademise se Shkencave ne Tirane u promovua dokumetari me karakter hisoriko-social i pergatitur nga gazetarja Vjollca Sadiku. Te pranishem ne kete aktivitet ishin drejtues te qeverisjes vendore nga Tirana dhe Dibra e Madhe, intelektual dhe mjaft qytetar dibrane me banim ne Tirane. Posacerisht per kete aktivitet kishin ardhur nga Dibra e Madhe dhe nje grup studentesh te rinj si dhe qytetar e familjare. Qellimi i ketij dokumentari ishte qe te tregonte karrvanin e rrugetimit hisorik te familjeve te para dibrane te cilet gjate eksodit te genocidit te viteve 1913-1920 lane shtepite dhe te afermit e tyre per tu vendosur ne Tirane. Personazhe ne kete dokuemtar ishin ngjarjet e verteta, largimet e padrejte dhe me dhune i ketyre familjareve nga vendet e tyre, nostalgjia e nje sere artisteve dhe intelektualeve te cilet te mallengjyr tregonin ngjarjen si dhe historite e te pareve te tyre sesi u shpergulen nga Dibra nen peshen e percmimit dhe te dhunes, duke treguar doreshkrime dhe fotografi te familjareve te tyre. Ky dokumentar eshte shfaqur per kater jave rrjesht ne tevizionin e Dibres, me nje trasmetim prej nje ore ne jave (gjithesej pergatitur 4



ore telereportazh), duke patur nje audience te gjere dhe teper te kerkueshme per tu ritasmentuar me kerkes te publikut. Pergjate 1 ore ne dokumentar u evidentuan gjithashtu marredheniet e shkelqyera mes familjeve Dibrane dhe Tiranase, te cilet nuk kurrsyen asgje per bujarin dhe mikepritjen e tyre tradicionale dhe te vecante ndaj dibraneve. Ne kete veprimtari promovuese na nderonin me pjesemarrjen e tyre Z. Njazi Kosovrasti Kryetar i Keshillit Bashkiak te Tiranes, Dr. Argetim Fida Kryetar i Komunes Diber-Maqedoni, Z. Bujar Kapexhiu, anetar i kryesise se SHBD dhe Mjeshter Arti. Ne perfundim te shfaqes se dokumentarit fjalen e morri dhe kryetari i Komunes Diber-Maqedoni, Dr. Argetim Fida, i cili ftoj shoqaten Bashkesia Dibrane dhe Komitetin "Nisma per Rrugen e Arberit" te drejtuar nga Znj. Yllka Causholli, per te festuar se bashku vitin qe vjen ne Diber, Jubileun e 100-Vjetorit te Shpalljes se Pavaresise Kombetare, ftese e pritur me kenaqesi nga te pranishmit.

vëzhgim



Dibra e Madhe mes gëzimit, lotit dhe asmilimit

Nga: ***Rexhep TORTE***

Në një takim ngushëllimi në një fshat të Dibrës së Madhe me rastin e vdekjes së një mërgimtari dibran, një plak i urtë tha, "më parë kur ishim të varfër tërë ditën punonim e në mbrëmje tuboheshim përreth sofrës. Në mes ishte tasi me më shumë lëng sesa groshë, kërsitnin lugët, por vetë fakti se të gjithë ishim tok e hanim sëbashku, na bënte të ndjejmë ngrohtësi gëzimi në zemrat tona. Sot jemi më të pasur, kemi edhe fëmijët tanë në kurbet gjer matanë oqeanit, por ja vijnë rastet e vdekjes duke na e sjellur varfërinë në zemrat tona".

Këto fjalë janë shumë dometënëse kur kemi parasysh njëzet mijë zemrat dibrane në vendlindje, po aqë në mërgim në SHBA, duke mos llogaritur ato nëpër Evropë e deri në Australi.

Kjo është Dibra e Madhe me zemrat e ndara familjare, fisnore e shoqërore, me shqetësimet dhe gjëmat që sjell mallëngjimi këtej dhe andej Dibrës, që ta përvlon shpirtin.

Asnjë dibran nuk është larguar nga vendlindja prej qejfi, por vetëm nga zori për të siguruar bukën për vete e familjen.

Ka dibranë që në mërgim jetojnë me familjet e tyre, por ka edhe dibranë që në mërgim kanë shkuar vetëm ndërsa familjet i kanë lënë në Dibër të Madhe. Në mërgim ka dibranë që tashmë janë shtetas të shteteve ku jetojnë, por ka edhe dibranë që atje jetojnë me grinkartë apo në mënyrë ilegale në pritje të rregullimit të statusit të tyre.

Dibranët në mërgim janë dëshmuar për zellshmëri dhe aftësi në punë, biznese e shkollim. Kontot bankare, shtëpitë dhe pasuritë e tyre peshojnë miliarda dollarë. Mundësia e tyre për të investuar në vendlindje është shumë e madhe, por lypset të gjendet shkopi magjik për t'i vënë në lëvizje kapacitetet që ofron Dibra e Madhe dhe për të hapur vende të reja pune, aqë të nevojsjhme për rininë dibrane, e cila ka mbetur pa shpresë dhe me synin të largimit nga Dibra nga Dibra e Madhe. Largimi i rinisë dibrane po e tkurrën populsinë nga dita në ditë. Po të hapeshin vende pune, të rinjtë do të mbeteshin në vendlindje, sepse të rinjë dibranë janë shumë të vyer dhe me shkollim të të gjitha niveleve.

Shprehjet e mërgatës dibranë se e duan vendlindjen, pa investimet konkrete , kanë mbetur të zbrazëta. Mërgata i ka përjertuar të gjitha vuajtjet e peripecitë, ndaj është e udhës të vë dorë mbi Dibrën e Madhe për ta nxjerrë nga kolapsi ekonomik.

Është lumturuese kur në muajt e verës nga mërgata në Dibër të Madhe vijnë disa mijëra dibranë për t'i kaluar pushimet me familjet, farefisin dhe shokët. Kjo është një hallkë e mirë për t'i ruajtur lidhjet me vendlindjen, por kjo ndodh një herë në vit.

Me keqardhje mund të themi se asnjë nga mërgimtarët dibranë nuk është kthyer sërish për të jetuar në vendlindje, sepse i tillë është ambieni i SHBA-ve që nuk të lë të largohesh. Një pjesë e të rinjve dibranë që kanë lindur në SHBA e që nuk kanë ardhur në Dibër të Madhe, po e humbin edhe interesimin për vendlindjen dhe lehtë mund të bëhen viktimë e asimilimit.

Mërgimtarët dibranë thonë se në SHBA ka vetëm punë e gjumë, sepse orari i punës dhe udhëtimi disa orë në vajtje dhe kthim nga puna, bën që të mos mbetet kohë për gjëra tjera që i lyp jeta. Pritet dita e pushimit gjatë javës për tju kushtuar familjes dhe argëtimit. SHBA-të nuk janë parajsë për të rinjtë tanë, sepse edhe atje aktualisht është e pranishme papunësia. Mërgimtarët thonë se, secili që vendos të kapën rrugën e mërgimit për në SHBA, është më se e nevoshme që përveç gjuhës angleze e arsimit sipëror, të ketë kryer edhe ndonjë zanat, si kusht për tu integruar më shpejt e më lehtë në shoqërinë amerikane.

Sipas tyre, një punësim normal në Dibër të Madhe, do të ishte shumë më i vyer për një jetë normale sesa aventura e mërgimit që ka të mirat, por edhe vështirësityë e saj, që ka gëzimin, lotët dhe asimilimin.

Banjat e Dibrës së Madhe - Capa punojnë tërë vitin

Investime të reja për rritjen e cilësisë



Veçoritë e pazëvendësueshme mjekuese të ujit, kujdesi i personelit mjekësor, rekuizitat bashkëkohore ushtruese, pastërtia dhe menya e pasur e hoteleve, janë reklama më e mirë që këto banja ia bëjnë vetes duke tërhequr në vazhdimësi mysafirë dhe duke i mbajtur kapacitetet plot.

Praktika e dikurshme e stinës turistike të Banjave të Dibrës – Capa që zgjaste nga maji gjer në shtator, tashmë i ka mbetur të kaluarës. Me investimet prej 5 milionë euro që i ka realizuar pronari Mexhit Capa në lokalitetet e Banjës së Banishtit dhe të Banjës së Kosovrastit në 6 vitet e fundit pas privtizimit, ka bërë që të krijohen kushte të shkëlqyera për rehabilitim, ku mysafirët mund të qëndrojnë e buajnë gjatë tërë vitit. Edhe në këto ditë të muajit dhjetor kapacitetet hotelierike të këtyre banjave janë përplot me mysafirë. Mysafirët që qëndrojnë për rehabilitim shëndetësor janë nga Maqedonia, vendet fqinje, por pjesa më e madhe nga Shqipëria

Veçoritë e pazëvendësueshme mjekuese të ujit, kujdesi i personelit mjekësor, rekuizitat bashkëkohore ushtruese, pastërtia dhe menya e pasur e hoteleve, janë reklama më e mirë që këto banja ia bëjnë vetes duke tërhequr në vazhdimësi mysafirë dhe duke i mbajtur kapacitetet plot.

Mexhit Capa, pronar i Banjave të Dibrës së Madhe, thotë se , "sivjet filloi edhe sistemi i ri i nxemjes qëndrore në Banjën e Kosovrastit për të cilin shpenzuam 100 mijë euro. Ky është një projekt i ri që e aplikuam për të kursyer energji elektrike, lëndë djegëse, për të mos i rritur çmimet e shërbimeve tona dhe për ta ruajtur ambientin nga ndotja. Çmimet e energjisë, të naftës dhe të ushqimeve janë rritur shumë, ndërsa në banjat tona çmimet nuk janë rritur gati gjashtë vite. Si alternativë për nxëmjen e ambienteve tona ne tashmë përdorim ngrohjen solare dhe ujin termomineral që ka temperaturën 42 gradë. Për këtë qëllim kemi ndërtuar një basen me ujë termomineral ku janë vendodur 6 mijë metra tubo me ujë të ftohtë, të cilat nxehen këtu dhe qarkullojnë nëpër stabilimentet e vendosura, duke bërë nxemjen dhe furnizimin me ujë të nxehtë të ambienteve tona 24 orë pa ndërprerëje. Këtë gjë do ta bëjmë edhe në Banjën e Banishtit dhe në restorantin dhe hotelin "Uraniku" në Dibër.

Tashmë do të kryhet rinovimi i dhomave me 40 shtretër në hotelin "Uraniku" në Dibër, rinovimi i 72 dhomave me 120 shtretër të Banjës së Banishtit, dhe i 50 dhomave të Banjës së Kosovrastit, që nënkupton rikontruksion të punëve ndërtimore në pishinat, banjot, dhomat dhe të orendive të brendshme në dhomat duke përfshirë edhe krevatët, në vlerë mbi 500 mijë euro. Pas kësaj vitin e ardhshëm 2012 do të vendosim gurthemelin për ndërtimin e një hoteli të ri me 120 dhoma në Banjën e Banishtit e pastaj edhe në atë të Kosovrastit. Kjo don të thotë rritje e cilësisë së shërbimeve dhe hapje të vendeve të reja të punës. Pritet që në banjat tona të vijnë edhe turistë të organizuar nga Hollanda. Më parë kishim turistë nga ky vend për vizitë njëditore. Ata kanë mbetur tejet të kënaqur duke përhapur famën e banjave tona edhe atje, kështu që tani kanë paralajmëruar ardhjen e tyre më masovike", thotë Mexhit Capa.

Latif Dika mjek specialist, shprehet se, " Banjat termominerale të Dibrës së Madhe janë të pasura me minerale që kontribuojnë në shërimin e suksesshëm të shumë sëmundjeve, duke zënë vendin e parë në Evropë dhe të tretë në botë. Në këto banja mjekohen më shumë se 35 sëmundje të aparatit lokomotorik, të sistemit nervor, të sistemit gastrointestinal, të sistemit respirator, urogjenital, të sëmundjeve endokrinale, të gjendjeve pas traumave të ndryshme, sëmundjeve të lëkurës dhe të sëmundjes së sheqerit" thekson Dika.

R.TORTE

- Hulumtime rreth emrit dhe vendndodhjes së Fushës së Torviollit -

Fusha e Torviollit apo Fusha e Tri Vjolleve?!

Nga: **AVNI ALCANI**

Pas kthimit të Skënderbeut në Krujë dhe fillimit të kryengritjes së tij kundërosmane, u ndje e nevojshme që të krijohej një lidhje apo bashkim të shqiptarëve, për të luftuar së bashku hordhitë pushtuese të ushtrisë turke. Më 2 mars 1444 Skënderbeu thirri në qytetin e Lezhës fisnikët shqiptarë, për krijimin e Besëlidhjes Shqiptare, e njohur si Kuvendi i Lezhës. Në të u ftuan drejtuesit e zotërimeve të pavarura dhe fisnikë të tjerë të vendit, për bashkimin e forcave të brendshme politike, ushtarake dhe ekonomike, që të mund t'i bëhej ballë pushtimit të egër otoman, fuqisë më të madhe ushtarake të kohës.

Sipas Barletit, në Kuvendin e Lezhës shkuan udhëheqësit kryesorë të kryengritjeve kundërosmane, por edhe pjesëtarë të tjerë të fisnikërisë shqiptare. "I pari nga të gjithë, - shkruan Barleti, - arriti Arianit Golem Topia (Gjergj Araniti), burrë me emër e me autoritet të madh si për bujarinë e lashtë të fisit, si për përvojën shumë të madhe në punët e luftës e për fisnikërinë e veçantë të fjalës dhe të fytyrës". Araniti mbërriti i shoqëruar nga dy nipërit e tij, Muzaka i Angjelinës dhe Gjurik Vladan Araniti. Barleti radhit edhe fisnikë të tjerë të lartë, siç ishin: Andre Topia (me dy djemtë, Kominin e Muzakën dhe nipin, Tanushin), Gjergj Stres Balsha, Gjin Muzaka (Despoti i Beratit), Nikollë e Pal Dukagjini, "që të dy të sprovuar në luftë" (Barleti), Lekë Zaharia, Lekë Dushmani, Stefan Cërnojeviçi (bashkë me bijtë e tij, Gjergjin e Gjonin), Pjetër Spani (bashkë me katër djemtë, Aleksin, Bozhidarin, Vruon dhe Mirkon), Zaharia Gropa etj.

Kuvendin e kryesoi Skënderbeu, i cili mbajti dhe fjalën e hapjes. Ai i dha rëndësi të madhe bashkimit politik dhe ushtarak të shqiptarëve për të përballuar së bashku fuqinë e madhe të ushtrisë pushtuese. Nga pjesëmarrësit foli Gjergj Araniti, i cili e quajti Skënderbeun "Princ i Arbërve" (Barleti) dhe propozoi që ai të vihej në krye të ushtrisë shqiptare. Vendimi më i rëndësishëm që u mor në Kuvend ishte krijimi i ushtrisë së përbashkët dhe caktimi i Skënderbeut si kryekomandant i përgjithshëm i saj.

Për t'iu kundërvënë Besëlidhjes Shqiptare, Sulltan Murati II nisi një ushtri të madh të komanduar nga Ali Pasha, subashi i Shkupit, një nga komandantët e tij më të shquar. Ai u vu në krye të 25 mijë vetave dhe iu drejtua viseve të lira shqiptare. Skënderbeu, sipas M. Barletit, i informuar me kohë për ardhjen e trupave osmane, përgatiti një ushtri prej afro 8 mijë kalorësish dhe 7 mijë këmbësorësh. Beteja u zhvillua në verë (qershor) të vitit 1444, në një vend që është emërtuar si "Fusha e Torviollit".

Skënderbeu përdori në këtë betejë një nga strategjitë e tij më të shquara, e cila është vlerësuar nga historianët dhe strategët ushtarakë si një nga taktikat më të shkëlqyera të artit ushtarak botëror dhe për Skënderbeun si një nga strategët më të mëdhenj të kohës. Ai e vendosi ushtrinë në fushë të hapur, përballë ushtrisë së armikut dhe e rreshtoi atë në formë harku të ndarë në tri pjesë. Në rreshtat e parë vendosi kalorësinë dhe pas tyre këmbësorinë. Për të drejtuar zhvillimin e betejës, ai qëndroi në krye të kalorësisë, me luftëtarët e grupimit të qendrës. Forcat e grupimit të djathtë i komandonte Moisi Golemi Arianiti, kurse ato të grupimit të majtë Tanush Topia. Mbrapa trupave të qendrës ishin vendosur edhe dy grupime luftëtarësh nën drejtimin e Ajdin Muzakës dhe të Kont Uranit. Në pyjet rrotull fushës ishin të fshehura forcat e rezervës të komanduara nga Gjin Muzaka dhe Hamza Kastrioti. Beteja filloi me sulmin e shqiptarëve. Sapo u ndeshën me forcat osmane, Skënderbeu u sul furishëm në qendër, kurse dy pjesët e ushtrisë, që ishin vendosur në pyjet e të dyja anëve të fushës, sulmuan njëherësh, duke e shpartalluar tërësisht ushtrinë osmane. Luftëtarët e Skënderbeut luftuan heroikisht dhe arritën një fitore të shkëlqyer. Në atë betejë, shkruante Barleti, "luanët komanduan luanët". Fitorja e ushtrisë shqiptare pati jehonë të madhe në Shqipëri dhe jashtë saj. Ajo përforcoi besimin e shqiptarëve te Skënderbeu dhe tek ushtria e Lidhjes së Lezhës.

Ku ndodhet Fusha e Torviolli, ku mendohet se u zhvillua beteja e famshme e vitit 1444? Marin Barleti, historiani më i madh i Skënderbeut dhe bashkëkohësi i tij, kur përshkruan betejën e qershorit të vitit 1444, nuk e përmend fushën ku u zhvillua beteja me këtë emër. I vetmi që e përmend atë, si "Beteja e Fushës së Torviollit", ka qenë G. Biemi, i cili, siç e kemi përmendur edhe në shkrime të tjera, është cilësuar nga disa historianë (Babinger, Buda, Shuteriqi etj.), si mashtrues dhe falsifikator.

Deri në fund të viteve '60 të shekullit të kaluar, historianët shqiptarë të pas Luftës së Dytë Botërore, nisur edhe nga të dhënat që jepte Barleti, e kishin përcaktuar vendndodhjen ku u zhvillua beteja e vitit 1444, në Fushën e Përrenjasit, e njohur me emrin e sotëm si Fusha e Domosdovës. Edhe në tekstin e "Historisë së Shqipërisë" (1966) për klasat e 6-a, të hartuar nga Prof. Stefanaq Pollo, sipas tij, beteja e Torviollit ishte zhvilluar në Fushën e Domosdovës (Përrenjas). Por, pas viteve '70, ata e "transferuan" fushën dhe betejën e Torviollit në Dibër. Kjo bëri që historianë lokalë, veçanërisht ata dibranë, të nxiteshin për të hartuar shkrime e artikuj të panumërt për të ripërcaktuar vendndodhjen e Fushës së Torviollit në trevat e Dibrës. Disa shkruanin se beteja e Fushës së Torviollit ishte zhvilluar në Bulqizë dhe disa të tjerë në një fushë që ndodhet në Dibër.

Rreth debatit për vendndodhjen e Fushës së Torviollit nuk mbetën pas edhe studiuesit lokalë librazhdas. Njëri prej tyre, Shahin Zharri (1915-1991), botuesi i parë i "Këngës së Gjorg Golemit" në vitin 1938 dhe një njohës i mirë i historisë së trevave të tij, kësaj ngjarjeje i pati kushtuar një studim të veçantë. Për hulumtimin e vendit se ku ka qenë Fusha e Torviollit, Sh. Zharri pati shfrytëzuar burimet historike të kohës si dhe botimet kushtuar figurës së Skënderbeut, veçanërisht veprën e Marin Barletit. Ai gjithashtu pati shfrytëzuar edhe burime të tjera, si tregimet popullore, toponimet, antroponimet etj. Sh. Zharri, me një analizë të thjeshtë të fakteve dhe me argumente bindëse, konkludon se, Fusha e Torviollit, ose Fusha e Tri Vjollëve, siç e quante ai, është fusha e sotme e Domosdovës në qytetin e Përrenjasit.

Në vitet '70–'80 kam punuar në Muzeun Historik të rrethit të Librazhdit dhe e pata njohur nga afër zotin Shahin Zharri. Bashkë kemi zhvilluar biseda të ndryshme që kishin lidhje me traditat historike dhe kulturore të trevave të Librazhdit, për të cilat ai kishte njohuri të thella. Një ditë solli në muze mikun e tij, Sal Radaku, i cili ishte një njohës dhe lexues i pasionuar i librave historikë. Dy miqtë bisedonin dhe diskutonin rreth eksponanteve të muzeut. Ata u ndalën gjerësisht te vitrina ku ishte ekspozuar skema që ilustronte strategjinë që kishte përdorur Skënderbeu në Betejën e Torviollit. Biseda u përqendrua tek emri i fushës, që sot thirret "Fusha e Domosdovës", që për ata ishte Fusha e Torviollit e shek. XV. Disa vite më parë (1972) ishte publikuar një shkrim, ku pretendohej se Fusha e Torviollit, ku ishte zhvilluar beteja e parë e Skënderbeut në vitin 1444, ndodhej diku në Dibër. Shahini tha se Fusha e Përrenjasit, para se të merrte emrin që ka sot (Fusha e Domosdovës), kishte pasur emrin "Fusha e Tri Vjollëve". Vjollët, - tha Shahini, - janë rrasa guri ku hidhej kripa për ushqimin e bagëtive të imta. Vjollët ishin të ndara mes tri fshatrave: Rrajcës, Kotodeshit dhe Përrenjasit, ndaj dhe kishte marrë emrin "Fusha e Tri Vjollëve". Pyetjes sime, se përse nuk shkruante një artikull ku t'i rendiste të gjitha argumentet rreth emrit të vjetër të Fushës së Trivjollëve, ai iu përgjigj se e kishte shkruar dhe e kishte dërguar në Institutin e Historisë në Tiranë, por ata nuk i kishin kthyer asnjë përgjigje.

Shumë vite më vonë (2005), kur isha duke seleksionuar disa materiale për hartimin e monografisë kushtuar Sh. Zharrit, papritur hasa në shkrimin e Shahinit kushtuar Fushës së Torviollit, të titulluar: "Ku ndodhet Fusha e Torviollit?" Shkrimi ishte i shtypur me makinë shkrimi, në formatin A-4, dhe ishte i përgatitur për t'u botuar me rastin e 545-vjetorit të Betejës së Torviollit (viti 1989). Artikulli i ishte adresuar gazetës lokale "Agimi", por që ajo nuk e kishte botuar dhe Shahini kishte shënuar në fund të studimit të tij: "Ky material u përgatit për gazetën 'Agimi', por s'e botuan nga frika e polemikës". Çfarë frike kishin pasur botuesit e gazetës "Agimi" dhe çfarë polemike do të ngjallte ai artikull?!

Sipas mendimit tonë, supozojmë se tri mund të kenë qenë arsyet kryesore për mosbotimin e atij artikulli. Së pari, gazeta lokale "Agimi" ishte një gazetë partiake (organ i Komitetit të Partisë të Rrethit të Librazhdit) dhe, duke qenë se bashkëshortja e sekretarit të parë të KQ të PPSH

- Me rastin e 545-vjetorit të Betejës së Torviollit -

KU NDODHET FUSHA E TORVIOLLIT?

Në juglindje të rrethit të Librazhdit shtrihet Fusha e Domosdovës ku, së lashti, kalonte rruga antike "Egnatia". Nëpër këtë rrugë kanë kaluar legjionet romake e më vonë sulmuan hordhitë osmane, që u shkërmoqën në gjokset e ushtarëve të Skënderbeut.

Gjithmonë me këtë emër ka qenë quajtur kjo fushë? Sado i vjetër që të jetë emri i kësaj fushe, ajo nuk i kalon vjetët 1467, kur u invazua përfundimisht nga pushtuesit turq.

Në këtë fushë, më 29 qershor të vitit 1444, ushtria turke, e komanduar nga Ali Pasha, nën shpatën e ushtrisë së Skënderbeut, në një disfatë të parë, humbi pathyshmërinë e saj. Këtë humbje të pamenduar, Sulltan Murati e quajti "tersllëk" (prapësi fatale) të atij vendi dhe që me mllef e quajti "Dumosdovë", d.m.th, "Fusha e Derrit".

Sipas tregimeve gojore, në kujtesën e popullsisë vendore, kjo fushë, para 100-150 vjetësh, është thirrur me dy emra: 1. Fusha e Domosdovës dhe 2. Fusha e Vjollëve. Emri i fundit është përmendur shumë rrallë, deri në fillim të viteve '20-'30 të shekullit të 20-të, nga ndonjë plak i moshuar, dhe më vonë është zhdukur.

Fusha deri para kolektivizimit të bujqësisë, në fund të viteve '50 dhe fillim i viteve '60, ka qenë moçalore dhe sipërfaqja më e madhe e saj ka qenë djerrë, e papunuar. Aty verës rriteshin barëra të shumta, të cilat, nga banorët e fshatrave Rrajcë, Kotodesh dhe Përrenjas, kositeshin dhe pas kosës kjo fushë vlente vetëm për kullotë. Secili fshat që përmendëm kishte pjesën e tij të fushës, të ndarë me kufi, ku kishin vendosur vjollët për t'u dhënë kripë bagëtive të tyre. Sipas traditës së këtyre fshatrave, nuk lejohej më shumë se një vend për të vendosur gurët (rrasat) e vjollëve në kullota, pasi duhej të mos shqetësoheshin bagëtitë, të cilat prishnin dhe dëmtonin barin (kullotat). Meqë në këtë fushë ekzistonin vetëm tre vjollë, ajo kishte marrë emrin "Fusha e Tre Vjollëve". Kufijtë e këtyre tre vjollëve njihen edhe sot: Vjolla e parë, e Rrajcës, shtrihej në verilindje dhe kufizohej me "Marain" e Rrajcës; Vjolla e dytë, e Kotodeshit, shtrihej në juglindje dhe jug, deri në Malin e Mokrës (vargu Qafë-Thanë - Kalivaç), në jugperëndim (në zgjatimin e Kodrës së Rashtanit, nën këmbët e së cilës është lumi Shkumbin); dhe Vjolla e tretë, e Përrenjasit, ndodhej në veriperëndim dhe kufizohej me Malin e Pishkashit.

Disa historianë, të cilët mbështeten në pohimet e Biemit, Fushën e Torviollit e fusin thellë në tokat e Dibrave, po me këto toponime që u gjetkërkan edhe në trevat e atyre vendeve. Këto kufizime, me të njëjtat emra, ndofta janë një e qëlluar (koincidencë) me ato të Domosdovës. Mirëpo, përcaktimi i lumit të Shkumbinit, në këmbët e kodrës, identifikon Fushën e Torviollit me fushën e sotme të Domosdovës. Po këta historianë, për të mbrojtur me ngulm tezën e tyre, thonë se emri i lumit Shkumbinit paska qenë quajtur "gabim" nga Biemi, që ka dashur të thotë "Drin".1) Kjo nuk na bind, pasi lumin Drin nuk e ndan një kodër me atë fushë, por një vargmal.

Që Fusha e Torviollit është në Dibrën e dikurshme, mund të jetë e pranueshme, por jo në Fushën e Peshkopisë. Kjo fushë deri vonë ka bërë pjesë në krahinën e Dibrës bashkë me një varg fshatrash, që janë në kufijtë e sotëm administrativë të Rrethit të Librazhdit. Ndër fshatrat që i përkasin kazasë së Dibrës, gjatë sundimit turk, ka qenë edhe Pishkashi, fshat në kufi me Fushën e Domosdovës, së bashku me shumë fshatra të tjera të krahinës së Çermenikës, në lindje të lumit të Shkumbinit.2) Fshatrat në perëndim të rrjedhës së lumit të Shkumbinit kanë qenë quajtur "alkaza", d.m.th, krahinë tjetër. Kjo ndarje u ruajt për një kohë të gjatë nga administrata e pushtetit turk, deri në mesin e shek. të 19-të. Në të dy anë e rrjedhës së sipërme të lumit Shkumbin, deri vonë ka qenë traditë, që fshatarët e krahut të majtë t'i martonin vajzat e tyre me djemtë e krahinës "alkaza", pasi burrat e kësaj krahine nuk merreshin ushtarë (nizamë).

Disa nga fshatrat "alkaza", si Dorëzi, Librazhdi, Dragostunja, Qukësi, Gurra etj., në shekullin e 15-të ishin prona të atit të Moisi Golemit, i quajtur Moisiu i Dibrës.3)

Për lokalizimin e Fushës së Torviollit ndihmojnë edhe informacionet që na jep humanisti shqiptar, Marin Barleti në librin e tij "Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut-Princit të Epirit", kur thotë se ajo betejë (Beteja e Fushës së Torviollit) u zhvillua 30 000 hapa larg kështjellës së Krujës.4) Pa ta masim në vijë të drejtë, kjo distancë i përgjigjet largësisë Krujë-Domosdovë, kurse largësia me fushën e supozuar në Peshkopi del 55-60 000 hapa largësi.

Në shekullin e 18-të, disa familje fshatare nga krahina e Polisit, të përndjekura nga presioni i iltizamëve dhe fajdexhinjve elbasanas, u shpërngulën në zonat e quajtura "alkaza".5) Familjet e vendosura në Pishkash edhe sot mbajnë si mbiemër "Polisi", emrin e vendit të origjinës së tyre.

Argumentet që dhamë na sjellin në sintezë se Fusha e Vjollëve, ose e Tri Vjollëve, dhe me anagramatizëm, Fusha e Torviollit, duhet të jetë aty ku fillon "alkazaja", në Domosdovë, në këmbët e malit Moravë, ngjitur me Maranë, në lindje të lumit Shkumbin.

Librazhd, më 29.05.1989

cyan magenta yellow black

ishte dibrane, vendosja përsëri e Fushës së Torviollit në Përrenjas dhe largimi i saj nga trevat e Dibrës, mund të kishte pasoja të rënda për redaksinë dhe redaktorët e kësaj gazete partiake.

Arsyeja e dytë, mendoj se ka të bëjë me moralin e disa prej historianëve që shkruanin nën diktaturë, të cilët ishin të detyruar të shkruanin sipas "udhëzimeve" të udhëheqjes politike apo dhe të konjukturave. Ky fakt mund të ilustrohet me ndryshimin e origjinës së Skënderbeut, të cilën disa historianë e bënin nga Kukësi, pastaj e zbrisnin në Krujë, disa e kishin dërguar në Mat dhe së fundmi po ata historianë e kishin degdisur në Dibër. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe me Gjergj Aranitin: disa historianë e quanin Princi i Kaninës, disa Princi i Himarës, i Labërisë, i Mallakastrës, i Golemit të Gjirokastrës etj., ndonëse e dinin shumë mirë se Princi i kujt treve ishte.

Arsyeja e tretë është më e ndërlikuar, pasi ka të bëjë me një plagjiaturë, ndaj na duhet që të ndalemi pak më gjatë.

Thamë më sipër se Sh. Zharri kishte shkruar vite më parë për Fushën e Torviollit dhe se ai e kishte dërguar shkrimin e tij në Institutin e Historisë. Nga ai institucion nuk i ishte kthyer asnjë përgjigje. Mund të supozojmë se drejtuesit e Institutit të Historisë as e kishin miratuar, por as e kishin kundërshtuar shkrimin e Shahinit. Ata thjesht e kishin lënë në heshtje shkrimin në fjalë, për arsyet që i dinë vetë ata. Çuditërisht, rreth 4-5 vjet më vonë del një artikull për Fushën e Torviollit, i cili, për koincidencë, mbante të njëjtin titull që i kishte vënë shkrimit të tij Sh. Zharri. Janë disa fakte të rëndësishme në artikull, të cilat na shtyjnë në dyshimin tonë, por unë po rendis më poshtë vetëm njërin prej tyre, atë të emrit "vjollë". Në lidhje me emrin e Fushës së Torviollit, autori i artikullit ka shfrytëzuar të njëjtat argumente që jepte edhe Sh. Zharri, e cila, edhe sipas artikullshkruesit, vinte nga emri "vjollë" (?!). "Vjolla", sipas shpjegimit që i kishte bërë Sh. Zharri, ishte një rrasë guri ku hidhet kripa për bagëtitë. Me këtë emër (vjollë), rrasën e njohin vetëm banorët e trevave në jug të lumit Shkumbin, që është edhe kufiri ndarës i dy prej trevave më të mëdha të Shqipërisë, Toskërisë dhe Gegërisë. Në veri të lumit Shkumbin, në Gegëri, si në Çermenike, Martanesh, Mat etj., kësaj rrase i thonë "gjollë". Edhe në Dibër kështu i thonë. Këtë detaj, artikullshkruesi nuk e ka ditur, ndaj dhe e ka vënë në shkrimin e tij.

A ishte shfrytëzuar artikulli i Sh. Zharrit, kur ky e pati dërguar në Institutin e Historisë dhe ajo mbeti pa përgjigje?! Për mendimin tim, mosbotimi i atij artikulli, qoftë nga Instituti i Historisë, qoftë nga gazeta partiake "Agimi", lë shumë për të dyshuar dhe fakti që renditëm më sipër më shton bindjen se ndaj artikullit të Sh. Zharrit është ushtruar plagjiaturë. Por gabimi më i madh dhe më i rëndë është falsifikimi që i është bërë vendndodhjes së Fushës së Torviollit, e cila, ashtu siç e argumentonte edhe Shahin Zharri, ndodhet në Fushën e sotme të Domosdovës.

Më poshtë po ribotojmë artikullin e z. Sh. Zharri, kushtuar emrit të Fushës së Torviollit, ku, në vitin 1444, u zhvillua njëra prej betejave më të famshme, e udhëhequr nga Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



Udhë të mbarë

Nga: **MUSTAFA TOLA**

Kam nderin e madhë, tu drej tohem në këtë ditë feste Çidhnakeve me fjalet tunjatjeta dhe gezuar 28 Nentorin, festën e Pavarsis që me shumë gjak e sakrifica të jashtëzokonshme me 1912, e benë të mundur burrat e kombit.

Si sot, 567 vite më parë, biri i Çidhnës dhe Heroi Kombëtar i shqiptarve GJERGJ KASTRIOT-SKENDERBEU, ngriti flamurin në Krujë, i shoqëruar nga 300 trimat Dibran, sigurisht që shumica prej tyre kanë qenë Çidhnak.

Për koncidenc ne Çidhnakët e shperndar këtu në Tiranë dhe në teritoret tjera Shqiptare, e në diaspor, për të ruajtur lidhjet me vendlindjen dhe për të zhvilluar vlerat tona Etnokulturore, duke synuar sqarimin e origjinës Çidhnake ,të Kastrioteve, dhe ruajtjen e zhvillimin e vlerave tona. Krijojmë sot shoqatën tonë "Çidhna dhe Kastriotët" për unifikimin e mendimit të shqiptarve rreth origjinës së tyre, meqë Sina dhe Kastrioti janë fshatra të Çidhnës, me të njeten popullsi, nga fiset e Çidhnës, me të njejtat tradita, zakone, kulture e nën-dialekt gjuhësor. Fisi i kastriotëve ka banuar në teritorin e Çidhnës, së paku nga shek. XIII, e deri në fillimshekullin e XVI, kur në vitin 1602 , në kuvendin e mbajtur në Dukagjin të Matit, ajo (Çidhna) përfaqesohet nga Jozef Kastrioti.

Pra per rreth 3 shekuj pa ndërprerje, territori i fshatrave Kastriot, Sinë dhe Çidhën është banuar nga familje të Kastriotëve. Në Çidhën, është zhvilluar Beteja e parë e Skenderbeut kundeër Turqve; Beteja e famshme e Torviollit dhe masakra më e madhe në histori kombëtare, e kryer nga Sulltan Mehmeti i II ne vitin 1466.

Ai pasi dështoj, në rrethimin e dytë të Krujës, në kthim, kreu për hakmarrje ndaj Skënderbeut, masakren e Çidhnës, në vendlindjen e heroit, ku masakroi 8-12 mijë banor, gra ,femije, burra e pleq Dibran.

Gjej rastin të theksoj se kastriotët nuk lindën dhe nuk mund të lindnin në një truall bosh, pa të kaluar kulturore dhe historike. Në Çidhën janë vendbanime të lashta Ilire, të banuara nga fisi i Penesteve (Një fise i përmendur luftëtarësh). Në vitin 168 para krishtit, po në Çidhën, u zhvillua beteja e mbretit maqedon, Perseu, për pushtimin e qytetit Oene, (Ndodhur në anë të një lumi nga prapa tij një male i lartë) që sipas mendimit të shumicës së historianeve, është qyteti i lashtë i Çidhnës, me një mbrojtje natyrore të jashtëzakonshme e cila fillon, që në portën hyrëse, me emrin Kepi i Qytetit.

Edhe Perseu, gjithashtu masakroi banorët e saj, për humbjet e mëdha që pesoi gjat luftimeve. Rezisteca Çidhnake, kunder Turqve, vazhdoi edhe pas vdekjes së Skënderbeut, me luftrat e Sal Demajrit, Sali Nokës, Vesel Lushës, Selman Alis, Halil e Llan Kaloshit etj ,deri në shpalljen e pavarësis.

Edhe pas shpalljes së pavarësis, luftrat e Çidhnakëve, për mbrojtjen e trojeve, vazhduan pa ndërprer në vitet 1913,1918 dhe 1920, kundër Serbve dhe 1915 kundër Austriakve, si dhe rezistence e vendosur kundër pushtimit fashist, si dhe kundër regjimit komunist, me luftën e Fush-Alijes dhe luftën e Sinës ne vitin 1944, e me pas me rezistencën, e pa nderprër të zonës së Çidhnës, Çidhnakët, trashigojn një identitet të veçant, me cilësi të forta karakterin, trimerinë e besën, njerëz puntorë, të zgjuar dhe krenar, por gjithnjë me mase, pa e tepruar dhe të kujdesshëm në përgjigje e në reagime.

Njerëz që kanë respektuar mikun, dhe e kanë mbrojtur atë, por në natyrë pak egoist, e zeliqar për njeri-tjetrin, cilësi kjo jo fort e këndshme, që na takon ne brezave të ri ta ndryshojmë, për mire në karakterin tonë ,për tu pershtatur me ritmet e zhvillimit qytetar dhe Europian.

Cermonit tona të dasmave dhe të fatkeqesive, kanë veçantit e veta, që duhen ruajtur dhe trashëguar tek pasardhësit.

ODA Cidhnake, një tempull i vertet i demokracise Dibrane, duhet të sherbej si model edhe per parlamentet e vendeve më demokratike të Botës, kur them këtë jam i sigurte që aspak nuk e kam zmadhuar dhe nuk e kam tepruar, vetëm se me vjen keq që modeli i bisedës dhe i diskutimit në odën Çidhnake, nuk njihet nga të tjerët, dhe po harrohet edhe nga vet ne.

Unë sot duke folur para Çidhnakve të mij, ndjehem keq, se ndoshta nuk arrije ta transmetoj ate mesazh dhe nuk mund ta krijoj atë emocion, që me krijonte mua muhabeti në odat tona.

Pleq të moshuar, pa shkollë por me një zgjuaresi natyrale të rrallë, diskutonin me orë e ditë të tëra për politikën dhe historin, për traditat, e të drejtën zakonore, për raportet me mikun dhe me shokët,por pa e tepruar dhe pa fyer askënd, e duke dëgjuar seicilin që dëshironte të përfshihej, duke të mbajtur të mbërthyer, si me magji pas bisedës.

Keto e shumë vlera të tjera, intelektualët Çidhnak që për fatin tonë, tani janë të shumtë dhe të kuliteteve të larta si , profesor, doktor, studiues e shkrimtar të talentuar, e shumë të tjerë me MCS, apo biznesmen shumë të suksesshëm, tashmë i bëjn nder jo vetëm Çidhnës por gjith vendit.

Me to ne mund të krenohemi, me të drejtë, prandaj ata e kanë për detyrë t'i studiojnë e bëjn të njohura për vendin. Natyra e mrekullueshme e krahinës dhe e bjeshkëve tona, si dhe gjeomonumentet e shumta natyrore, monumentet, pasurit ujore me burimet e mrekullushme, kanioni i Setës, kalatë e pastudjuara, afërsia me liqenet e Lures, prodhimet BIO, bujqësore e blegtorale, si dhe numri i madhë i ngjarjeve historike, munde ti perdorë shoqata jonë si argumente dhe mundesi per zhvillimin e Turizmit malor, të kombinuar me atë historik.

Këto pasuri e vlera të mëdha duhen mbrojtur fuqishëm nga shoqata për, të mos lejuar dëmtimin e mjedisit, dhe gjithë ekosistemit të zonës, dhe vetem me aprovimin e saj mund të lejohet, zhvillimi i bizneseve në harmoni me natyrën e në fuksion të zhvillimit të harmonizuar, me studime të plota në interes te krahines sonë.

Me mbështetjen e tre komunave të zonës së Çidhnës, shoqata duhet të kërkojë, që në kuadrin e 100 vjetorit të pavarësis edhe vendlindja e Kastriotëve, Sina të përfshihet në veprimtarit festive.

Vetë intelektualët e zonës, besoj se do jenë të gatshëm për të marr përsipër tematikën e një Sesion Shkencor, sipas pasionit dhe mundësive te seicilit, për ta realizuar në prag të nëntorit të ardhshëm.

Unë që pata sot nderin të flas para jush, kam rreth 6 muaj që bëj perpjekje për të bërë të mundur ngritjen e kesaj shoqate.

Dua të falenderoj të gjithë intelektualeët Çidhnak që me kanë mbështetur, për ta ngritur Shoqatën "Çidhna dhe Kastriotët" në veçanti grupin nismëtare, si dhe z.Ilir Krrashi e Përparim Noka, për kontributin në lidhje me procedurat juridike, për regjistrimin zyrtar të shoqatës në gjykat, si dhe intelektualin e biznesmenin Muhamet Bitri, për sponsorizimin e aktivitetit të sotëm dhe koktein.

Duke përfunduar, jam i kënaqur për kaq sa munda te bëj për afrimin e Çidhnakve, për kontakte më të shpeshta, me njeri tjetrin dhe ju uroj nga zemra suksese, drejtuseve të rinj të shoqatës që do zgjedhen sot.

E ndjej veten shumë të nderuar si Kryetar Themelus i kësaj shoqate, që gjithashtu sot po marr në dorë, për ta shpalosur para jush flamurin e shoqatës sonë, në krahë të flamurit tonë kombetar, si simboli që besojme së është, me afer së vertetës, me flamurin e derës së Kastriotëve.

Në mes të këtij flamuri ndodhet shqiponja dykrenare me krahë të mbledhur, zbuluar në vitin 2006, në murin e kishës pranë Kepit të Rodonit, nga një ekspedit arkeologjike Shqiptaro -Gjermane, ndërtuar nga vetë Skënderbeu, dhe ku ka qendruar edhe e motra e tij, Mamica Kastrioti.

Udhë të mbarë shoqatës sonë!

Fjala e hapjes në ceremoninë e themelimit të shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", datë 28 nëntor 2011

E ndjej veten shumë të nderuar si Kryetar Themelus i kësaj shoqate, që gjithashtu sot po marr në dorë, për ta shpalosur para jush flamurin e shoqatës sonë, në krahë të flamurit tonë kombetar, si simboli që besojme së është, me afer së vertetës, me flamurin e derës së Kastriotëve.

Rruga Arbërit nr. 68

portret



Mësuesi Petrit Bajro, misionar për mësimin e gjuhës shqipe

Nga: **HYSEN LIKDISHA**

Në një ditë me diell dhe plot shkëlqim të fund nëntorit të këtij viti, udhëtojmë drejt Dibrës së Madhe, thënë ndryshe "Sheheri" i Dibrës. Pasi kryejm formalitetet përkatëse në Doganën e Bllatës, vetëm 3 kilometra larg Maqellarës, marrim rrugën drejt Dibrës së Madhe, qytetit të lashtësisë, tregtisë, emigracionit, arsimit, kulturës, qendrës lidhëse të të gjitha trojeve etnike shqiptare nga lindja në perendim dhe nga veriu në jug.

PAK HISTORI. DIBRA E MADHE ME NAM TË MADH

Hulumtimet arkeologjike dhe historike të deritanishme konfirmojnë se Dibra është pasardhësi i qytetit të Doberos, prej nga rrjedh dhe emri i sotëm Dibër. Dibra ka qenë qendër e njohur tregtare dhe e artizanatit në të kaluarën dhe ka luajtur rol të ëndësishëm në historinë e këtij regjioni.

Emri i Dibrës përmendet që nga shekulli i pestë para erës sonë nga Herodoti, e më vonë në shekullin e parë të erës sonë nga Straboni dhe Plini. Këta përmendin fisin Ilir, të Doberëve, të cilët themeluan qytetin e tyre me emrin Dober. Ptolemeu në shekullin e dytë të erës sonë konfirmon në hartat e tija planin e qytetit të quajtur Dober apo Doberos dhe banorët e tij doberët.

Ky qytet ka qenë udhëkryqi kreysor i këtij regjioni nepër të cilin kalonte edhe Via Egnatia. Më vitin 1502 njihet si qendër e rëndësishme qytetare. Në vitet 30-40 të shek. XIX, ka afro 8400 banorë dhe 250 dyqane, dhe ishte një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike. Deri në vitin 1911 Dibra ka qenë një nga vendet më të zhvilluara në regjion si nga ekonomia, artizanatet, tregtia, ndërtimet dhe arkitekturën e saj të veçantë por edhe në planin kulturor e social. Në këtë kohe Dibra numëronte 11.000 banorë dhe 462 shitore. Por mbas turbullirave dhe luftave Ballkanike ky vend e humbi rëndësinë e vet. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, nën ish Jugosllavinë, Dibra e Madhe, qendra e shqiptarizmës, mbeti nga rajonet më pak të zhvilluara. Aktualisht numëron rreth 15 mijë banorë. Plaga e emigracionit ishte dhe ka mbetur për këtë qutet edhe pas viteve '90. Dibra e Madhe qendër e rëndësishme ku kryqëzohen rrugët që lidhin qendrat kryesore shqiptare si Prizren-Dibër-Strugë-Ohër-Manastir-Shkup-Tetovë-Gostivar-Dibër e Vogël-Tiranë. Padyshim qendër e Arbëris së lashtë së Shqipërisë etnike dhe gjeografikisht qendër e hapsirave mbarë shqiptare. Dibra e Madhe është qendra ku janë zhvilluar 9 beteja të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, pasi gryka e Radikës në lindje të këtij qyteti ka qenë porta kryesore e sulmit të osmanëve drejt Krujës. Dibra e Skënderbeut, Moisi Golemit, Iliaz Pashë Dibrës, Said Najdenit, Vehbi Dibrës, Qemal Ataturkut, Millosh Dibranit, Qemal Stafës, Ibe Palikuqit etj, padyshim që mbetet një nga kalatë e qendresës së shqiptarëve ndër shekuj. Por, qëllimi I ardhjes tonë në Dibër të Madhe, gjithsesi nuk ishte eksplorimi I historisë së Dibrës edhe pse ajo nuk mund të shmanget. Ditë më parë gjatë një vizite në Dibër të Madhe, një miku im regjizor-gazetar, Aqif Ademi, më mundësoi të njihem me mësuesin Petrit Bajro, që për hapjen e shkollave shqipe dhe mësimin e gjuhës tonë të bukur shqipe, mbetet një misionar i spikatur i shqiptarizmës në trevat shqiptare të ish Jugosllavisë.

PETRIT BAJRO, MËSUESI QË GJITHCKA E VURI NË SHËRBIM TË SHKOLLËS E GJUHËS SHQIPE

Me Petritin takohemi në shkollën ku ai punon aktualisht në Dibër të Madhe, e cila mban emrin e veprimtarit të shquar të lëvizjes sonë kombëtare, Said Najdeni, birit të këtij qyteti, që e zhvilloi veprimtarinë e tij për mësimin e gjuhës së bukur shqipe në zonën e Dibrës. Petriti krejt buzagaz dhe krenar na shoqëron për tek busti i këtij patrioti të madh që ndodhet në hyrje të shkollës. Shkolla me mjedise të bollshme dhe krejt funksionale ku nuk mungojnë as fushat sportive si dhe palestra, biblioteka, kompjuterat etj, e kishte pothuajse të gjithë personelin mësimdhënës të kombësisë shqiptare. Drejtori i kësaj shkolle, Pëllumb Frangu, na pret në zyrën e tij dhe pasi na shpjegon për punën që bëhet në këtë shkollë na qeras me kafe sipas zakonit të mikpritjes shqiptare të kësaj treve. Aty mësojmë dhe marrim një ftesë për pjesmarrje në portikun poetik që do zhvillohet në Pallatin e Kulturës. Zhvillimi i këtij portiku poetik ishte i përvitshëm në këtë qytet ku promovoheshin librat poetik të poetëve dhe shkrimtarëve nga të gjitha trevat shqiptare si, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali I Zi, Medvegja, Bujanovci, Presheva. Takimi ishte vërtet shumë i bukur dhe relaksues dhe të bënte vërtet që të ishe krenar për gjuhën dhe fjalën e bukur shqipe. Pas këtij aktiviteti, vonë në mbrëmje marrim rrugën për në shtëpinë e Petrit Bajros, në realizim të qëllimit të ardhjes tonë në Dibër të Madhe.

NË SHTËPINË E PETRITIT, NË MIKPRITJE TË TIJ

Shtëpia e Petritit, ndodhej në pjesën jugore të qytetit, në afërsi të liqenit ku dhe është ndërtuar H/Cderdhja e ujit e të cilit nis vërshimin e lumit të Drinit të Zi në tokën tonë duke shërbyer edhe si vijë kufitare ndarëse mes Shqipërisë dhe Maqedonisë. Shtëpia njëkatëshe në lagjen Uranik ishte e rrethuar me mur dhe ishte me oborr të bollshëm. Menjëherë sapo dëgjon zërin e motorit të makinës, del dhe na hap portën Hazbia, bashkëshortja e Petritit e qeshur dhe krejt nur, duke na ofruar kështu një mikpritje tipike dibrane. Na ofrohet mikpritja në një dhomë me hapsirë të bollshme dhe të ngrohtë. Ndërkohë që Hazbia shtron gostinë sipas zakonit për miqtë e ardhur nga Shqipëria mëmë, Petritit na njeh me kalvarin e vuajtjeve të tij dhe familjes, ku gjith jetën e tij active të punës e vuri në shërbim të shkollave dhe gjuhës shqipe.

Origjina e familjes së Petritit është nga fshati Macukull i Matit, vendosur para rreth 200 viteve në fshatin Konjarë buzë lumit të Drinit të Zi, për tu zhvendosur pas dy vitesh në fshatin Sollokiq ku dhe ndodhet kalaja e Moisi Golemit. Në këtë fshat, lindi dhe u rrit ai, duke kaluar një fëmijëria sa të ëmbël aq edhe e hidhur, pasi ish regjimi sllavo-komunist punonte për të rënuar cdo gjë shqipare, me qëllimin e vetëm asimilimin tonë tregon Petriti. "Kalova një fëmijëri të trembur, me trauma psikologjike, pasi e kishim të vështirë për tu shfaqur ashtu siç dhe ishim shqiptarë të pastërt. Fshati Sollokiq duke mos njohur asnjë lloj interesimi të ish qeverisë jugosllave për zhvillimin e tij, për çdo vit pësonte ulje të banorëve të tij për shkak të emigrimit. Aktualisht në këtë fshat nuk banon asnjë familje pasi të gjitha janë shpërngulur drejt zonave urbane dhe në emigrim. Një fat të tillë pësoi edhe familja Bajro, ku para 50 viteve u vendos në qytetin e Dibrës së Madhe. Kështu në fshatin e tij të lindjes, Petriti kreu vetëm shkollën fillore(tetëvjeçare), ndërsa atë të mesme gjimnaz e kreu në Dibër të Madhe. Shkollën e lartë pedagogjike e kreu në kryeqendrën kosovare, Prishtinë, ku dhe ndjea e tij atdhetare me fillesa në Dibër të madhe, njohu zhvillim e konsolidim të mëtejshëm, që e ktheu atë në të ardhmen në promotor të hapjes e mësimit të gjuhës shqipe kudo ku ai punoi si mësues.

PUNA SI MËSUES, BURGOSJA DHE NDALIMI I USHTRIMIT TË PUNËS SI MËSUES

Punën si mësues e nisi në Kosovën martire, në rrethin e Prizrenit, në shkollën e fshatit Planej dhe atë të Gjonajt në Hasin e Thatë afër malit të Pashtrikut, ku shërbeu deri në vitin 1972. Gjatë kësaj kohe, mori pjesë aktivisht në demonstratat që u zhvilluan në Prizren për vendosjen e flamurit shqiptar në shtëpinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjatë punës në Kosovë, ai mbeti gjithmonë aktiv dhe pjesmarrës në debate e demonstrate që bëheshin për Kosovën republikë. Pjesmarrja e tij aktive në këto demonstrata ra në sy të regjimit të kohës, i cili nuk qendroi duarkryq. Kështu për mësuesin e gjuhës dhe shkollës shqipe, vjen vendimi për transferimin e tij, duke e caktuar të punojë në fshatrat më të thellë malorë të zonës së Dibrës së Madhe, ata të Rekës së Epërme dhe të Poshtme, Zhirovnicë dhe Vërbjan, ku punoj për 9 vite radhazi. Por edhe kjo nuk e përkuli për asnjë çast mësuesin misionar patriot të gjuhës dhe shkollës shqipe. Ai ju vu punës më me shumë përkushtim për gjuhën dhe shkollën shqipe për fëmijët e kësaj zone malore të banuar nga shqiptarë, duke fituarkështu respektin dhe dashurinë e nxënësve dhe banorëve të këtyre zonave. Shkolla e Zhirovnicës ku mësonin edhe nxënës të nacionalitetit maqedos nuk u mundësonte nxënësve shqiptarë mësimin në gjuhën e tyre. Kjo e shqetësonte së tepërmi Petrit Bajron. Kështu mësuesi atdhetar, ju vu punës për mësimin e gjuhës shqipe edhe në këtë shkollë, duke mos ndaluar në këtë rrugë për asnjë çast. Rezistenca serbo-sllave e ish regjimit të atëhershëm në Jugosllavi nuk mund të binte në dakordësi me mësuesin Petrit Bajro. Hapja e shkollës shqipe në Zhirovnicë, thotë Bajro, ishte vërtet një moment historik për kohën dhe për banorët e Rekës së Epërme . Ndërkohë përndjekja e mësuesit nga ish punonjësit e sigurimit të UDB-së jugosllave kishte nisur me kohë që në Universitetin e Prishtinës kur ishte student, për të vazhduar me nisjen e punës në Prizren dhe tani në malësitë e Rekës, kur ai u bë promoter i hapjes së shkollave shqipe. Dhe hakmarrja sërbe nuk vonoi për mësuesin misionar. Kështu në një ditë të bukur mai, ku çdo gjë në malësinë e bukur dhe piktoreske të Rekës ishte zhytur në gjelbërimin e stinës, në shkollën e Zhirovnicës, ja behin policë sllavo-maqedonas, që prangosin në sy të nxënësve, mësuesin e tyre të dashur Petrit Bajro. Kjo natyrisht që i tronditi fëmijët dhe banorët e Rekës që aq shumë e deshën dhe respektuan mësuesin e tyre. Çdo gjë u duk se ra në heshtje dhe ndaloi, kur hekurat u vunë në duart e mësuesit që aq bukur shkruanin shkronjat shqipe. Madje u duk se ndaloi edhe zhurma e ujrave të kristalta të Radikës që zbresin flurimthi me melodinë gurgulluese të tyre nga malet e larta.

BURGOSJA NË TETOVË DHE NDALIMI I USHTRIMIT TË PUNËS SI MËSUES

Mësuesin atdhetar të shkollave e gjuhës shqipe, në trevat shqiptare t ëish Jugosllavisë, e mbyllin në burgun e Tetovës. Presionet dhe shantazhet ndaj tij ishin nga më çnjerëzoret. Ai akuzohej për nacioalizëm, irredentizëm, separatizëm e shumë izma të tjera. Në atë kohë ishte shumë e vështirë të jesh misionar për mësimin dhe hapjen e shkollave shqipe pasi regjimi i kohës në ish Jugosllavi punonte për asimilimin e shqiptarëve në trojet e tyre etnike, tregon Petriti.

Prokuroria kërkoi dënimin e tij me 9 vite burg, por falë ndërhyrjes së një miku të tij, fatmirësisht ai u dënua vetëm me dy muaj burg. Por, më e rënda në dënimin e tij ishte vendimi i gjykatës që ai të mos punonte në arsim deri sa të ekzistonte vetë Jugosllavia. Natyrisht që kjo masë e dhënë nga gjykata ishte edhe më e rënda për të, pasi e shkëputste atë përfundimisht nga nxënësit dhe shkollat shqipe që ishin dhe mbetën gjërat më të shtrenjta për të.

DALJA NGA BURGU, EMIGRIMI E VETMJA MËNYRË PËR MBIJETESË

Burgimi dhe heqja e të drejtës për të ushtruar profesionin e mësuesisë, e vënë shumë në vështirësi mbijetesën e familjes së Petrit Bajros. Bashkëshortes së tij, Hazbies, një grua me karakter dhe tepër fisnike, i bie një barrë shumë e rëndë, pasi krejt e vetme ajo duhet të kujdeset jo vetëm për fëmijët e saj dy djemtë, Gëzimin, Dritanin dhe vajzën e vetme Besën, por edhe për bashkëshortin në burg. Në të tilla kushte kur familja ishte totalisht e rrënuar ekonomikisht, me lirimin nga burgu, me vendosmërinë që e karakterizonte për të përballuar situata të rënda, mësuesi Petrit Bajro, vendos të emigrojë për në Amerikë për të punuar atje në tokën e bekuar, si shumë dibranë të tjerë, ku vetëm në Neë-York numërohen aktualisht rreth 15 mijë dibranë. Fillimisht vendoset në Neë-York, ku punon për tre vite në Bruklin. Edhe gjatë kësaj kohe, ai nuk u shkëput nga veprimtaria patriotike kombëtare, duke u treguar pjesmarrës aktiv në tubime, koncerte, demostrata e shumë e shumë aktivitete të tjera që organizonin shqiptarët e Amerikës. Bëhet anëtar dhe veprimtar i shquar i shoqatës atdhetare Dibrane, të Neë-Yorkut, e cila për kontributin e dhënë e dekoroi atë me medaljen e mirënjohjes me motivacionin: "Për kontribut të pa kursyer në drejtim të zhvillimit dhe afirmimit të arsimit shqiptar". Pas tre



Petriti me bashkëshorten, Hazbie

viteve në Amerikë, ai provon të punojë në Irak, Slloveni, Itali etj. Por, sa vinte dhe jeta larg familjes bëhej edhe më e vështirë për të, kur dhe fëmijët ishin rritur dhe kërkonin kujdesin e tij. Ndaj gjatë kësaj kohe ai provoi të punojë edhe si punëtor betoni, por ëndrra për nxënësit, shkollën, e gjuhën shqipe, nuk ju largua për asnjë çast.

VITET POS '90, SPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË, KTHIMI NË ARSIM

Ëndërra e Petrit Bajros për t'iu rikthyer arsimit edhe pse prej vitesh ishte veshur nga hiri, asnjë herë nuk ishte shuar në shpirtin e tij. Dhe kjo bëhet realitet vetëm pas viteve '90 me shpërbërjen e ish Jugosllavisë. Kështu misionari i shkollës dhe gjuhës shqipe, Petrit Bajro, i rikthehet sërish arsimit, falë përkrahjes së partive shqiptare në pushtet, ku emërohet mësues në Shkollën "Said Najdeni" të Dibrës së Madhe ku vazhdon të punojë edhe sot dhe pret të dalë në pension. Petrit Bajro në kompleksitetin e figurës së tij shquhet për sinqeritet dhe korrektësi, mikpritje e bujari sa ska më, humanizëm dhe largpamësi, ku zemra i rreh vetëm për Shqipërinë dhe bashkimin e trojeve shqiptare.

Pjesmarrës me kontribut të spikatur në shumë fusha të jetës, si arsim për hapjen e shkollave dhe mësimin e gjuhës së bukur shqipe, shoqata patriotike brënda e jasht vendit, kulturë, aktivitete sportive ku ka qenë lojtar hedbolli dhe futbolli në ligën e dytë të Maqedonisë, pjesmarrës po kaq aktiv edhe në strukturat për çlirimin e Kosovës, Përkundër kësaj pjesmarrje kaq aktive të tij në shumë fusha e veçanërisht atë të arsimit, bëhet e pakuptimtë dhe të lë një shije të hidhur që shtetarët shqiptarë të Maqedonisë asnjë herë nuk e vlerësuan atë qoftë edhe duke e emëruar drejtor në një nga shkollat në Dibër të Madhe edhe pse ai si pak tjetër kush e meriton një gjë të tillë. Por, mësuesin që së shpejti del në pension, fare pak e shqetëson një gjë e tillë. Edhe pse tani çdo gjë duket se ka shkuar në vendin e vet, ku vetë ai pret të dalë në pension faqebardhë dhe mjaft krenar duke mbetur pishtarë l arsimit dhe burim frymëzimi për brezat në Dibër të Madhe, krenari për të mbeten edhe fëmijët. Ata jetojnë e punojnë familjarisht nëpër shtete të Europës. Kështu Gëzimi jeton me familjen në Bolzano të Italisë, Dritani në kryeqytetin e Europës së Bashkuar, Bruksel dhe vajza Besa po në Bruksel ku vazhdon vitin e fundit të shkollës së lartë në fkultetin e albanalogjisë dhe gazetarisë, një vazhdim i punës së të atit, për lëvrimin e gjuhës së bukur shqipe.

NË VEND TË MBYLLJES

Kafenë e lamtumirës së kthimit, e pijmë në lokalin "Besa" që ndodhet në qendër të Dibrës së Madhe. Petriti që prej 24 orësh të qendrimit me ne më tepër ka folur për të ardhmen e shqiptarëve në Maqedoni edhe këto momente të fundit don që t'ia përkushtojë kësaj teme, që është dhe mbetet mjaft e preferuar për të. "Ndaj Dibrës së Madhe në veçanti dhe gjithë trevave shqiptare në Maqedoni, thotë ai, vazhdon po e njejta politikë si dhe para viteve '90-të. Po qe se kjo politikë ndaj Dibrës do të vazhdojë kështu pa asnjë lloj investimi serioz për të, ne shqiptarët nuk kemi të ardhme këtu. Fëmijët vetëm ikin duke marrë rrugët nëpër Europë e Amerikë dhe nuk investojnë këtu pasi nuk kanë garanci nga qeveria maqedonase. E vetmja shpresë e Jona është Shqipëria mëmë dhe ndërtimi i Rrugës së Arbërit, Edhe partitë shqiptare, në njërën prej të cilave militon edhe vetë Petriti, janë të "shitura", pasi nuk këmbëngulin për zbatimin sa e si duhet të "Marrveshjes së Ohrit", e cila nuk zbatohet si për ngritjen e flamurit, gjuhën shqipe, etj. Shqetësimet tona, vijon në fjalën e tij mësuesi misionar i gjuhës shqipe, Petrit Bajro, bëhen edhe më të mëdha po të kemi parasyshë shpërthimet histerike të nacionalizmit maqedonas këto kohët e fundit në një ndeshje miqësore futbolli mes Shqipërisë e Maqedonisë, të luajtur në Prilep, të cilat po përhapen në gjithë Maqedoninë. ■

Shkolla shqipe në Grykën e Vogël

Nga: **ZABIT LLESHI**

Shkolla Shqipe në Grykën e Vogël, është kurorëzimi me sukses i luftës për autonomi e pavarësi, në çerekun e fundit të shekullit të XIX, i popullit të Dibrës i prirë nga rilindasit tanë, ndër të cilët edhe ato dibranë si Said Najdeni, Selim Rusi, Shaqir Daci, Ramiz Daci, Hasan Ballanca, Josif Bagëri, Nuredin Xhemalce, Aziz Mezenxhiu etj.

Abdyl Frashëri gjatë udhëtimit të tij për në Dibër në tetor të 1878-ës, në Kuvendin e Shupenzës shtron problemin e mësimit të gjuhës shqipe si nje nga detyrat kryesore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ai u shpjegoi pjesëmarrësve edhe rrugët që do të çonin drejt hapjes së shkollave. Mësimi shqip dhe hapja e shkollave do të bëhej krahas luftës për mbrojtjen e trojeve nga synimet shoviniste te fqinjëve ndaj vendit tonë.

Në vitin 1884 filloi të dalë në Stamboll gazeta "Drita", e cila më vonë u quajt "Dituria". Kjo gazetë do të bëhej një nga armët më të forta në duart e patriotëve shqiptarë, për të ndriçuar mendjet e atdhetarëve, për të zgjuar ndërgjegjen Kombëtare e për të ndihmuar në Bashkimin Kombëtar.

Më 1886-ën, Sami Frashëri shkruan tekstet themelore të shkollës: Abetaren e Gjuhës Shqipe; Jani Vreto Arithmetikën (Numratoren) dhe Mirëvetinë (mësime morale), duke përgatitur edhe kushtet për hapjen e shkollave.

Më 1887-ën, me iniciativën dhe përpjekjet e Samiut, Naimit, Jani Vretos, shumë patriotëve brenda vendit dhe të shoqërive patriotike shqiptare të mërgimit u çel në Korçë e para shkollë shqipe me fizionomi të plotë kombëtare laike e demokratike.

Shkolla shqipe në Dibër është e lidhur me Said Najdenin, i cili gjithë jetën ja kushtoi mësimit, e shkollës, shqipe, rritjes se ndërgjegjes kombëtare për liri e pavarësi, dinjitet e përparim shoqëror. Prandaj ra në kontakt dhe u lidh dhe me Naim e Sami Frashërin, Ismail Qemalin e patriot të tjerë në Stamboll duke gjetur te ata një frymë atdhedashurie të sinqertë që ndikoi fuqishëm në formimin e personalitetit të tij.

"Dëshira për ti shërbyer mëmëdheut dhe çështjen kombëtare, u bë një nga qëllimet kryesore të Saidit të ri"[1]

Shkolla Shqipe në Dibër te Madhe u çel më 1888 nën kujdesin e Said Najdenit; Ashtu si dhe në Kosovë mësimi shqip në Dibër bëhej herë në mënyrë individuale, herë të fshehta dhe ilegale. Çdo shkollë shqipe që hapej shikohej si një rrezik i madh për Perandorinë Osmane, prandaj ato ishin të ndaluara e të shpallura si antifetare. Shkolla u mbyll megjithatë u bë një qendër patriotike e antiosmane. Në fillimet e muajit Korrik të vitit 1890 në Dibër shpërtheu një kryengritje e armatosur kundër pushtuesve osman. Natyrisht, dhe si gjithnjë turqit dërguan ushtri të mëdha kundër kryengritëse, të cilët nuk deshën të paguanin taksa dhe të qeveriseshin nga turqit. Kjo kryengritje filloi dhe në Kosovë.

"Shqiptarët nuk mund të mendojnë ndonjë fuqi mbi fuqinë e tyre, pushtet mbi pushtetin e tyre. Kështu që as pushteti, as pushka, as prangat nuk kanë mundur t'i frenojnë këto njerëz. [2]

Më 1893, Said Najdeni e hapi përsëri shkollën e Dibrës që pushtuesit osman e kishin mbyllur më 1888-ën. Saidi bëri përpjekje për të shtrirë aktivitetin e tij për hapjen e shkollave edhe në Malësi, në bashkëpunim me atdhetarët malësorë, si në Gollobordë (me Hoxhë Moglicën), në Grykë të Vogël (Teqen e Bllacës, me Isuf Tashën), në Zerqan (me Sheh Sulën), ne Homesh (me Mersin Demen) në Maqellarë, Dohoshisht, Brezhdan (me Isuf Karasanin) etj.

Kështu lufta për përhapjen e mësimit fshehurazi të gjuhës shqipe u shtri jo vetëm në qytet por edhe në zona të thella malore të krahinës se Dibrës.

"Në vitin 1894, një nga shokët e Said Najdenit, Shaqir Daci njeri me influencë në Dibër të Madhe, hapi në katundin Homesh një shkollë shqipe"[3]

Për ta patur më të lehtë shpërndarjen e librave dhe hapjen e shkollave shqipe në Malësi, Said Najdeni u lidh me familje patriotike të Malësisë së Grykës së Vogël, si me Demët, Lleshët, Dacët, e Camët. Me Markët bëri edhe një miqësi familjare"Na lypset miqësia e atyre fiseve për do punë që ju tashti si kuptoni" – shprehej Said Najdeni. [4]

Said Najdeni mbante lidhje të ngushta me shoqëritë patriotike si brenda ashtu edhe jashtë vendit nga ku siguroheshin librat dhe gazetat shqip, sidomos nëpërmjet Manastirit dhe Korçës, por edhe nga Bullgaria, prej Josif Bagerit nga Reka e Epërme e Dibrës etj. Patrioti vlonjat, Ibrahim Shyti, në kujtimet e tij thotë se e kam njohur mirë Said dibranin dhe i kam çuar mjaft libra shqip që vinin në dyqanin tonë nga Bullgaria e Rumania posaçërisht për të"

Në Shkurt 1899 në Dibër të Madhe besëlidhja e Dibrës në të cilën marrin pjesë më shumë se 1000 vetë, përfaqësues të shtresave të ndryshme të popullsisë, qytetarë, zanatçinj, tregtarë të vegjël, fshatare nga Dibra e Madhe, e poshtme, e sipërme me malet, Reka e Mati. Ky kongres mund të quhet edhe kongresi për themelimin e shkollave në Dibër. Për ketë qëllim me iniciativën e patriotëve dibranë u hartua edhe një kërkese për autoritet turke për njohjen e gjuhës shqipe dhe lejen për hapjen e shkollave shqipe në qytet dhe fshatra, duke marrë përsipër edhe vetë shpenzimet për hapjen e shkollave. Përfaqësues të Grykës se Vogël në kongresin e Dibrës ishin Tush Lleshi, Barjam Markja, Jashar Dema, të cilët kontribuan jo vetëm ditën e Kongresit me mbështetje, por edhe u angazhuan për shpërndarje të librave shqipe në Homesh, Zogje, Bllacë, Zerqan, Bulqizë, Luzni e Selishtë. Me format ilegale me përpjeke të përbashkëta, ndonëse pa pasur shkollë e mësues në Dibër brenda një kohe të shkurtër në fillim të viti 1899, mësuan të shkruajnë e të lexojnë shqip më shume se 300 veta. 5)

Në përgjigje të përpjekjes të patriotëve shqiptarë për hapjen e shkollave shqipe në Dibër, autoritete osmane vendosen të hapnin 100 shkolla të reja turke. Zemërimi i popullit ishte aq i madh sa që kërkoi largimin e prefektit nga Dibra. Sulltan Hamiti dërgoi forca te reja ushtarake për shtypjen e zemërimit popullor, filloi kontrollin e shtëpive, arrestoi patriotë, midis tyre edhe atdhetarin e shquar që luftoi për shkollën e gjuhën shqipe Hamdi Ohrin. Këto masa nuk i ulën patriotët dibranë, përkundrazi, i shumëfishuan përpjekjet, e rritën solidaritetin, ndërmorën masa e veprime konkrete për hapjen e shkollave në të gjithë krahinën, si dhe ndaluan hapjen e shkollave turke.

Jashar Zeneli së bashku me Isuf Tashen (Baba Isufi shërbeu në teqe të Bllacës), filluan mësimet e gjuhës shqipe në mënyre ilegale. Ajo u quajt shkolla tinëzare (e fshehtë). Autoritet osmane as që bëhej fjalë për të dhënë leje për mesimin e hapjen e shkollave shqipe.

Në marsin e 1902 Isuf Karasani në një tubimi në Pashkopi ku morën pjesë Sheh Sula për Gryken e Madhe, Jashar Dema e Bajram Markja për Grykën e Vogël etj, u vendos, që në zbatim të vendimeve të kuvendit të Dibrës (1899) të hapen shkolla shqipe në fshatrat që përfaqësonin.

Në pranverën e vitit 1905 Mersim Dema nën kryesinë e tij, mblodhi gjithashtu 9 malet në Gjurrën e Mazhicës për të kundërshtuar sulmin osman kundër shqiptarëve. Një prej vendimeve të këtij kuvendi ishte se "në Nëntë malet e Dibrës e në Topallti të hapen shkolla shqipe në frymën e kuvendeve të zhvillua me pare" 6)

Mersim Dema, Jashar Dema, Tush Lleshi, Barjam Markja, Jashar Zeneli, Isuf Tasha, Osman Lleshi, Shaban Cami, Dan Cami (një pjesë e mirë prej tyre autoritete të klubit "Bashkimit të Dibrës"). Ata zhvilluan një veprimtari të gjerë patriotike në shërbim të shkollës e të mësimit shqip në Grykën e Vogël.

Kongreset e Manastirit dhe të Dibrës, ne 1908 dhe 1909 shtruan problemet e reja e u morën vendime për zgjerimin e shkollave shqipe. Përgatitje e kuadrove mësues tashmë do të bëhej nga shkolla normale e Elbasanit. Në Dibër tashmë mësimi nuk bëhej në dyqane, por filluan shkollat. Qamil Daci, Ramiz Daci, Zenepe Qoku, Osman Leshi, Dalip Rusi, Aziz Mezenxhiu, Nuredin Xhemalce, Vehbi Xhidri, nuk mësonin në orët e vona me llambat e vajgurit por filluan të mësohen e të mësojnë legalisht.

Sipas dëshmive të shtypit në Kosovë, disa shkolla në Dibershq i mbylli vetë Tuhan Pasha me 1910. Qeveria e Xhonturqve të rinj, për shkak të kryengritje së përgjithshme, u detyrua të japë leje për hapjen e shkollave shqipe në Dibër, ndërmjet tyre edhe për Bllacës dhe në disa fshatra të tjerë të Grykës së Vogël. Gazeta "Liria e Shqipërisë" dt. 18. 1. 1912 shkruan "Në malci , në fshatin Ballcë" këto ditë do të hapet një shkolle Shqyp për djemtë, mësues është zgjedhur Jashar Bllaca ". Për shkollën shqipe në Grykën e Vogël kanë kontribuar jo vetëm intelektualët mësues por edhe familjet që trashëguan disa breza profesionin e mësuesit si Jashar Zeneli Bllace, Kurt e Ahmet Cami Viçisht, Haxhi Skënderi Gjoricë, familja e Demajve, Rakip Hoxha, Hamit Manjani (Homeshe), Abaz Xhafa (Kovashicë), Demir Leka, Sinan Rustemshi (Zogje), Mule Dumani (Stushaj), Cen Lila (Cerenec) etj.

(Vijon)

Referenca

1. Sotir Temo "Said Najdeni" fq 18
2. Shukri Rahimi "V. i Kosovës 1818-72 Prishtinë 1967" fq 79
3. Haki Stërmilli "Dibra në prag të historisë, Tiranë 1940" fq. 53
4. Djelmëria Dibrane, Dorëshkrim Vepër e cituar
5. Hysni Myzyri "Shkollat e para kombëtare shqipe Tirane 1978" fq. 142
6. Mois Murra "Merim Dema" fq. 36
7. Lutfi Turkeshi "Dibra ne shekuj" fq. 14

"RRUGA E ARBERIT"

merr kopjen tënde

eshte koha per tu pajtuar...
telefono: (04) 22 33 283





"Dëshmia e Gjeneralit", një libër me vlera globale

Nga **SHPËTIM CAMI**

Majfton të lexosh rreshtat e parë të reçen sës së Prof.Dr.Ylber Selës me të cilat fillon libri, dhe kupton që ke të bësh më një vepër me vlera globale ku ndërthuren të gjithë elementët kombëtarë dhe ndërkombëtar. Libri i botuar në tre gjuhë na jep përsëri një mesazh global. Ai shpreh respekt ndaj kombit të tij duke u shkruar në shqip, respekt ndaj shtetit duke u shkruar në maqedonisht dhe respekt ndaj botws globale duke u shkruar në anglisht.

Libri është një rast studimor i shkëlqyer për të studiuar "Të Drejtën Ndërkombëtare". Libri është një mësim shumë i mirë për qeveritë e shteteve jo kombe, qeveri të cilat duke qenë të një kombësie të caktuar tregohen jo të drejtë, të njëanshëm dhe të pabarabartë ndaj të tjerëve. Libri është dokument historik pa komente dhe emocione personale. Libri është një lutje për të jetuar në paqe se përndryshe ka luftë dhe luftën e pamë se çfarë prodhoi. Prodhoi liri dhe të drejta por me kosto maksimale, humbje jetë njerëzish të cilët nuk kthehen më midis nesh ndërsa shtëpitë dhe palatet ndërtohen përsëri.

Dhe jo vetëm kaq. Lufta shoqërohet më gjyqe kombëtare e ndërkombëtare si ky rast që na sjell në vëmendje Gjenerali ynë!

Libri është një apel për të gjithë ne që punojmë e jetojmë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni apo kudo që jemi që të përulemi me respekt ndaj kësaj historie, kryesisht të përgjakshme që na ka marrë bijtë më të mirë, më trima, më liridashës. Një histori që na ka konsumuar pafund energjitë tona intelektuale. Ne vazhdojmë të luftojmë ndërkohë na duhet të mësojmë dhe të konkurojmë me dije . Libri e reflekton këtë . Bëmë luftën dhe tani po e shkruajmë historinë jo si fitues por si heronj nga njëra anë dhe si historian nga ana tjetër, pa komente por me fakte historike dhe në gjuhën origjinale në të cilën është kryer procesi hetimor, duke i prerë rrugën çdo abuzimi dhe dezinformacioni për brezat e ardhshëm.

Gjenerali vazhdon të luftoj, por me tani me libra. Kjo është një fazë e re në të cilën ka hyrë Kombi shqiptar. Të luftojmë me dituri. Historia ka provuar se kjo është lufta më e mirë, është rruga më e mirë. Le të konkurojmë dhe të luftojmë edhe me dituri.

Libri është një sfidë ndaj Akademisë së Shkencave së Republikës së Maqedonisë duke treguar se shqiptarët janë të zotë edhe në fushën e dijes dhe së shpejti anëtar të saj. Numri i magjistrave, doktorëve të shkencës apo profesorëve shqiptar ka ardhur gjithmonë në rritje. Gjenerali na ka sfiduar edhe në këtë fushë. Ka magjistruar në një moshë që shërben si model frymëzimi për të gjithë brezat e rinj që janë ulur në auditorët e universiteteve. Kam qenë i pranishëm atë ditë magjistrimi. E kam ndjekur me vëmendje studimin shkencor. Erdhi rasti të evidentoj një element shumë të rëndësishëm të atij studimi për të cilën shkenca bashkëkohore po investohet shumë. Studimi përbëhej nga tabela dhe të dhëna statistikore. Konkluzionet shkencore nuk kishin asnjë emocion nga ato me të cilët ne shpesh abuzojmë. Konkluzionet ishin rrjedhime të bazës së të dhënave dhe statistikave zyrtare që flisnin vetë.

Ndërmjet rreshtave të këtij libri apo në përgjigjet e drejtpërdrejta kupton diplomacinë e përdorur nga Gjenerali, rreth disa çështjeve të mprehta që shkelin të drejtën ndërkombëtare apo që ngarkojnë me përgjegjësi persona të caktuar.

Gjenerali me dëshminë e tij na mëson edhe se si të mbrojmë veten dhe kolegët, si të mos mos marrim mbi vete përgjegjësi që nuk mundemi ti përballojmë, si të mos flasim për ato gjëra që nuk jemi profesionalisht kompetentë, si të mos gjykojmë pa fakte shkencore.

Personazhet e këtij libri janë njerëz të gjallë që i kemi midis nesh edhe sot. Gjenerali pranon të dëshmojë me shkrim duke botuar gjithë procesin gjyqësor dhe të rigjykohet, por tashmë jo në sallën e gjyqit në Hagë, por në sallën e bashkëluftëtarëve të tij, miqve të tij, familjarëve të tij . Ai pranon të rigjykohet dhe rikomentohet edhe nga kundërshtarët e tij. Edhe ky është një mësim i madh për ne.

Gjenerali na mëson jo vetëm me të shkruarit por edhe me të folurit, me qëndrimin, me ecjen, me vështrimin, me veshjen, ai është një model për mua, për ne, për fëmijët tanë.

Faleminderit Gjeneral Ostreni!



suksesi



Foto: B.Karoshi

Takim me kampionin e botës në Tai&Kikboks

"Flamurin shqiptar në zemër, atë gjerman në gjoks"

Ditën e premte, më 9 dhjetor 2011, ora 18.30 minuta, në Hotel Tirana International, u organizua takimi promovues i Kampionit të botës të saposhpallur në Tai&Kikboks në Mynih të Gjermanisë, Ismail "Joni" Keta, djalit nga Bulqiza, që aktualisht me famën e tij është bërë ikona e ringut profesionist në këtë sport. Në këtë promovim, Ismaili apo "Joni" sic e thërrasin gjermanët, nuk ka qenë i vetëm, por është shoqëruar edhe nga vëllai i tij Gjetan "Mike" Keta (Mikk Tayson) sic e thërret tifozeria gjermane ku edhe ai luan në sportin profesionist të boksit, ku sapo ka shënuar fitoren e 11-të të tij, duke u bërë kështu së bashku me vëllain e tij Ismailin "Joni", krenaria e Bulqizës që i lindi, Dibrës dhe mbarë Shqipërisë. Në këtë takim promovues me kampionët vëllezërit Keta, ku Ismaili sapo është shpallur kampion bote dhe vëllai i tij Gjetani ka shënuar fitoren e 11-të dhe lufton për tu bërë edhe ai kampion bote i boksit profesionist, kanë marrë pjesë qindra dashamirës, simpatizanë, miq dhe të afërt nga Bulqiza, Dibra dhe mbarë Shqipëria. Përshëndetën në këtë takim mjaft personalitete të sportit, kulturës, miq dhe dashamirës ndjekës të vëllezërve Keta. Mjaft emocione ngjalli për të pranishmit ndjekja në monitor e takimit final zhvilluar para pak ditëve në Mynih të Gjermanisë për titullin kampion bote, në Tai&Kikboks, ku Ismail "Joni" Keta, në tre raunde të zhvilluara me kampionin e Hungarisë, Jozef Ziklodi, i shkaktoi atij 5 nokdoën-e, duke fituar kështu gjerdanin e artë. Prof. Dok. Gudar Beqiraj, që kishte ndjekur ndeshjen në Gjermani, pjesmarrës në këtë takim promovues me kampionin e botës, pasi vlerësoi lart vlerat sportive të kampionit, tha se djali nga Bulqiza e mineralit të kromit ka aq këmbë të forta, a thua se i ka të kromuara ata me mineralin e vendlindjes së tij që ai aq shumë e don. Sa i fuqishëm e agresiv në boks, aq i butë në shpirt. Ismaili, tha më tej ai, është aq shumë mirënjohës, sa e bën atë më shumë se njeri. Është i mrekullueshëm, kështu besoj se janë të gjithë bulqizakët, e përfundoi fjalën e tij me shumë emocion Prof. Dok. Gudar Beqiraj. Përshëndetjet vijuan me radhë nga Tefta Radi, Vasil Bici, Prof. Dok. Mehmet Spahiu, dekan i Akademisë së Sporteve, Bajram Hoxha, drejtor i programacionit në TVSH, Perlat Musta,ish ikona e portës në ndeshjet sportive të futbollit me skudrën tonë përfaqësuese, Vasil Bici, drejtor i drejtorisë sporteve në MKRS etj, të cilët vlerësuan lart vëllezërit Keta jo vetëm për rezultatet e larta të arritura në ringun profesionist të sporteve, ku janë kampionë, por t ë tillë kampionë janë ata edhe në vlerat qytetare që shpalosin në ring, duke afirmuar e treguar se mbeten shqiptarë, që falë punës dhe sedrës sportive, mbërritën deri kiëtu. Të gjithë folësit që përshëndetën në këtë takim u fokusuan jo vetëm në arritjet spektakolarë të vëllezërve keta, por edhe në vlerat qytetare, njerëzore e patriotike, që ata shpalosin të trashëguara nga familja Keta, Bulqiza dhe gjithë Shqipëria. Është vërtet mbresëlënëse e krenari pa fund kur sheh kampionin Ismail keta që del e prezantohet në ring me flamurin shqiptar të varur si hajmali në gjoksin muskuloz e burrërror të tij. i binda gjermanët të mbaj flamurin shqiptar pasi ju thash atyre se këtë, flamurin shqiptar e kam si hajmali të varur në qafë që më jep forcë e guxim në fitore, tregon kampioni. Përshëndetën edhe përfaqësues të pushtetit local në Bulqizë zotërinjtë; Roland Keta, kryetar i Bashkisë Bulqizë, Hamit Dervishi, nënprefekt i rrethit Bulqizë dhe Fluturim Zeneli kryetar i komunës Fushë-Bulqizë, ku u lindën dhe u rritën vëllezërit Keta. Në fjalën e tyre ata vlerësuan vëllezërit Keta dhe në emër të të gjithë banorëve të trevës së Bulqizës, u uruan atyre mirënjohje dhe respect për punën dhe vlerat qytetare që manifestojnë. Me këtë rast kryetari i komunës Fushë-Bulqizë, i dha titullin "Qytetar Nderi" që këshilli komunal i kësaj bashkie u akordon vëllezërve Keta, që me punën e tyre janë krenaria e fshatit Kocaj ku u lindën, Fushë-Bulqizës, Bulqizës, Dibrës dhe gjithë Shqipërisë. Djemtë kampionë, vëllezërit Keta, nga fshati Kocaj i Bulqizës, që me famën e tyre kanë pushtuar botën, mes emocionesh pa kufi falenderuan të pranishmit për vlerësimin e arritjeve të tyre dhe premtuan për t'i cuar akoma edhe më përpara këto arritje. Gjetani fituesi i 11 ndeshjeve të boksit, jo vetëm ëndërron, por edhe premton për fitimin e titullit kampion në boks ashtu si i vëllai i tij Ismaili në Tai&Kikboks.

HYSEN LIKDISHA



Foto: B.Karoshi

Kryetari i komunës Fushë-Bulqizë, i dha titullin "Qytetar Nderi" që këshilli komunal i kësaj bashkie u akordon vëllezërve Keta, që me punën e tyre janë krenaria e fshatit Kocaj ku u lindën, Fushë-Bulqizës, Bulqizës, Dibrës dhe gjithë Shqipërisë.

cyan magenta yellow black



Foto: Bujar Karoshi

Poemë për qytetin tim

— Jua fal me dashuri bashkëqytetarëve të mi —

Nga: **ISLAM ÇENGA**

1

Lart nga Llaseni
Si një yllësi
Çelet mrekullia,
Në kurm e në shpirt
Vibron bukuria.
Me mollë në prehër nane
Me mall në sy zane
E sofër, raki thane
Më pret Peshkopia;
Si burrë me krenarinë
Si zonjë me bujarinë
E plak me mençurinë
Vendlindja ime
E shtrenjta ime.

2

Nënë e babë
Vëlla e motër
Dhe fis e xhins
E miq e shokë
Më presin sot
Rrugës së Pazarit
Në shëtitoren e Blirit
Në kroin e Korabit,
Ku për qindra vjet
Kojshi me kojshi u bëmë vëllezër
Në mort e në dasëm
E shart e dert
Si një familje e madhe
I ndamë bashkë
Gëzimet e hallet
Dhe kokrrën e kripës
Dhe agun e dritës
Dhe grushtin e misrit
Dhe strehët e pragjet…

3

E marr mësysh bukurinë,
E ngroh në sy hijeshinë
Nurin që mban në shpirt
Zemrën që shfaq në dritë…
Në lagjen e Vjetër
Shtëpitë shtyhen,
Shtyhen udhët
Përpjetës së Dublecit,
Çati më çati pikojnë street,
Dritare më dritare bien gjethet
Sokak më sokak
Plakat me namazbeze
Fole në fole
Turtujt çelin vezët…

4

Shtëpi të gurosura me baltë
Me hatulla të moçme lisi
Ju ngjiten kodrës
Për të kursyer fushën,
E arë e farë
E lis e kullotë,
Për të qënë
Më pranë burimit
Zjarrit më pranë
Më afër dashurisë
Në ballë të historisë
Në fluturimin e shpresës
Të ndershmërisë, të djersës
Gurit e lumit më pranë
Mikut në të mirë e në hall
E hasmit përballë
Vëllezërit e mi dibranë.

5

Dublec e Dobrovë,
Kallavere e Pazar
Emra që mësuam më parë se abetarja;
E gishtat e vrarë
Në gurë e sokak
Para feminisë
I sakatova,
Me balsamin tënd i shërova
E u burrërova
E trashëgova;
E njësh u bëra me ju vëllezër
Me ju binjak
Me shpirt
Me gjak

6

Ju të dashur
Të shtrenjtë
Të butë në shpirt
Në gjak të sertë,
Sy më sy
Fjalë më fjalë
Zemër në zemër
Lëkurë me lëkurë
Të shoh më sheh
Në ditët me mjergull
Në natën me terr;
Me njërën dorë, Korabit
Mbi vetull i ul qeleshën,
Me tjetrën, Drinin e Zi
Në gushë e përkëdhel.

7

Bashkë nuk e ndamë
Urretjen, as cmirën
As xhelozinë
E sherr e pabesinë;
Ishim bonjak me ty
Me vetvetën
Ndamë bashkë të keqën
Dhimbjen
E vdekjen
Bukën e krypën
Lindjen dhe rritjen
Plakjen dhe rininë
E me okë e pa pre
E falëm dashurinë.

8

Më shumë jam se s'jam
Më shpesh vij se iki
Më shpejt rinohem se plakem
Me ju
Me ty;
Në trungun e blirit
Kam inicialet e mia
Në gurët e themelit
Kam emrin tim
Të fisit
Të xhinsit
Kam zemrekun e jetës
Dhe kapilarët e gjakut
Trarët e shtëpisë
Dhe rrasat e pragut.

9

Sonte erë e vjeshtës
M'a degdisi gjumin
Në degët e blirit
Në lendët e lisit;
Shilarëse fëmijëria
Përkundet me yjet…
Me shkumës në dorë
Profesor Qaniu
Profesor Alliu
Musa e Lavdrim
Spartak e Kujtim
Genc, Fitim, Bashkim
Zhulal e Prapaniku
Babë Hasan e Baba Lym
Të tjerë, e të tjerë të prorë
Si meteorë
Krijuan meteorë.

10

Në silueta fisnikësh
Në bronx hënë e plotë
Kodra e Tërshana
Vëllezërit Isaku
Bardullët e Xhombullët
Vraniçët e Kalecët
Lazimet, Kallaveret
Leka e Përlekët
Stojkët edhe Vleshët
Sojli e shehërlerë
Më zgjasin një gotë
Më hapin një derë
Më çelin një portë
Më falin një botë…
Dhe bëre histori
E shkrove histori
Si rrallë kush, zemërprush
Për vatan e për nder
Sokol e skifter
Burrë si shkëmb i sertë
Mal si plak i urtë
Trimëresha ime.

11

Hashashin e mallit
Paskam pirë që në fëmijëri
E përsëri
Pranë moshës së tretë
Në polenin tënd
Hashash malli pi
E më thumbon bleta jote
Por mjaltin në koshere
Me nektar perëndish
M'a shtron
Në sini
E mira e ime,
Zemërbardha ime.

12

Në të gjitha stinët
Në të gjitha motet
Erë ftua e mollë
Shpërdan kurmi yt
Djersa, mundi, mendja
Nëpër Shqipëri;
E s'the kurrë u lodha
Nuk the kurrë plaç
Me dorën tek balli
Nga dhimbja
Nga malli
Me lofkën tek djali
Zemërdhëmbshura ime.

13

Një tufë mëllage
Tek ti i mblodha
Një tufë mimozash
Për ty i solla
E shumë përshëndetje
E tungjatjeta
Mëngjezëve e netëve
Hijeshojnë udhët
Fisnikërojnë njerëzit
Pragun e sokakun
Dhe gurin dhe plisin
Fjalën dhe qeshjen
Dhimbjen e qëndresën
Të thjeshtën dhe besën
Vendlindja ime
E shtrenjta ime.

14

Më shumë jam
Se s'jam
Më shumë vij
Se iki
Më shumë rinohem
Se plakem
Me Ju
Më Ty
Moj fisnikja jonë Peshkopi.

vjersha

Elegji për Dibrën

Nga: MENTOR HOXHA

....U shua zëri yt i fortë e gjëmimtar
Emri të përmendet rrallë e më rrallë
Dikur të kish në gojë çdo shqiptar
Tani dhe dibranët më pakëz kanë mallë.

Humbi zëri yt i fortë e gjëmimplotë
Nuk dëgjohet më në Media e kuvend
Dikur parlamentit këndoje si një zog
Tani në harresë e zi mbuluar krejt.

Askush më për ty nuk po mendon
Trupi yt po shuhet pak e nga pak
Nuk di si duron dhe si jeton
Kur bijtë e tu i sheh të ikin larg.

Ti ke mbetur pa vajza dhe pa djem
Ti -mburoja dhe zemra e Shqipërisë
Ndaj nga kjo zemrën e kam helm
Unë poeti i dhimbjes dhe i dashurisë.

-Ku janë ata mijra e mijra dibranë
Që bënë historinë e Shqipërisë?
Në Dibër ushtritë më barbare ranë
Por kurrë nuk u shua dielli i lirisë.

Ishte kryedibrani Gjergj Kastrioti
Së bashku me treqind dibranë
Që erdhën nga Turqia me fuqi baroti
Dhe zjarrin e lirisë ndezën në vatan.

Më pas Iljaz Pashë Dibra në ditët e egra
Kur Shqipërinë e priste copëtimi
Nga qielli shqiptar ra porsi kometa
Dhe mbarë Shqipërisë dha kushtrimin.

Por...,dhe në shekujt që rrodhën më pas
Zëri i Dibrës u shfaq si vetëtima
Në çdo derë Skënderbejë e Iljaz Pashë
Se nënat dibrane lindin vetëm trima.

...Edhe më vonë kur erdhi Pavarësia
Në kullën vlonjate ndrin Nikollë Kaçorri
Si djalin më të mirë që kish Shqipëria
Nënkryetar të qeverisë kuvendi e zgjodhi.

Por s'di pse sot kaq emërhumbur mbete?
Pse zëri yt si buçimë më nuk vjen?!
Apo të mundon dhimbja ndër vete
Që nuk i ke më pranë këto djem.

Varfëria në trup si murtajë të ka rënë
T'i preu gjunjët, shpresën dhe zërin
Emrin e mirë që të parët kanë lënë
Dibranët e sotëm ta zvordhën të tërin.

Ç'bëjnë bijtë e tu në administratë?
Përse heshtin shtetarë e biznesmenë?
Ato të shohin si një qyp me mjaltë
Vijnë të të vjelin kur oreksi u vjen.

Të duan veç për vota Dibra ime!
Ty që ke mbetur kockë e lëkurë
Ndaj zgjohu me shpejtësi vetëtime
Dhe fatin tënd kërko si dikur....

Mos u tremb Dibra ime, nënoke plot nur
Ja, Mentor Hoxha për ty e ngriti zërin
Ti që tonelata gjak dhe për flamur
Mund të rrëzosh dhe rruzullin të tërin.

Ja...,unë poeti, i pari jam në radhë
Kur zëri yt të buçasë anembanë
Dil e kërko fatin tënd të bardhë
Nand Malet e Dibrës akoma gjallë janë.



Foto: Bujar Karoshi

Pikëtakim "Rruga e Arbërit"

Nga: DRITE ADEMI, Basel

Zbardhur erdhi mëngjesi sot,
Rrezet e Diellit pështërisin
Udhëtimin...
...matanë bregut...
Portat hapur
Kali i Bardhë pret urdhërin e Zotit
Uratën prej Qiellit...
Pikëtakim:
"Rruga e Arbërit" numër 2011
Dasma:
Tek "Kulla e Gjergjit"
Do të bëhet kanjushe,
Më the...
Mos harro
... dhe dymijë e dymbëdhjetë pranverat aty do të çelin!
Lumenjtë
...tok me ne vallen
... do të hedhin
Deri në Jon!
Kënga e malli
Atë ditë do të jehojnë
Deri në Prizren e Janinë...
... e një kupë të Qiellit
Unë Teutë me lule dafine
Cep më cep oborrin shtruar...
Kurorë imazh Ilirie...
... e ti Yllo...
Xhamadan amanetin e Dymijë e Dymbëdhjetë brezave!
Në sy të Shqipes
.... Pikëtakim "Rruga e Arbërit" numër 2011-të!



Fabula nga Iliaz Bobaj

Miku i gazetës dhe një ndër lexuesit e rregullt të saj, shkrimtari dhe poezi Iliaz Bobaj, na ka sjellë disa fabula për botim, me rastin e Vitit të Ri.

Me këtë rast, redaksia falenderon poetin, dhe me këtë rast, duke botuar fabulat e tij, u urojmë gjithë lexuesve në emigracion, Gëzuar Festat!

KUAJ DHE KALORËS

Të vetmit kalë, që s'i mungon kurrë tagjia,
është kali i bështëm i mbretit.
Të vetmit kalë, që s'i mungon kurrë kalorësi,
është kali me shalë i pushtetit.

Kali i dytë, ndryshon nga kali i parë:
shpesh e kalërojnë aventurierë të marrë.
Kali i parë, nga i dyti ndryshon gjithashtu:
shpesh e kalërojnë mbretër pa tru.

VENDI I MERITUAR

Thërrisnin ca miza,
në shpatijen e malit:
-Kemi pushtuar,
fundbishtin e kalit!

Një flutur, që rastësisht i dëgjon:
-Keni zënë vendin,
që u takon.

DHELPRA KËSHILLON DRERIN

Dhelpra i jepte këshilla drerit,
të sapoemëruar në detyrë pushteti:
-Në punë bëj ç'të duash, s'bën zarar,
për punën s'pyet kush, e ndreqi s'e ndreqi,
as aftësinë se vë kush në kandar.
Veç vër vath në vesh një këshillë,
në do ta mbashë detyrën e pushtetit:
mos i dil kundër kryetarit të partisë!
Lëre mënjanë krenarinë që kanë drerët,
sillu urtë e butë, ul kokën si të tjerët!

E SOTMJA

E sotmja kish rënë në mendime thellë.
Njerëzit thanë:
-Vret mendjen,
si do jetë e nesërmja.
Ajo psherëtiu pikë e vrer:
-Më dhembin plagët që më la e djeshmja.

ATË E BIR

-Baba, më thuaj, nga e tërheqin njerinë?
-Nga dora, bir, pse si është puna?
-Unë kam dëgjuar mamin që thotë:
"Burrin tim e tërheqin nga hunda''.
VENDI I PARË

Dikur,
ndesheshin e vërteta me gënjeshtrën.
(Luftonin për vendin e parë të dyja).

Sot,
në vend të parë ka dalë hipokrizia.

PRINDËRIT VLERËSOJNË NJERI-TJETRIN

Burrë e grua kishin një djalë.
S'ia kursyen kujdesin
dhe djali po rritej, po bëhej i mbarë.
Por siç ndodh me këdo në jetë,
edhe ai kish huqet e vet.
Në të tillë raste,
e ëma përgjigjen majë gjuhës kish gati:
-Ç'fëmijë kokëfortë,
kokë e këmbë si i ati!
I ati, si flakë shpërthente nga brënda:
-Ç'dreq karakteri,
njëlloj si e ëma!

Krushqit e çuditshëm

XHAFER MARTINI

1 Gjon Ketën e thirri pashai, por ai nuk i shkoi.

- Nuk kam punë me pashain, po pati ai me mua, le të vijë, - i tha atij që i pruri fjalën.

Gjon Keta njihej për burrë mentar dhe trim. Kur njerëzit morën vesh përgjigjen që i ktheu pashait, thanë që ai e kishte humbur urtësinë, se nuk i flitej të parit të Nëntë Maleve me atë gjuhë. Po pashai u ngrit dhe i shkoi në derë Gjonit. Ai kishte punë me Gjonin dhe jo Gjoni me të.

- Të dua për të marrë nusen e djalit te veziri i madh, - i tha pashai. - Ke njëmijë lira vetë, treqind lira për secilin që do të vijë me ty.

- Si është puna, pasha, se ju bëni baltëra dhe kërkoni t'ua përthajë Gjoni.

- Nuk kam bërë baltëra, kam vepruar si çdo burrë malësie, edhe pse jam pasha e kam tagrin që të mos veproj kurdoherë ashtu. Ia kërkova vezirit vashën për djalin sipas të gjitha normave kanunore, dhe ai më bëri mik për qejf. Kjo ka ndodhur dhjetë vjet më parë. Tani që nusja është bërë për ta marrë, se është njëzet vjeç, nuk ma jep. I kam çuar dy herë krushqit në derë. Veziri u ka çue terziun, u ka qepur petka të reja, i ka kthyer të veshur e të mbathur, por pa nuse.

- Nga ishin krushqit? - e pyeti Gjoni.

- Ishin nga Valkana e Madhe. Nuk ma mori nusen Valkana e Madhe, të ma marrë Valkana e Vogël, të ma marrësh ti që je burrë mentar dhe trim. Do ta bësh apo jo?

- Do ta bëj, pasha, por as për ty, as për lirat e tua. Do ta bëj për Valkanën, për nderin e saj. Por ti, pasha, nuk e meriton sakrificën, se gjithë djemninë i fute në dhè, i vrave e i preve për Turqinë. Ku t'i gjej djemtë që t'i marr me vete? Ku t'i gjejë ata burra që hanin hekurin me dhëmbë?

Pashai uli kokën, se ajo që thoshte Gjon Keta ishte e vërtetë. Kishte vrarë dhe kishte prerë për hesap të Turqisë dhe me ushtarët e saj. Tani i duheshin burrat, por ata ishin nën dhè.

Gjon Keta mori tre vetë përmbrapa: Draf Bërdafin, Gjergj Savën dhe Vuksan Cenin. U tregoi detyrën që kishin për të kryer dhe i mbajti atë natë në shtëpinë e vet. Këta zemrën e kishin të fortë, por trupin të dobët. Trimit i duhet edhe zemra, edhe krahu. Ato kishin vetëm njërën, zemrën.

Gjon Keta i ngriti natën, u hoqi para dhe i çoi në malin e Mosullit. Kishte edhe tri orë për të zbardhur drita. Zanat e Malit laheshin ende në liqen. Ato i kishin lënë rrobat ndanë bregut. Rrobat e tyre jo vetëm nuk duheshin prekur, por as nuk duhet të shikoheshin drejt.

- Sytë në tokë, burra, - u tha Gjon Keta dhe u veçua prej tyre. Hipi në një majë kepi. Thirri dikë. Nuk merrej vesh se me kë bisedonte ashtu, se zëri i vinte i shqimët. Erdhi Zana e vet dhe i qëndroi pranë. Pastaj Gjoni bashkë me Zanën zbriti te tre burrat që ende rrinin me sytë në tokë.

- Këtij t'i japësh veshë për të dëgjuar ç'bëhet në qendër të tokës, - i tha Gjoni Zanës duke treguar Draf Bërdafin. - Këtij t'i japësh sy për të parë delen e zezë në mes të natës në malin më të dendur, - i tha Gjoni Zanës duke treguar me dorë Gjergj Savën. - Këtij t'i japësh forcë për të ngritur një shkëmb të madh dhjetëmijë okësh,- i tha ai Zanës duke treguar me dorë Vuksan Cenin.

Gjon Keta u fal dhe u përshëndosh me Zanën duke iu përulur asaj sikur të ishte mbretëreshë. Ajo ishte më e bukur se çdo mbretëreshë, më e fuqishme se të gjitha mbretëreshat bashkë.

- Po të kesh nevojë për mua, më thirr prapë, o Gjon Keta, - i tha ajo. - Mua njoftomë kur të kesh hall të madh, për ndonjë hall çfarëdo, ke vashat e mia.

Gjon Keta prapë u përul para saj dhe u tha edhe tre të tjerëve që të përuleshin në të njejtën mënyrë. Ata të tre nuk e bënë shumë hijshëm, por, sidoqoftë, e bënë me zemër. Dhe Zanat zemrën vlerësojnë.

Ende nuk kishte zbardhur agimi, kur Gjon Keta i çoi tre burrat tek varrezat e katundit. Dukeshin vetëm kryqet tek koka e secilit. Ca varre ishin të rinj, mbuluar me dhè të freskët, kurse në shumë prej tyre kishte mbirë me kohë bari. Thaju në vjeshtë dhe gjelbëro në pranverë. Nuk dihej sa mote kishin kaluar, se dheu mbi varre ishte bërë tokë e ngjeshur.

2 Gjoni thirri me emër Gjon Dukën. Draf Bërdafi, Gjergj Sava dhe Vuksan Ceni mbetën pa mend kur u hap varri e prej tij doli një burrë i madh, mjekërbardhë, flokëbardhë, me dy sy të mëdhenj, që sikur lëshonin shkëndia. Tiparet e tjera nuk i dalloheshin.

- Gjon Duka, të dua me vete bashkë me trimat që ke këtu. Mos i merr të gjithë. Zgjidh më të mirët. Do të shkojmë t'i marrim vashën vezirit të madh.

- Më ke përmbrapa, Gjon Keta, - tha Gjon Duka.

Me kaq u ndanë nga Gjon Duka.

Kur të katër burrat zunë rrugën e madhe, Gjon Keta nxori fletën e shqipes nga xhepi i kajukes dhe e ngrohu nën eshkën që ndezi me uror. Vjen një shqipe e stërmadhe që me krahët e saj mbulonte një hektar vend.

- Dua katër kuaj të bardhë, - i tha Gjoni asaj.

Shqipja iku fluturimthi nga ana e bregdetit. Ata që e shoqëronin, kujtuan që Gjoni nuk u mor vesh me shqipen, por, pasi bënë një orë rrugë në këmbë, u dolën para katër kuaj të bardhë, të ngjashëm me njëri-tjetrin.Të katër hipën në kuaj dhe morën rrugën për nga veriu. Ec e ec dhe nata nuk po sosej. Draf Bërdafit, Gjergj Savës dhe Vuksan Cenit u dukej sikur po erresohej më shumë. Kuajve, për çudi, nuk u dëgjohej trokthi. Ata ecnin butë-butë si mbi një ranishte, ndonëse rruga ishte gjithë gurë dhe shkrepa. Kurrë nuk kishin parë kuaj që të ecnin ashtu, lehtë, sikur nuk shkilnin në tokë.Gjergj Sava, megjithëse në gjysmerrësirë, po kqyrte me kujdes këmbët e kalit të vet. Kalit sikur nuk i zinin këmbët në tokë. *Mos më bëjnë sytë*, tha me vete Gjergj Sava, megjithëse ai kishte sy që shikonte delen e zezë në malin më të shpeshtë. Jo, nuk i bënin sytë: kali e prekte tokën, por fare pak, me thua. Dhe kuajt e tjerë, bënin ashtu. Zot, o Zot, tha Gjergji me vete, ne nuk po ecim, po fluturojmë.

Para u doli një kënetë me ujë të ndenjur. Hëna dhe yjet sikur ishin këputur nga kupa e qiellit dhe kishin rënë në kënetë, kaq shumë dritë kishte. Këneta kishte shumë ujë, se kërkund nuk shihje një fije shavari ose ndonjë bimë tjetër që rriten në ujëra të ndenjura, jo të thellë. Duhet të dredhojmë udhën, ishte gati t'i thoshte Gjon Ketës, por ky ia mbajti drejt, përmes kënetës. Tre të tjerët pas tij. Kuajt ngrinin stërkala sikur po ecnin mbi një vijë uji, jo në dy-tri metra thellësi. Ecnin në sipërfaqe, pa u zhytur në ujë. Kuajt i solli shqipja, tha me vete Gjergji, prandaj nuk ishte çudi edhe sikur të fluturonin. Përderisa kishin ndodhur plot çudira të tjera, pse të mos ndodhte edhe kjo?

Si mbaroi këneta, kalorësit me kuajt e bardhë dolën në një lëndinë. Tashti nga të gjitha anët kishte pyje të dendura dhe rruga nga veriu ishte e zënë prej tyre. Gjon Keta u ndal dhe nuk dinte nga t'ia mbante. Kështu, të paktën, iu duk Gjergj Savës.

- Pa vështro thellë, Gjergj, nga duhet të kalojmë, - i tha Gjon Keta. - Ndalu dhe shiko përtej pyjeve.

Gjergjit nuk i besohej që e kishte fituar këtë dhunti. Por, kur u ndal dhe përqëndroi shikimin tutje, në hapësirën e errët, në pyll sikur ra dielli. Pylli ishte vërtet i madh, me drurë të shpeshtë dhe të gjatë, shumë të gjatë, por nuk ishte i pakalueshëm. Në mes të drurëve kishte plot udhë të holla. Pas pyllit, ishte rruga e gjerë e me kum të butë, por që nuk dihej ku të çonte.

- Na hiq para, - i tha Gjon Keta Gjergj Savës.

Ky nxori kalin e vet në krye të karvanit të vogël. Në të dyja anët e asaj rruge syri nuk të shikonte gjë tjetër veç fushë djerrë, me një bar të imët, të parritur. Kishte pak lisa nëpër të, ata dukeshin si shkurre. Ecën tri orë pa pushuar dhe pa thënë një fjalë.

Veziri ishte lajmëruar që një shpurë e vogël, por e çuditshme, me kuaj që fluturonin, ishte nisur për t'i marrë vashën me ia çue pashait të Valkanës. Veziri nuk i nënvlerësonte gjërat. Dha urdhër që ushtria të zinte të gjitha shtigjet nga mund të shkohej në kështjellë. Dha urdhër t'i kapnin kalorësit dhe t'i vrisnin në vend. Vezirit do t'i çonin vetëm kokat e tyre. Doli ushtria, sipas urdhërit të tij dhe zuri çdo shteg dyzet kilometra larg kështjellës.

3 Dita kishte dalë, por nuk shikohej asgjë, se një mjegull shumë e dendur e kishte bërë bardhë botën. Burrat ecnin kuturu të orientuar nga kuajt. Në mjegull nuk kishte aftësi të shikonte as Gjergj Sava.

- Nuk shikoj asgjë, jam si ju, - tha ai.

- E di, - tha Gjon Keta.

Kuajt fluturuan midis mjegullës së dendur dhe, sa më shumë kalonte koha, aq më shumë merrnin lartësi. Dolën në qiellin e pastër ku vezullonte dielli. Mbas një ore u ndalën në majë të një kepi.

- Dëgjoj zhurmë, - tha Draf Bërdafi, - vjen nga ana e kështjellës.

- Çfarë thonë?- e pyeti Gjon Keta.

Draf Bërdafi u përqëndrua më mirë, kuptoi shumë më tepër se sa herën e parë.

- Është ushtria, - tha ai i sigurtë, - oficerët japin urdhëra që të zihet çdo rrugë dhe çdo shteg nga mund të hyhet në kështjellë.

Gjonit iu kujtua se për të shkuar në kështjellën e vezirit kishte një shteg që nuk mund të zihej nga ushtria, se ishte shumë i ngushtë, kalonte në mes të maleve, ku, në anën e djathtë ishte gremina treqind metra, kurse, në të majtën, shpati thikë i malit, edhe ai rreth treqind metra i lartë. Aty nuk mund të hynte ushtria. Ai shteg ishte bosh, i pazënë. Po si mund të mos e dinin oficerët e vezirit një gjë të tillë? Ishte e pamundur të mos e dinin, se ata e njihnin vendin me pëllëmbë. Mund të kishin lënë një skuadër ushtarësh për t'i prerë rrugën shpurës së vogël.

- Shiko, Gjergj, nëse është i zënë me ushtarë edhe ai shteg, - i tha Gjon Keta atij.

Gjergj Sava nguli shikimin në atë drejtim, nga ishte shtegu. Ai tha që shtegu nuk ishte i zënë me ushtarë, por me shkëmbinj të mëdhenj, që nuk mund t'i ngrinin as njëqind burra po të bëheshin bashkë. Kuajt fluturuan në atë drejtim dhe, pas gjysmë ore, u gjendën para shkëmbinjve që ushtarët i kishin rrokullisur nga maja e malit dhe kishin zënë udhën e ngushtë.

Kuajt i kishin bërë orët e fluturimit. Ata këndej e tutje vetëm mund të ecnin si të gjithë kuajt e tjerë. Gjoni e dinte që kuajt kishin vetinë për të ecur pa shkelur në tokë një natë e një ditë, kurse ata kishin dy ditë dhe dy net që po udhëtonin.

- Kape një gur dhe provoje,- i tha ai Vuksan Cenit.

Vuksanit iu duk budallallëk që të matej me atë shkëmb sa një shtëpi përdhese, por, kur e kapi, iu duk i lehtë, sikur të ishte prej letre. E shtyri teposhtë dhe shkëmbi përfundoi në greminë. Kështu veproi edhe me shkëmbinjtë e tjerë. Rruga ishte e lirë. Ata të katër po i afroheshin kështjellës. Gjergj Sava vuri re se në të gjithë bedenat kishte roje dhe ushtarë me shumicë. Ushtria ishte lajmëruar që shpura e vogël kishte kaluar në ngushticën që ishte zënë me shkëmbinj. Kështjella ishte alarmuar se si mund të ndodhte një gjë e tillë nga katër vetë. Nga majat e bedenave ata panë se shpura arriti në Fushën e Gjerthit. Veziri i njoftuar për të gjitha këto, mendoi se kishte të bënte me djaj dhe jo me njerëz. Ai dha urdhër që t'u prisin patjetër udhën dhe kokat atyre njerëzve. Vetëm kur të shikonte katër kokat e tyre të prera, do të ndihej i qetë. Nuk ishte puna se nuk do të jepte vashën, që e kishte fejuar sipas të gjitha rregullave.Tani ai po kuptonte se ishte i sulmueshëm dhe i asgjësueshëm. Kur ushtria e tij nuk mund të ndalte katër vetë, si mund t'u bënte ballë qindra dhe mijërave? Ushtria nuk kishte ç'të bënte tjetër veçse të rrethonte plotësisht kështjellën nga jashtë. Po kjo mund të bëhej vetëm pesë kilometra pa ardhur tek muret e saj. Nëse ata do të fluturonin, si kishin fluturuar deri tashti, edhe kjo masë ishte e kotë. Megjithatë, nuk kishte mbetur gjë tjetër për t'u bërë.

Në pyllin e Vranjerit, nga e majta, u dëgjua një zhurmë marramendëse sikur po shembeshin qiell e tokë dhe po binin poshtë në luginë. Zhurma nuk ishte as si e shtrëngatës, as si e bubullimës, as si e shtënë me topa të kalibrit të madh, por si të gjitha zhurmat bashkë, si shungullimi dhe

4 dridhja e çdo gjëje në natyrë. U dukën mijëra hije të bardha (dukeshin si njerëz të veshur me pelerina), që marshonin drejt ushtrisë së vezirit. Nga një herë dukeshin si tufë e madhe resh në qiell, pastaj, reja zhdukej, dhe gjëma dhe rrëmeti merrte rrugët tokësore. Në çdo kaçubë e drizë kishte një pelerinë të bardhë. Ushtarët e vezirit qëllonin, por nuk i vrisnin dot; hijet e bardha përparonin dhe ishin gati t'i kapnin nga grykët e pushkëve.

- Është ushtria e Gjon Dukës, - tha Gjon Keta, - nuk jemi vetëm.

Mbas dy orësh, duke iu afruar ushtrisë së vezirit, ushtria e bardhë, që përparonte rrugë pa rrugë, herë në tokë e herë në qiell, herë në formacion luftimi, herë në formë grumbujsh të vegjël, të shkapërderdhur, krijonte një frymë të akullt, që vraponte për nga kështjella me vrapin dhe forcën e një uragani. Ushtarët dhe rojat nuk qëndronin dot tek bedenat e kalasë: një pjesë binin poshtë, nën muret e saj, kurse një pjesë braktisnin detyrën dhe fshiheshin nëpër qoshe për t'u mbrojtur. Uaragani nuk la gjë pa shkulur. Lisat dhe pemët e tjera shkuleshin me lehtësi si qepë të njoma dhe fluturonin rrënjëpërpjetë duke tmerruar njerëzit. Dera e rëndë e kështjellës që dëgjohej tre sahatë larg kur mbyllej, krenaria e tre ndërtuesve llkovas, që kishin përzier hekurin, tunxhin dhe çelikun bashkë, fluturoi nga menteshat dhe u përkul sikur të ishte një llamarinë e hollë, e ndryshkur. Njerëzit e bardhë, të vdekurit me qefina veshur, siç i quajtën kështjellarët, u afroheshin ushtarëve dhe ua zinin pushkët nga gryka. Kështu ua bënin guximtarëve, se të tjerët, dhe këta ishin shumica, i kishin hedhur armët me kohë dhe shtriheshin barkazi, në shenjë dorëzimi, që të mos i rrëmbente tufani e t'i përplaste diku. Sikur të mos mjaftonin gjithë këto rrëmete dhe tërmete, mijëra shqipe vërdalliseshin në hapësirën duke e zënë pothuaj gjithë qiellin me krahët e tyre. Në fund, tërë ushtria e vezirit u ndodh para portës së madhe të hapur, por ngaqë ishin me shumicë dhe ngaqë donin të hynin brenda përnjëherë, u bë një gjurulldi e madhe dhe shtypën njëri-tjetrin.

Kështjella ra, megjithëse asnjë ushtar i ushtrisë pushtuese nuk hyri brenda mureve të saj. Madje hijet e bardha u temtisën diku larg. Shtrëngata e uraganit të erës dhe të reve, të gjithçkaje që mund të bënte zhurmë, pushoi papritur. Nuk kishte më sulm dhe batërdi, por kështjella kishte rënë. Askush nuk shfaqte shenjën më të vogël të kundërshtimit.

Gjithë kjo rrëmujë dhe zallamahi ishte shkaktuar, si e kishin kuptuar të gjithë në kështjellë dhe jashtë saj, ngaqë ushtria e vezirit të madh, me urdhër të tij, kishte dashur të vriste dhe t'u merrte kokat atyre katër kalorësve që kishin hipur në kuaj të bardhë, dhe po i drejtoheshin kështjellës.

Katër kalorësit me Gjon Ketën në krye kishin zënë kepin e Vijës së Malit dhe qëndronin aty. Tre kalorës, me flamurë të bardhë në duar, po shkonin drejt tyre. Si u afruan nja dyzet- pesëdhjetë metra, thirrën:

- Pushojeni luftën, se jemi njerëz të paqes.

- Ne nuk po luftojmë. Veziri ngriti qindra dhe mijëra ushtarë kundër katër burrave, - tha Gjon Keta.

- I ngriti, se nuk deshi që ju të vini në kështjellë, por tani ju fton si miq dhe do t'ju nderojë dhe respektojë pa masë.

- Afrohuni të bisedojmë, - u tha Gjon Keta tre kalorësve. - Ne si miq u nisëm të vinim, se miq jemi.

Vetë zbriti poshtë në lëndinë, kurse Draf Bërdafit, Gjergj Savës dhe Vuksan Cenit u tha të mos lëviznin nga vendi pa u bërë ai një shenjë. Qëndroi nën hijen e një shelgu dhe tre kalorësit erdhën dhe u përulën para tij. Njëri, që duhet të ishte kryesori, zbriti nga kali e iu paraqit Gjon Ketës:

- Jam i dërguari i vezirit të madh. Ai do të dijë ç'qëllim ka ardhja juaj në kështjellë.

- Jemi krushq,- tha Gjon Keta. - Kemi ardhur në emër të pashait që të marrim nusen. Asgjë të keqe nuk kemi ndërmend.

- Po të jeni krushq, të dalim dhe t'u presim si krushq, si ka traditë shqiptari. Nuk është nevoja të vini me ushtri.

5 - Ne ashtu ishim duke ardhur. Ju na zutë rrugën, ne i dimë planet e vezirit dhe mos kërko të na thuash të kundërtën. Po të kishte veziri mendjen me na pritur si miq, ne si miq do të vinim, rrugës që ka caktuar Allahu.

- Jeni krushq, në të drejtën tuaj, të vinin udhës së madhe si krushq, - tha kalorësi.- Ushtria do të largohet, dhe rrugën do ta keni të lirë. Këto janë fjalët e Vezirit.

Muzgu po binte me shpejtësi. Gjon Keta me tre shoqëruesit e vet u nis dhe iu afrua portës së madhe të kështjellës. Re të mëdha të zeza, si turma kavalerie, rrinin herë në një cep të qiellit, pastaj dilnin në një cep tjetër, pas një ose disa minutash, grumbulloheshin mbi kështjellë sikur t'i sillte dikush me dorë.

Gjon Keta hyri në portën e madhe vetë i katërti. Nuk kishin bërë as dhjetë hapa, kur vargu i tyre u shtua edhe me shtatë burra të tjerë, veshur po me ato rroba, si malësorët e krahinës. U bëmë njëmbëdhjetë, tha me vete Gjon Keta, sa duhej të ishin krushqit për të marrë nusen.Vuri re që i pari i tyre ishte Gjon Duka. I njihte edhe të tjerët, që kishin vdekur brenda këtij dhjetëvjeçari, madje disa, kishin vdekur njëzet vjet më parë. Gjon Duka kishte marrë ata që i ishin dukur më të përshtatshëm. Të gjithë ishin shumë të zbehtë, të dobësuar, pa mish në faqe dhe u vinte era dhè. Më i fundit i tyre kishte një thes të madh të mbushur plot. Me çfarë, nuk dihej.

Veziri nuk kishte dalë vetë për t'i pritur, por njerëz për pritje kishte boll. I futën në odën më të madhe e më të mirë dhe u dhanë kafe e duhan. Ata u çuditën kur panë se asnjëri prej tyre nuk ishte i armatosur. Kuajt e tyre, të gjithë të bardhë, shkrofëtinin në oborr. Kuajt nuk i kishin ngrënë torbat me urov që u kishin vënë.

Në një odë tjetër, pesë gjashtë konaqe larg asaj ku u rrinin krushqit, veziri kuvendonte me njerëzit më të afërt:

- Tani që i futa në dorë, edhe këtyre do t'ua bëj si të tjerëve, nuk do t'ua jap nusen.

Thirri terzinjtë dhe u tha:

- U merrni masën dhe neser të kenë nga një palë tirq dhe koparanë të re.
- Si urdhëron, - tha kryeterziu.

Pas gjysmë ore ai ishte me metër në dorë te Gjon Keta dhe krushqit e tjerë.

- Urdhëri i vezirit është t'ju bëjmë nga një palë rroba të reja, - tha kryeterziu duke iu afrua Gjon Ketës.
- I kemi rrobat me vete,- tha Gjon Duka.
- Ku i keni?- pyeti kot terziu se nuk ishte aty për të bërë pyetje.

U ngrit një nga njerëzit e Gjon Dukës dhe shprazi thesin e madh në një këndë të odës. Ishin njëmbëdhjetë qefina, krejt të bardhë dhe të pastër. Ai që u ngrit për të zbrazur thesin, (në fillim burrë i zakonshëm, me shtat mesatar), erdhi duke u zgjatur, duke u zgjatur, dhe i zuri koka në tavan, megjithëse tavani i odës së vezirit ishte tetë metra i lartë. Kryeterziut i ra të fikët dhe u rrëzua mbi qilim; ata që shërbenin në odë, morën hov dhe dolën jashtë. Qëndruan me miqtë vetëm dy djem të rinj, që nuk kuptonin çfarë po ndodhte, por edhe ata rrinin si në ferra.

- Këto janë rrobat tona, - u tha Gjon Keta djemve të rinj. - Po nuk morëm nusen, do të veshim këto dhe jo rrobat që do na bëni ju.

Kryeterziut i lëshuan një ibrik me ujë dhe mezi erdhi në vete. Ai që hapi thesin me qefina, ishte ulur. Dukej si të gjithë të tjerët. Kryeterziu doli jashtë dhe pas disa minutash ishte në odën e vezirit të madh, të cilit i tregoi për krushqit e çuditshëm, njerëz që kanë udhëtuar me qefina për kreje, njerëz që, po të donin, zgjateshin dhe bëheshin tetë metra. Njërit i zuri koka në tavanin e odës. Veziri e quajti zemërpulë kryeterziun, por fjalët e tij i mbështeti edhe Faik Beu që kishte dalë vrik nga oda, sa kishte parë që njeriu zgjatej e zgjatej… Ai njeri, tha me vendosmëri Faik Beu, po të donte bëhej sa një lis. Të gjithë ata, bëjnë ç'të duan…

Veziri thirri njerëzit e tij më të afërt dhe më të shquar, këshilltarët dhe dashamirët, për të vendosur se ç'duhet të bënin me këta krushq që u kishin hyrë me zor në kështjellë dhe, si e kishin ndarë mendjen, do të dilnin të vdekur prej saj, nëse nuk merrnin nusen për t'ia çuar pashait.

- Ata duken si të vdekur që janë ngritur nga varret,- tha Faik beu. - U vjen era dhè. Të futin frikën kur i shikon. Unë bëj be në Zotin që ata janë ngritur nga varret.

6 Të gjithë heshtnin. Këshilltari i parë i vezirit ishte njeriu më i autoritetshëm në kështjellë. Atij i dëgjohej fjala me respekt të madh nga të gjithë, madje edhe nga veziri, që kishte bërë si kishte thënë ai, dhe nuk i kishte dalë kurrë keq.

- Do t'i vrasim,- tha ai.
- Po qysh t'i vrasim?- pyeti veziri.- Po t'i besojmë Faik beut, atëherë…

Këshilltari i parë shpërvoli buzët sikur donte të thoshte se me mendjen e Faik beut nuk shkonte as në …

Këshilltari i dytë që të mos mbetej prapa të parit, tha:

- T'u helmojmë ushqimin. Të mos derdhim gjak.
- Kur të dalin në oborr për të marrë nusen me vete, t'i vrasim të gjithë,- tha këshilltari i tretë.

Këshilltarit të parë iu desh të fliste dy herë.

- Vezir i lartë, - nisi ai ligjërimin me tonin që e përdorte kurdoherë kur kishte probleme të vështira për t'u zgjidhur. - Sonte bisedo me ta sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Tregohu i dashur. Për t'u hequr çdo dyshim që ushqimi nuk është i helmuar, ha në një sofër me ta, duke marrë i pari në tepsinë e përbashkët, ku do të vihet gjella e parë. Neser bëjmë gati nusen dhe ua japim. Pritën ua nxjerrim te Kroi i Qyqes, se aty është vend i përshtashëm. I vrasim dhe marrim bijën tonë prapë në shtëpi. Kështu duhet bërë kjo punë.

- Kështu do të bëjmë, - i tha veziri i vendosur.

Veziri hyri në odën e krushqve.

- Na falni për mosdijen dhe nxitimin ,- tha veziri duke vështruar Gjon Ketën në sy. - U bë si u bë, ne miq jemi, dhe neser në mëngjes vasha ime vjen nuse me ju, të shkojë atje ku e kam fejuar me dëshirë.

- Paç ymër dhe emër të madh si e ke, vezir i lartë, - i tha Gjon Keta duke e vështruar në sy.

Gjon Duka dukej si prej dheu. Veziri ia qepi sytë dhe nuk ia ndante. *Ku e kam parë këtë njeri?* - pyeste ai veten. A thua është Gjon Duka i Fushës së Vgjerrë ku ushtria ime luftoi me karadaklinjtë dhe ky la nam për trimëri? Por nuk ka si të jetë Gjoni se ai u vra në atë luftë. Sigurisht është ndonjë që po i ngjaka kaq shumë atij. Duke e pasur mendjen tek Gjon Duka, veziri u ndje ngushtë; harronte edhe fjalën ku e kishte lënë. Kjo vinte nga momente të shumta hutimi. Të jetë ngritur Gjon Duka nga varri?! Sa gjëmë për mua, tha me vete veziri dhe u drodh, kur njohu edhe Prelë Palin që rrinte në krah të Gjonit aty në vallen e burrave. Edhe ai kishte qenë në luftë me kralin. Edhe ai ishte vrarë në luftë. Mirë se për Gjonin po më bëjnë sytë, por për Prelën jo, ky është bash Prelë Pali, tha me vete veziri dhe u hutua krejt.

Ngjarja kishte rrjedhur kështu: veziri i çoi fjalë pashait të Valkanës që ta ndihmonte në luftë kundër karadaklinjve. Pashai i çoi dyqind burra, pika e djalit. Midis tyre ishin edhe Gjon Duka dhe Prelë Pali që mbetën të vrarë. Pikërisht nga kjo ndihmë, veziri e bëri mik pashain e Valkanës, duke i dhënë vajzën për djalin. Pastaj rrodhën ngjarje të tjera…Pashai i Valkanës donte të bëhej më i njohur tek sulltani sesa vetë veziri i madh. Kështu, rast pas rasti, miqësia e tyre erdhi duke u ftohur, derisa mbërriti në këtë ditë.

Paska të drejte Faik beu, mendoi veziri i madh dhe e mblodhi veten. Duhet të jem shumë i kujdesshëm. A i duhej dhënë të njohur Gjon Dukës dhe Prelë Palit apo jo? Kjo pyetje nuk e linte të qetë. Duhej për të dashur, por a mund t'i thuash tjetrit që je ngritur nga varri?Ku ka bërë vaki kjo?

Asnjë nga ata të shtatë që dukeshin të zbehtë, pra, as Gjon Duka, dhe as Prelë Pali, nuk folën asnjë fjalë. U shtrua darka dhe veziri i madh, ndryshe nga ç'kishte bërë përherë, u ul në sofër të hante bukë me miqtë e largët. Lugën e parë me tasqebap e mori vetë në sahanin e përbashkët. Në çdo gjellë ai merrte i pari që t'ua hiqte miqve çdo dyshim për ushqimin.

Në sofër ishin shtatë vetë: Gjon Keta, Draf Bërdafi, Gjergj Sava, Vuksan Ceni, veziri dhe dy këshilltarët e tij, i pari dhe i dyti. Shtatë burrat e tjerë, me Gjon Dukën në krye, u radhitën nëpër lëkura dhe shilte dhe thanë që ishin të ngrënë.

-Krushqit nuk ndahen, - tha veziri i madh.

Kjo ishte e drejtë: vërtet krushqit nuk ndaheshin as në sofër dhe askund tjetër.

- Na ka ndarë puna, - foli për herë të parë Gjon Duka.

7 Vezirin e mbuluan djersë të ftohta. Ishte zëri i përhershëm i Gjon Dukës.

Mbas darke erdhi kafja. E sollën me ibrikun e madh, që merrte dyzet kafe. Filxhanin e parë hyzmetqari, ia mbushi vezirit. Kur ishte duke ia dhënë në dorë, Gjon Keta ia kapi dhe e mori për vete.

- Kafja e parë i jepet mikut, - tha ai për të justifikuar veprimin që bëri.
- Mos, bre, nuk e pata për të treguar mosrespekt, - tha veziri i madh.
- E dimë përse e bëre, - tha Gjon Keta.
- Për çfarë e bëra, meqë e ditke?- e pyeti veziri dhe ia nguli sytë e mëdhenj dhe të zinj.
- Për të na hequr merakun, e more. Po ne e dimë se nuk do na helmoni me kafe dhe ushqim.

Veziri i madh u trondit thellë nga fjalët që dëgjoi, por prapë e përmbajti veten.

- Dera ime nuk ka helmuar kurrë miqtë, madje as armiqtë kur i ka pasur brenda,- tha veziri.
- Keni zgjedhur tjetër mënyrë për të na zhdukur,- tha Gjon Keta.

Veziri kësaj here filloi të dridhej sikur ta kishin futur në ujë akull të ftohtë, pastaj, në çast, e mbuluan djersët.

Dy burra nga të vetët e kapën nga duart dhe, duke e mbajtur sikur të ishte i plagosur, e nxorën jashtë. Thirrën doktorin. U ngritën e dolën nga konaku edhe dy këshilltarët e vezirit të madh. Mbetën vetëm ata që shërbenin.

Aty nga e vona, kur krushqit kishin pirë edhe dy kafe të tjera dhe kishin ndezur kushedi sa cigare duhan, erdhi këshilltari i parë i vezirit dhe u tha:

- Na falni se u shqetësuam edhe ju, por vezirin e madh, i dhashtë Zoti ymër, e kap nganjëherë kjo lloj sëmundjeje. Tani është më mirë dhe ju uron që të kaloni një natë të qetë. Neser në mëngjes, pa zbardhur drita, nusen e keni në kalë.

I nxorën nga oda e pritjes për t'u treguar odat ku do të flinin. Gjon Duka me të vetët u zhdukën dhe nuk u panë nga shkuan.

- Po të tjerët, ju qetë shumë, - thanë dy burrat që shërbenin duke pasur parasysh shtatë të tjerët me Gjon Dukën në krye.
- Ikën, kanë shtëpitë këtu afër,- tha Gjon Keta.

Gjon Ketën e zuri gjumi sa vuri kokën në jastëk. Kështu fjetën si të vdekur edhe Gjergj Sava e Vuksan Ceni. Draf Bërdafi ndejti duke përgjuar.

Gjergj Savës i doli gjumi heret në mëngjes. U ngritën edhe të tjerët dhe, si lanë sytë, u çuan ibrikun me kafe. Veziri hyri në odë, i përshëndeti me ngrohtësi dhe u çudit mbasi më shumë se gjysma e krushqve mungonin. Ai kishte marrë kafen dhe po e pinte veç kur pa Gjon Dukën, Prelë Palin dhe pesë të tjerët, në vendet që kishin mbrëmë në odë. Nuk u panë nga hynë.

- Ç'është kjo punë kështu, - tha veziri duke iu dridhur dora. Ai po bënte përpjekje që të mos i derdhej filxhani i kafes dhe të mos e kapte sëmundja si një natë më parë.
- Çfarë të çudit, o vezir i madh?- e pyeti Gjon Keta.
- Kam pasur një trim të rrallë në luftë me Karadakun, bile dy: Gjon Dukën dhe Prelë Palin. Këta të dy që kemi këtu, u ngjajnë shumë atyre të dyve, por më duken më të vjetër dhe shumë më të zbehtë se ata,- tha veziri, duke treguar me dorë Gjon Dukën dhe Prelë Palin.
- Edhe mund të jemi ata që thua ti, vezir i madh, - tha Gjon Duka.
- Si mund të jeni?- pyeti i habitur veziri.- Ata u vranë në luftë. I varrosëm aty ku ranë, se nuk kishim mundësi tjetër.
- Hiqe pritën nga Kroi i Qyqeve,- i tha Gjon Duka vezirit të madh pa e parë fare në sy.
- Ç'thua, more?- e pyeti veziri dhe e uli filxhanin e kafes në tabak që të mos i derdhej në prehër.
- Ai di çfarë thotë, vezir, - i tha Gjon Keta vezirit.

8 - Nuk ka kurrëfarë prite tek Kroi i Qyqes. Me këto çudira që shikoj dhe dëgjoj, kuptohet se nuk mund të ketë kurrëfarë prite - tha veziri i madh.- Ju kam miq për kokën e miqve dhe nusen e keni gati ta merrni, por më parë, dua t'u bëj nga një dhuratë të gjithëve. Nuk është fjala për rroba veshjeje, si atyre dy palë krushqve të tjerë. Flisni, çfarë ju do zemra.

Në çast Gjon Duka me të vetët u zhdukën pa u parë se ku ishin dhe nga shkuan. Vezirit sa nuk i ra të fikët si kishte ndodhur një natë më parë.

- Ikën, se ata nuk kanë nevojë për asgjë, vezir i madh, - i tha Gjon Keta. - Meqë dashke të na bësh nga një dhuratë, unë e pranoj, por për vete nuk dua asgjë.
- Por për kë e do dhuratën, Gjon Keta, fol, se do të të japë çfarë të duash.
- Mbi lumë duhet ngritur një urë, sepse lumi ynë është i pakalueshëm në tri stinët e vitit me përjashtim të verës; e ka ndarë krahinë tonë të Ndërmale në dy pjesë.

Veziri e dinte sesa bënte një urë, ose e dinte afërsisht. Ai kërkoi arkëtarin e vet dhe i tha t'i mbushte Gjon Ketës dy palë duq me flori dhe t'ia jepte me vete.

- Nder e bujari paç në jetë, vezir i madh, - i tha Gjon Keta kur ngarkoi duqit me flori në kalë dhe në kalin tjetër, në atë të Drafë Bërdafit vuri nusen.
- Ju jeni pak, rruga është e gjatë dhe me rrezikqe, - i tha veziri i madh Gjon Ketës. - Keni nusen në kalë, por keni edhe floririn. T'ju çojmë deri në vend me ushtri.
- Nuk është nevoja, veziri i madh, - i tha Gjon Keta.

Sa tha ai këto fjalë, me mijëra dhe mijëra hije të bardha u vërdallisën bedenave të kështjellës, pastaj u duk se zbritën në tokë, por, në të vërtetë u shndërruan në një tufë resh të bardha dhe mërguan tutje, nga jugulindja, nga e kishin rrugën krushqit me nuse. Qindra dhe mijëra shqipe mbas tyre u ngritën në qiellin e vjeshtës dhe e mbuluan atë duke zënë edhe dritën e diellit.

- Vezir i madh, është ushtria e Gjon Dukës, - i tha Gjon Keta. - Na detyrove të ngremë të vdekurit nga varret. Ata nuk vdesin dy herë.

Veziri i madh e kuptoi se ishte fjala për pritën që kishte bërë plan për t'u ngritur.

- Dua të të kem mik për jetë, mik për kokë, o Gjon Keta. Pashain e kam mik me vashën që i dhashë, ty dua të të kem mik shpirti.
- Do të më kesh,- i tha Gjon Keta dhe u nis bashkë me nuse.

Veziri i madh hipi në bedenat e kështjellës dhe vështroi poshtë në luginë, nga mori rrugën Gjon Keta me nuse. Pelerinat e bardha ecnin në dy kollona vargmaleve, në të dyja anët e rrugës që kishin marrë krushqit.

- Zot , o Zot, - tha me vete veziri i madh. - Kështu krushqish nuk më kishin parë sytë dhe mos më pafshin.

Gjon Keta ia çoi nusen pashait dhe nuk deshi përshëndetje, dhurata dhe lavdërime prej tij. Nuk ndejti për të pirë as kafen. Shkoi te lumi dhe po mendonte se ku duhej bërë ura mbi të. Thirri tre ustallarë ndërmalas. Ndërtimi i urës filloi me një qershor të vitit …mbaroi në qershorin e katërt. Nuk deshi ti vërë urës emrin e vetë, por të fisit. Edhe sot e kësaj dite ajo qëndron në këmbë e patundur, dhe ka emrin Ura e Ketës.

(Marrë nga libri "Dasma me 300 nuse".

Shënime për librin me kujtime të Enver Kaloshit



"Amanetin s'e tret dheu..."

"Amaneti" është shumëplanësh. Heronjtë vijnë si të gjallë. Vërshojnë kujtimet si gurra. Vijnë porositë si sentenca. Rreth zemra e Kaloshëve si vite.

Nga: **HAMIT VATA**

Qyteti i madh llamburit nga rrezet e diellit vjeshtor. Qëndron në kullë të burrave, pak i lodhur nga një rrugë e gjatë, ndjek lajmet në radio: sapo kanë përcjellë Leka Zogun në banesën e fundme e Sabri Godo paska ndërruar jetë...

I mbyll sytë pa dashur. S'fle. As dremis. Rrezet e diellit në "kullë të burrave" më zgjojnë kujtimet. Një nga një. 20 vjet më parë. Njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy.

Të shoh me sytë e mendjes e të shpirtit, Enver, o vëlla si sot. Flokë bardhë. Trupdrejtë. Sy dritë. Ballë e faqe brazduar. Gojë mjaltë. Shpresëdhënës. Largpamës. Vizionar...

Enver, vëlla, kurrë s'më ke dëgjuar të flas për moshë. Dhe sot, edhe pse po flas e shkruaj për të gjithë për rrudha e për thinja, s'e kam aspak për vitet! Dashuria , mirësia, zemërbardhësia, trimëria, bujaria, burrëria i superon vitet. As pyet për to. Varret s'janë frigoriferë mishi. Varret vetëm kockat kërkojnë. Mishi është kontigjent i tjetërkujt...

E kush mund të thotë se u plakëm, sa kohë që deshëm, duam, jetuam, jetojmë, qëndruam, qëndrojmë, besuam, besojmë, luftuam, luftojmë, shkruam, shkruajmë?

Ti në karriken e drejtorit të Arsimit, unë përballë teje duke qarë një hall jo të vogël. Ti me ballë e faqe të brazduar nga malhallet e sytë, pasqyrë e shpirtit, ndjekin e me të mijtat e sekondës rrokun thelbin e bisedës dhe po aq shpejt gjen shtegun e shpresës.

Heshtje s'ka aspak. Heshtja s'ka për të gjetur asnjë grimë vend bosh midis meje dhe asnjë plasë, asnjë veshtajkë, asnjë hije. Dashuria e pamasë u vulos një herë e përgjithmonë, u saldua me dritë rrufeje.

Dhe dashuria njerëzore moshë s'ka.

Ti do të jesh aty përherë, dimër e verë, trup drejtë këmbëshpejtë, mendjemprehtë, gjaknxehtë.

Heshtja s'ka për të gjetur vend tek ne asnjë plasë.

Këtu do të jemi unë e ti përherë!

Dhe midis nesh – vëllazëria e pamasë. Në të gjitha stinët. Dimër e verë...

Sapo ishte përmbysur sistemi i egër dikatorial kur ju njoha. Ju kishit e keni aq hire, aq mirësi sa më afrohet Alfred Uçi në vite e më thotë, bukuria shpirtërore qëndron mbi çdo bukuri tjetër, përjashto ato të vogëlushëve faqepjeshkë e sydritë... Fjalët e tua tingëllojnë hyjnore. Vështrimi i syve të tu të pastër, si t'i doje: me dritë rrufeje e me mjaltë hojesh...

Njëzet vjet pa ndryshime. Sot e gjithmonë dritë rrufeje e mjaltë hojesh.

Ndërsa zemra – xhenet mbi dhe: E madhe, e bardhë, e kuqe.

Mendja e Enver Kaloshit: E ndritur, krijuese, vetëtitëse, e madhe.

Feksin mendimet si drita e agimit, ndizen planet me vullnetin, durimin e përsosmërinë e bletës punëtore, realizon ëndrrat me kujdesin e Miçurinit, gëzon frytet e punës me qetësinë e prindit që sheh shtëpinë katund, fëmijët burra, nipat e mbesat si qinqa të butë e keca të harlisur dhe sytë të tradhtojnë një çast... me dy pika lot të nxehtë.

Koha ka hedhur paprerë mbi trupin, mendjen e shpirtin tënd rrufe, po t'i vëlla me to, si Dine Hoxha i ke prapsur "ëmbëlsisht".

S'di pse më kujton Plakun Balë të Gavril Darës së ri që na paraqet trimat dhe bujarët e "Kohës së madhe", punët e shkëlqyera të tyre, si një pasqyrë, ku vërehen nipërit e mbesat, që të ndizen me trimëri për të mbrojtur nderin pa u ligështuar dhe pa e shtrembëruar këmbën nga udha e madhe e prindërve.

U ngule në Fushë-Krujë dhe "themelove" katundin e Kaloshëve, pa harruar Sinën e shtrenjtë e të bukur...

S'është rastësi që plot miq e shokë publicistë e shkrimtarë, historianë e kritikë arti të e uruan atë maj të 2008-ës në Muzeun Historik kur u promovua libri "Qëndresa": - Suksese në bëma të tjera të mëdha, Enver Kaloshi. Ushtoi salla atë ditë nga zëri, Abdi Baletës, Nderim Kupit, Sulë Xhixhës, Astrit Kosturit, Bajrtam Xhafës, Mevlud Bucit, Beqir Ajazit e të tjerëve, duke vënë në dukje vlerat e atij libri, prodhimi shpirti e mendje.

Kështu që s'befasohet kurkush sot kur merr në dorë librin tënd të dytë "Amanet" me atë titull aq mbresëlënës e sinjifaktiv.

Amanetin s'e tret dheu, se ai është një gjë që i përket dikujt për ta ruajtur e për t'u kujdesur për të, është ajo porosi që duhet realizuar pa derman, që lihet me gojë a me shkrim para vdekjes.

Amaneti i babës!

Kam pas nderin dhe obligimin e madh kur më është besuar redaktimi i librave të Enver Kaloshit. I kam ndjekur hap pas hapi ecurinë e tyre.

E pohoj me plot gojën: "Amanet" – libri i dytë i Enver Kaloshit është një arritje e lavdërueshme.

Një libër brilant. Një him i vërtetë për Kaloshët e Shqipërisë. Një himn i merituar për një pjesë të familjeve të mëdha të Dibrës, të Matit e të Lumës që kuptohet prej gjithkuj se kanë pas peshë në historinë e Shqipërisë.

Kështu edhe "Amaneti" Enver Kaloshi. S'është bërë muaji që doli libri dhe s'kanë vonuar vlerësimet. Dikush vë në pah qëllimin e mirë të autorit, të tjerë theksojnë vërtetësinë e fakteve të bazuar në arkiva e dokumente, dikush shton origjinalitetin e interpretimit të fakteve, për ngjarje e figura, të cilat ose janë lënë në heshtje, ose janë denigruar e poshtëruar me qëllim 50 vjet.

"Amaneti" është shumëplanësh. Heronjtë vijnë si të gjallë. Vërshojnë kujtimet si gurra. Vijnë porositë si sentenca. Rreth zemra e Kaloshëve si vite.

Derdhet shpirti i tyre i pastër qelibar. Përjetësohen figura në këtë vepër ndonëse ata, heronjtë e kanë çimentuar jetën e tyre, me kohë e me vakt.

Një ndihmë tepër të madhe për "Amanetin" kanë dhënë dorëshkrimet e Mehmet Kaloshit, që janë kocka dhe palca e librit. Këto dorëshkrime i kanë imponuar autorit edhe kompozicionin edhe personat veprues. Kjo duket lehtë sapo të nisësh të shfletosh faqet e para.

I gjithë libri paraqet një gërshetim të mrekullueshëm elementësh e mjetesh letrare artistike, të shkrira në mënyrë të natyrshme, pa artificialitete, në një tërësi organike të harmonishme. Shpalosen në këtë libër përshkrime të gjalla betejash, peizazhe, portrete, analiza të holla psikologjike. Gjuha është e pasur, e figurshme, e gjallë, shumë shprehëse. Ka në këtë libër krijime të vërteta, ku vërshon një lirizëm i shëndetshëm, i hollë. Shkasin faqe të tëra të një proze të vërtetë poetike,"Sina ime", "Në Kodër-Saraj", "Gati rob lufte", "Jeta në arrati", "Burgjet e mia", "Llan Destani – kurrorë burrërie", "Poshtë Sulltani – rroftë Hasani", "Një figurë madhore e kombit shqiptar", "Dine Hoxha – mal mençurie e trimërie", "O rroni me nder, o vdisni me lavdi", "Heroina e Korabit", "Tragjedi me shumë akte", "Isufi dhe Leonela", "Jemi shqiptarë" janë vetëm disa kapituj të këtij libri të rrallë.

Në faqen 342 "Mbi rrasën e varrit të Babë Mehmetit midis të tjertave shkruhet:

"Dua ta gdhend shtatoren tënde me daltë
Në mermer të pastër nga Guri i Kuq
Dua të ta shoh trupin e thatë e të artë
Trup e shpirt t'i dua, o virtytmadh pa një huq!

Ndonëse vargjet i atribuohen të atit, Mehmet Kaloshit, ato përcjellin mesazhe nderimi për të gjithë heronjtë e librit dhe për të tjerët që s'munden të përfshiheshin në këtë volum. Enver Kaloshi është një qenie e rrallë dhe ka në dorë, në mendje dhe në shpirt ide e vepra të tjera. Dhe kur vendos Enver Kaloshi diçka, e realizon pa tjetër. Gjithë jeta e tij është prova më e pakundërshtueshme.

Dy fjalë për fotografitë dhe kopertinën. Bujar Karoshi ka punuar me dashuri dhe profesionalizëm.

S'është befasi Muzeu i Skënderbeut në Sinë, as katër vargjet e Neki Kalasë:

Para nesh – hordhitë e huaja
Prapa jush – votrat tuaja
prapa jush – gjithë Atdheu
Kështu foli Skënderbeu.



***Email:* info@devadesign.net.** ***Phone:* 612 203 5960.** **www.devadesign.net**

"Elez Isufi, mor ku je..."



Nga: **NAIM PLAKU**

Në fillimin e shek. XIX shkëlqeu si një meteor në qiellin e Shqipërisë një figurë pak e njohur, thuajse enigmatike, një emër i ri, që nisi të ndriçojë shpejt në rrugën e lavdisë dhe shpejt u ngrit e u lartësua në pjedestalin e lirisë, një njeri i thjeshtë që s'kishte kapërcyer ende pragun e krahinës së tij, një bari dhish që nuhaste me një dhunti të pazakontë e natyrale zhvillimet politike të kohës, një Garibald i tokës shqiptare, që shpejt mori përmasa legjendare në trojet e tij. Ky hero-legjendë i Dibrës kreshnike ishte Elez Isufi (Ndreu), bir i një familjeje të zakonshme fshatare që i kishte rrënjët atyje, në Malin e Dardhës trime, njërin prej Nëntë Maleve të saj, që tashmë ishin bërë të njohur në histori. Babai i tij Isufi me të shoqen Zahiden nga fshati Lugje, kishin ngarkuar ato pak plaçka dhe me fëmijët e vegjël në krahë kishin kaluar Drinin dhe ishin vendosur në Lisivalle, një vend pak i njohur më parë dhe aty, mbi një kodër piktoreske që e kishte njerin sy në majën e Korabit dhe tjetrën në Drinin e Zi, kishin ndërtuar një shtëpi përdhese që shumë shpejt do të bëhej një kullë e bardhë dhe e lartë trekatshe, një fortesë e pamposhtur në qëndresën vigane antisërbe dhe një karakoll nga buroi më pas lavdia e trimëria e brezave, që tamam si ajo rrëkeza e vogël e shiut duke ecur e kaluar mal mbi mal shndrrohet në një lum të vrullshëm e të stuhishëm që rrëmben lëmishte e kalbësira dhe hap rrugën e vet për t'u derdhur në ujëra të qeta e të kulluara. Babai dhe nëna u gëzoheshin fëmijëve të urtë e të mirë e plot shëndet që po rriteshin aty mes pyllit e luleve, në lëndinat e bukura duke dëgjuar këngët e lashta të Drinit dhe melodité e ëmbla të fyellit që përcillnin bjeshkët e Korabit. Dhe kështu, siç e deshi i madhi Zot, u rritën e u burrëruan djemtë Xhelili, Elezi dhe Hazizi. Xhelili vdiq i ri, por la pas Suf Xhelilin, krahun e djathtë të Elez Isufit, po aq madhështor sa mixha (xhaxhai) i tij, që duke ecur në gjurmët e lavdisë e të heroizmit, populli me të drejtë do t'i quante:

Shqipja e Ndreut me dy krahë,
Me dy krahë e za bilbili:
-Ban hoxhum, o Elez-aga,
-Besë-a-besë!-thotë,- Sufë Xhelili!

Të bëjsh portretin fizik të këtij luftëtari, duhet të kesh talentin e Rembrandit që balli i tij të ketë shkëqimin e agimeve të dritës, që sytë e tij të shohin gjer në thellësitë e oqeaneve, që gjoksi t'u ngjajë shkëmbenjve të maleve tona, që duart e tij të jenë mbërthyer fort në kondakun e pushkës dhe gishtin ta ketë prej çeliku, që këmbët e tij t'u ngjajnë atyre të drerëve që ngjiten lartësive, që trupi i tij të jetë i lartë sa qielli dhe i rëndë sa toka. Dhe këto që thuhen për të nuk janë hiperbola poetësh, por realitete të lindura në flakadane betejash e zulma luftërash.

Mjerë ata që e njohin shumë pak këtë burrë!

Të përshkruajsh jetën e tij duhet të kesh memorien e Homerit dhe penën e Shekspirit që ta paraqesësh ashtu si ishte: të matur në kulme dëshpërimi, të heshtur e hijerëndë në rrethana të vështira, i duruar deri në dhimbje dhe i ashpër deri në vetëmohim. E njihte armikun që me vështrimin e parë dhe e fitonte mikun që kur shkelte te pragu i shtëpisë, fjalëpak në kuvende burrash e punëshumë në mejdane trimërie; për të nuk kishte kthim prapa, vdiste aty ku lidhej besa, ta kuptonte qëllimin sa të hapje gojën, dhe kur hapte gojën aty ngulte kufirin.

Mjerë historia që ka mbyllur një sy e një vesh!

Besoj se janë atavizma të një uni gjenetik parabolat dhe diagrama e jetës së tij. Të jesh anafabet e të luftosh aq shumë për shkollë, dije e dituri; të jesh i pashkollë e t'u mësosh të shkolluarve artin e të shkruarit, të jesh i pashëtitur dhe të njohësh botën tejendanë, të jesh bari dhish e të japësh kulturë të foluri diplomatik; nga një fshatar i thjeshtë të ngrihesh në lartësitë e një udhëheqësi vigan, nga çoban të bëhesh strateg luftërash e nga ndjenjat e dashurisë për vatanin të frymëzohesh për të mbaruar vepra heroike, është, padyshim, një mrekulli e zbritur nga qielli.

Lavdi Zotit, që e pajise kështu këtë burrë!

Elez Isufi ishte shembulli më i mirë i një udhëheqësi popullor, të cilin ai e dëgjonte dhe vepronte me dashuri të veçantë për të zbatuar këshillat e tij. Janë bërë proverbiale shumë thënie të tij. Një thirrje, ishte kushtrim lufte . Ajo ngrinte më këmbë **"shtatë e m'shtatëdhjetë",** mobilizonte në luftë burra e gra, ngrinte nga gjumi fëmijët dhe i niste në beteja, lartësonte bajrakun e fitores aty ku gjëmonte thirrja e tij, grumbullonte rreth vetes qindra luftëtarë të gatshëmm për t'u hedhur në zjarr e flakë.

-Ka thënë Elez Isufi, hoxhum, o burra!

Nuk ra kurrë në kurthin e intrigave dhe nuk u bashkua asnjëherë me asnjë për përfitime personale dhe në dëm të interesave kombëtare. Miq e shokë të tij ishin nga figurat më të ndritura të kombit që nga Bajram Curri, Isa Boletini e Hasan Prishtina e gjer tek Vehbi Dibra e Ismail Strazimiri.As nuk u shit e as nuk u ble nga asnjë pushtet e politikan, nuk u gënjye e as u bë pishman për asjë arsye, nuk u thye e as gënjye nga sulmi i tradhtisë e as u step kurrë nga kurthi i djallëzisë. Armiku e donte të vdekur, populli e bëri të pavdekshëm. Gjithkush e donte dhe e mbronte, të tërë i besonin dhe e nderonin. Nuk pati frikë nga kthetrat e varfërisë e as e verbonte shkëlqimi i floririt. Mësojeni, pra, veprën e tij, bëmat e tij! Janë, vërtet, madhështore.

Mjerë politika, sa qorre është!

Hyri në skenën e historisë si dalëzotës dhe mbojtës i vullnetshëm, trim e besnik i pasurive të Rekës nga grabitësit, kusarët e hajdutët, të liqtë e hajnat. Këtu fitoi besimin e madh, se gjëja e lënë në besën e tij është e sigurtë .

U pagëzua në zjarrin e betejave, së pari, me ushtarët turq të cilët e patën fillimisht çaush, por, kur i njohu mirë, u vuri pushkën dhe i përzuri i pari nga vatani. Qe flakadani dhe zëri i kulluar i lirisë, që ndezi me guxim kryengritjen e përgatitur në Kosovë më 1912 dhe doli në mal me qytetarët e Dibrës së Madhe. Shpartalloi disa njësi të garnizoneve turke duke u marrë atyre armatimin dhe dy topa që u përdorën me aq sukses kundra mësymjes sërbe në betejën e famshme të Kolosnjanit, se:

Na ka shkelë hasmim te dera!

Elez Isufi u bë korifeu i qëndresës popullore në epopenë e luftrave 9-vjeçare kundër një armiku nga më të tërbuarit e më mizorët i shqiptarëve. Shkriu gjithë pasurinë e tij për interesat kombëtare. U dogjën tri herë kullat e tij, u internua dhe u burgos familja e tij, u përgjakën burrat e konakut të tij, por ai nuk u thye, as u gunjëzua, as u përkul. Përkundrazi, historia do ta lartësojë hakmarrjen vigane, të paparë në llojin e vet dhe armiku do ta ruajë në shekuj si një relikë të zezë në kujtesë të brezave duke shkruar mbi një vazo që mban brenda skeletin e një koke viktime: **"Mos e harroni kurrë Kodrën e Kaushit"!**

Tri herë u dogjën dhe u bënë hi fshatra të tërë, u martirizuan e u masakruan burra e gra, vdiqën në rrugët e vështira të gjenocidit sërb qindra burra, gra, e fëmijë. U kosit si bari i njomë djalëria dibrane.

Mjerë arkivat që i mbajnë të mbyllura fletët e këtyre ngjarjeve të mëdha!

Katër muaj me rradhë në dimrin e egër të vitit 1921 qëndroi në shi e në borë në malet e Lurës me malësorët besnikë të Reç-e-Dardhës dhe të mbarë Dibrës duke treguar një trimëri të jashtëzakonshme në mbrojtje të vatanit dhe nuk i lejuan sërbët të kalojnë kufirin.

Elez Isufi u dekorua për merita të vecanta lufte nga perandori i Austro-Hungarisë Franc Jozefi me titullin e lartë **"Franc Jozef-Orden".** Në mjediset e pallatit perandorak kishte vënë këmbët me baltë mbi qilimat persianë të salloneve aristokrate këtë rradhë një njeri krejt i veçantë, një malësor me rroba shajaku, kësulë të bardhë, tirq të bardhë e kuparane të zezë, me opinga lëkure, por me një zemër të madhe e një mendje të ndritur që ia kishin zili dhe perandorët me njëqind tituj e grada e të fundosur në kolltuqe të artë. I thotë Perandorit, duke iu drejtuar përkthyesit që mos t'ia ndryshojë llafet në komunikim, se shqiptarët janë vrarë me turqit, se ai u kishte kërkuar nizamë e taksa; ishte vrarë me sërbin se kishte kërkuar të bëhej zot shtëpie e të mblidhte taksa e ushtarë e se kështu do të vritej me të gjithë ata që janë të këtij soji. Kështu i kishte thënë dikur dhe dikujt tjetër që kishte provuar t'i thoshte Plakut të Çuditshëm të ndrronte mendje e të ulte armët, por ai e kishte pasur përgjigjen në majë të gjuhës:

-Mirë thue ti, or mik, por unë jam një Elez. Ç'tu baj atyne njiqind Elezave të tjerë që ka Dibra?!

Elez Isufi ishte i idhët për këdo që shkel në të drejtën e liritë e tjetrit, për të gjithë ata që tradhtojnë idealet e lirisë, për këdo që vihet në shërbim të hasmit, e, sidomos, të hasmit të vjetër. Ai ishte mik për kokë me atë që luftonte për liri e drejtësi, për nder të vatanit e jo me ata që binin në prehër të dushmanit. Këtë qëndrim mbajti tërë jetën. Nuk u pajtua as me Zogun. Në Lëvizjen e Marsit, që ndonjë historian i mefshët e dritëshkurtër, nga ata që kujtojnë se historia është petull me ujë të ftohtë ose një tufë tjetër politikanësh që nuk shikojnë më larg se hija e trupit të tyre, këtë Lëvizje, që ndërmorën forcat më demokratike të kohës, duan ta quajnë një grusht shteti. Elez Isufi hyri në Tiranë vetëm me 500 burra dibranë, as për pushtet e as për lavdi dhe i struku në qylarët e qelbura pushtetarët faqezinj të kombit. Këtë e bëri që t'i siguronte popullit zgjedhje demokratike, atë gjë që i ishte premtuar sa e sa herë se do ta bënte Asambleja e përgjithshshme, ***"e të caktohet fati i popullit të ngratë",*** si shkruan në kujtimet e tij Ismail Strazimiri.

Lëvizja e Marsit dhe revolucioni i Qershorit, sidomos, fundi i tij, qe shumë zhgënjyes për Plakun e nderuar., sidomos ndaj një pjese të parisë dibrane e asaj kombëtare që i patën dhënë besën dhe e tradhtuan, bile i mbushën pushkën dorës tinëzare dhe vranë më 16 dhjetor 1924 nipin e tij e bashkëluftëtarin e trim Sufë Xhelilin dhe plagosën për vdekje Elez Isufin që do të ndrronte jetë dy javë më vonë më 30 dhjetor 1924. Vdekja e tij e kobshme u kthye në një mort për mbarë popullin e Dibrës e të Lumës dhe tërë miqve të shumtë që kishte në mbarë vendin. Vdekja e tij qe kaq madhështore sa e shpreh fare qartë dhe kjo antitezë e fuqishme që hyri në mes dy kampeve: njërit që mbante zi e qante e tjetrit që pinte raki e këndonte. Në Sllovë ku Mide Doda vajtonte kreshnikun e maleve:

Elez Isufi, vllau jem, o vlla,
O yll i karvanit, vllau jem, o vlla,
Kreu i mejdanit, vllau jem o vlla!

...diku në Dibër të Madhe ushtarët sërbë ia kishin shtruar me raki e meze dhe kërcenin e këndonin duke kujtuar të kaluarën:

Kush don ta njohë se ç'është tmerri
Le t'i bjerë në këmbë Kaushit të Elezit!
Ah, moj nënë atje,
Dhe bari i njomë digjet nën këmbë...
(Koj sakat do videt teshki gubitak
Nekai zverzhi uder protif Eleza Kaush,
Moja majka i suve trava
Je goreno pad moje mogi).

Vrasjen e Elez Isufit dhe veprën e tij populli do ta përjetësonte në dhjetëra këngë dhe koha do ta qëndiste në kornizën e portretit të tij sintezën e mendimit lapidar:**"Punova për Komb e Atdhe"**

Populli do ta quante Elez-a, megjithëse nuk ishte aga, teprina e parisë dibrane, Plaku i randë i maleve, shqipja e Korabit, e të tjera epitete. Shtypi i kohës u tregua i pakursyer për të dhënë vlerësimet e tij, si kurrë ndonjëherë për ndonjë figurë tjetër: Plaku i famshëm, filozofi me kësulë të bardhë, mendimtari i madh, diplomati i pashkollë, gjenerali me shajak, kreshniku i maleve të Dibrës, ballina e kombit, atdhetari i flaktë, njeri me cilësi të mbinatyrshme, e qindra vlerësime të tjera. Figura e Elez Isufit është vlerësuar në çdo kohë, se mali nuk mbulohet me kashtë e dielli nuk zihet me shoshë. Por politika e të gjitha ngjyrave, nuk dimë pse mban dicka të frikshme brenda saj, ndrojtjen për t'i dhënë vendin që meriton, titullin më të lartë "Nderi i Kombit", ndërkohë që me këtë titull po vlerësohen shumë të tjerë që nuk e kanë as peshën e as rëndësinë e veprës së tij.

Në 150 vjetorin e lindjes së tij ne e kujtojmë me respekt jetën dhe veprën e këtij patrioti të madh, e këtij atdhetari të flaktë, e këtij flakadani të lirisë që frymëzoi breza të tërë luftëtarësh për çeshtjen e madhe të Kombit.







Një libër homazh, një homazh i përbashkët

Ashtu si një vit më parë kur di branët u mblodhën të gjithë tok në Teatrin e Operas dhe Baletit për të festuar 70 vjetorin e poetit të këngës popullore Naim Plaku, edhe sivjet në prag të festës së vitit të ri përsëri bashkë u mblodhën dibranët, dhe përsëri Naimi ishte ai që i bashkoi në një takim të tillë.Ky ishte një takim disi i veçantë, ashtu siç ishte dhe vetë libri, i veçantë: "Trëndafila mbi mermer" që u promovua më datën 17 nëntor në lokalin e Sadik Çerës tek Ura e Kamzës sipas një montazhi letraro-muzikor. Në sfond një monitor i madh ku herë pas here shfaqeshin portretet e personazheve të librit.Në fund të çdo portreti nga një epitaf. Në atë sallë të improvizuar një dhimbje e përbashkët. Moderatorja e këtij montazhi, Ejona Merhadi nuk e pati dhe aq të lehtë kur shikonte nga salla sy të përlotur, koka të ulura poshtë e një heshtje e plotë si prej varri. E gjeti më së fundi zgjidhjen, e gjeti bukur. Do të ftonte në fillim këngëtarin vyrtuoz Qerim Sula që me këngën e heroit tonë kombëtar Skënderbeu po dhe kjo me tekst të Naim Plakut do ta ngrinte këtë spektator disi të veçantë në këmbë .Jo vetëm kaq por zëri i fuqishëm thirri dhe të tjerë nga rruga, udhëtar të ndryshëm që u mbërthyen pas dritareve të lokalit.Të gjithë u çliruan nga ai makth disi i madh që i kishte mbërthyer, u çlirua dhe vetë moderatorja e tashmë montazhi letraro-muzikor kishte filluar. Një grup vajzash nga shkolla e mesme"Elez Isufi" Bathore kishin ardhur për të recituar vargje nga ky libër mbushur plot me vargje të përmallshme.

Vetë autori që në faqen e parë të librit do të shprehet: "Me respekt e përmallim përulem në kujtim të këtyre martirëve duke vënë vargjet e mia modeste mbi varret e bijve dhe bijave të vendit tim, që sosën rininë e vështirë të mbuluar me mallin përvëlues të prindërve të tyre, të nënave e motrave shamizeza, atyre që derdhën lot të nxehtë mbi këta trëndafila të heshtur që çelin e lulëzojnë ritmikisht në tabanin e kujtimeve tona" Ky nuk ishte thjeshtë një promovim libri por ishte dhe një përkujtimore, një përkujtimore e përbashkët, një homazh që u bë për djemtë e vajzat, burrave e grave, të afërme tanë,farefisit, miqve e shokëve që kanë ndërruar jetë në rrethana të ndryshme, por që kanë lënë mes nesh mallin e pashuar, kanë lënë një vend bosh në vatrat tona, një lugë bosh në sofrat tona, një ndjenjë të fortë pikëllimi, një këngë vaji mes këngëve tona të gëzuara. Sa bukur shprehet vetë autori në parathënjen e këtij libri disi të veçantë nga botimet që kanë dalë deri tani: " Kam parë pleq e plaka duke qëndruar pranë bijve e bijave të tyre, që, për të lehtësuar ngashërimet e ngushjtet, i nxitnin të qajnë ca, të nxirrnin mëllefin, se kështu do t'u lehtësoheshin sadopak dhimbjet.Se loti shërohet me lot! Këto vargje, vërtet, janë të përlotur, por them me sinqeritet, se në atë pellg të madh dhimbjesh e lotësh, janë dhe lotët e mi"

Të gjitha poezitë e librit më të ri të Naim Plakut pothuaj se janë bërë këngë nga përkujdesja e të afërmëve për ta mbajtur gjithmonë të freskët kujtimin e tyre dhe sidomos për t'ua përcjellë brezave që vijnë. Dhe këngët, dhe poezitë e përmallshme u recituan, dhe fjalët e mallit dhe dhimbjes u thanë të gjitha. Sot ky promovim libri, kjo përkujtimore, ky homazh të përbashkët nuk duhet të kthehet në një ditë vaji, por në një ditë respekti e krenarie, duke treguar se kujtimi i tyre rron. Rron dhe frymëzon, se në të vërtetë vdekja e tyre ka qenë heroike në kuptimin e mirëfiltë të fjalës.Se heroike është dhe vetë jeta e tyre. Dhe në këtë sallë të mbushur plot për plot me nëna shamizeza e pleq të plakur para kohe nuk kishte nevojë për shumë fjalime dhe kumtesa. Vazhdoi gjatë ky montazh muziko-letrar, afro tre orë . Dhe moderatorja nuk mund t'i qëndronte strikt programit, herë herë u ngritën nga salla dhe floën, folën shumë e të gjithë dhe pse me lot në sy përshëndetën Naim Plakun që me këtë libër i bëri të pavdekshëm djemtë dhe vajzat e tyre. Këngëtari Qerim Sula në fjalën e tij tha:" Naim Plaku është dhe do mbetet për shumë kohë një penë e artë. Ne këngëtarët që sot jemi bërë të njohur jo vetëm në skenat tona por dhe jashtë vendit, na ka bërë pena e artë e Naim Plakut.i urojmë jetë të gjatë e kurrë mos iu ndryshkët pena". Folën shumë, folën e thanë urimet më të mira për Naim plakun; foli e përshëndeti Hysen Çera, foli Halil Palushi, babai i Gramoz Palushit që u vra për flamurin tonë në Greqi, foli vajza e Shaqir Nokës, foli Qemal Doda, nipi i Baftjar Dodës, kompozitori Xhelil Imeri, Dr. Fejzulla Gjabri, mbesa e Selim Hysës Sedije Hysa e plot të tjerë. Përsëri këngë nga Sherif Dervishi, Arif Madana, përsëri Qerim Sula. Duartrokitje të gjata por dhe ndonjë pikë loti i ngrohtë rrëshqiste tinëz nëpër faqe.Kjo ishte e pranishme dhe askush nuk i shpëtoi dot se kjo përkujtimore, ky homazh ishte i përbashkët për të gjithë. Edhe dhimbja u nda mes të gjithë të pranishmëve.Në fund një foto me Naimin, një autograf në libër një shtërngim duarsh dhe urimi i të gjithëve dhe pse me sy të përlotur ishte:"Faleminderit Naim Plaku, na i ngjalle sot njerëzit të dashur që humbën jetën në moshën më të bukur, na e lehtësove dhimbjen,Do mbetesh i pranishëm, miku më i rëndësishëm, njeriu më i domosdoshëm në familjet tona!

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Refleksione

Bekuar qofsh o Naim Plaku...



Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Nuk e di kush tundi djepin tënd duke të thirrur NAIM... Bekuar qoftë! Si Naimi i "Maleve... lisave të gjatë... pyjeve... gërxheve... të Shqipërisë...". Më ngrohe me udhëtimin tënd me penë e me shpirt maleve të Katër Grykëve të Murrës, liqeneve të bukur të Kacnisë, liqene që ndoshta jam i pari që i kam fiksuar në celuloid, liqene që për mua janë më të bukur se Liqenet e Lurës. Një mbi një, ulur në prehrin e njeri tjetrin, në atë zbritje të butë, zbritje poetike të natyrës, pamje që të futet në shpirt e të mbetet tërë jetën kur ngjitesh në kreshtën malore prej nga njëra anë merr në dorë e në shpirt ikonën e pyjeve të Pratit dhe bjeshkët e Lukanit dhe Qafë Murrës e nga ana tjetër kap e nuk e lëshon prej dore pamjen që varet maleve të Balgjajt për të zbritur e notuar mbi lumin, e më poshtë mbi Liqenin e Matit...

Nuk po udhëtoj gjatë atyre maleve, nuk po ulem në ballkonin e bukur natyror të Manazdrenit, lagje e Qafë Murrës, nuk po fus dorën në galeri të marr një gurë kromi nga ajo që quhej dikur "Miniera e Selishtës", nuk po ngjitem në Qafën e Lukanjakëve për të zbritur në bjeshkën e Pllajit e as po marr rrugën këmbësore pyllit të thanave për të dalë në Krue të Zi e për të zbritur në Bulaç e Sinë, në vendlindjen e Gjergjit tonë të madh, Mbretit të Shqiptarëve...

Po ndalem. Një pikë loti mori teposhtën e rrudhave të moshës. Nuk e mbaj dot lotin e mallit për ato vende që ma kanë mbushur jetën me gaz e hare.

Plaku e ke mbiemrin dhe PLAK i fjalës së urtë dibrane je. Kam një libër tuajin në emigracion, në Athinë ku jam i ngujuar prej pesëmbëdhjetë vjetësh, librin "Po të mos ishte Drini". Ngrohem me fjalën tuaj kur është ftohtë, çmallem me Drinin, kur më merr malli...

Hyra në të thella. Mos më ven faj. Më ka marrë malli e nuk çmallem dot.

Në udhëtimin tënd Katër Grykëve të Murrës ishe ndalë në Lunarë, atje ku ujërat bëjnë shtrungë, shtrungë që një njeri i dashuruar me dritën, që i buron në shpirt, kërkon ta mjelë e ta shndërrojë në rrymë elektrike.

Kam një dobësi për dritën elektrike, dritë që rrjedh (siç rrjedh qumështi) nga shtrungat ku njerëzit me dije e kulturë mbledhin ujërat që nga ato të vijave ujitëse e deri tek ato të gjoleve të madhësive të ndryshme. Dobësia është e lidhur me një ngjarje në kapërcim të fëmijërisë sime, është e lidhur me vjeshtën e vitit 1955 kur sapo kisha kaluar katërmbëdhjetë vjet të jetës...

...Shtëpia e prindërve të mi është në krye të fshatit të Brezhdan-Zdojanit dhe në fund të mëhallës së Ashikëve. Në fund të ogrades, atje ku Brezhdani të vjen në pëllëmbë të dorës e fusha e Çapit me deltën e gjerë të Drinit të Zi ta mbush shpirtin me bukurinë e papërsëritshme, kishim një vresht, një vresht në një teposhte që po nuk u mbajte mirë rrokulliseshe si ortek dëbore. Në krye të vreshtit u hap një gropë e thellë, gropë që thurur me mur guri dhe e veshur me çimento formoi atë që e quajtën "hauz", emër i cili edhe sot e kësaj dite ka mbetur si toponim, si një emër që vjen larg, shumë larg në kohë. Hauzi u lidh me një kanal të thellë deri tek "Mulliri i Sadullit" dhe me një tub çeliku teposhtës së thepisur. Një godinë e thjeshtë, brezi i parë me gurë dhe dy brezat e tjerë me plita, mblodhën brenda vetes një turbinë dhe një gjenerator. Telat elektrikë u shpërndanë në të gjithë fshatin, që nga Bunçet, e Xharret deri tek Reçet në lagjen e Zdojanit. Hidrocentrali me llamba 110 voltësh u dha dritë të treqind shtëpive të Brezhdanit dhe Zdojanit...

Ishte me të vërtet një gjë e madhe, dritë elektrike fryt i punës vullnetare të fshatarëve që kërkonin një jetë të re, kërkonin dritë. Asokohe ende nuk ishte krijuar kooperativa bujqësore.

Drita solli radiot, solli një garë të vërtetë për të mbushur shtëpitë me atë aparat të çuditshëm që "fliste dhe këndonte". Ndodhi që fshatarët shitën bagëti e katandi

të reja

Duke reflektuar rreth librit "Të parën kemi Dibrën" të autorit Velo Cfarku



Një monument publicistik për Dibrën dhe dibranët

Nga **Dukagjin HATA**

Isha ende djalosh, njëzetvjeçar plot ëndrra dhe pasione, kur para tridhjetë vitesh kam takuar për herë të parë një burrë, që më ka bërë përshtypje për energjinë, gjallërinë, besimin në atë që bënte, performancën e bukur që dinte të ruante, në një kohë të devijimit dhe shëmtimit të shumëçkaje. Ky burrë, atëherë ende i ri dhe i bukur (edhe sot në moshën shtatëdhjetë e gjashtëvjeçare i ruan gjurmët e tipareve të dikurshme), quhej Velo Cfarku dhe ishte kryeredaktori i gazetës lokale të Dibrës "Ushtima e maleve".

Takimi me njerëz të shtypit dhe atyre mediave të kufizuara të kohës nuk ishte një takim i zakonshëm, me njerëz të zakonshëm. Gazetarët aso kohe kishin një fuqi dhe sharm që mund të krahasohet vetëm me atë të atyre që sot quhen vipa, veçse me një ndryshim: fjala vip sot ka pësuar një keqpërdorim deri në devijim, ndërsa fjala gazetar dikur ishte identike me atë që përshkruhet në përcaktimin e saj, në fjalorin e gjuhës shqipe.

Veloja të bënte menjëherë për vete me thjeshtësinë, inteligjencën, talentin, kudesin që tregonte ndaj atyre që e rrethonin, afësinë për të dëgjuar me vëmendje dhe për të zhvilluar një bisedë të mençur e produktive. Kur e kam takuar tani pas shumë kohësh, kam vënë re se kalimi I viteve jo vetëm nuk ia ka zbehur, por ia ka nxjerrë më në pah këto cilësi.

Të botoje në atë kohë në gazetë ishte vërtet një gjë e madhe, të dukej sikur para teje hapeshin dyert e një bote të panjohur dhe të priste fati i Hirushes. Meqë unë isha mashkull dhe nuk prisja ndonjë princ të kaltër, (princeshat ishte bërë lanet me kohë dhe nuk guxonte kush t'i zinte në gojë), botimi në atë gazetë modeste, por që kishte aq shumë kreativitet në atë kohë të pa kohë, ishte sigurisht më shumë se një sadifaksion, ishte një lloj çelsi për të shkuar tek ëndrra. Një nga ata që ma e ushqeu ëndrrën, duke më nxitur të shkruaja dhe të botoja, ishte miku im i vjetër, mësuesi dhe gazetari pasionant, Velo Cfarku.

Njohjen me Velo Cfarkun, këtë burrë të gjindshëm, që i buronte mirësi në çdo pore të lëkurës, e konsideroj me të vërtetë një fat. Ai dinte të gjente gjuhën e përbashkët me kolegët dhe bashkëpunëtorët, dinte të ndizte zjarre shprese edhe aty ku hiri përpëlitej në agoni, teksa shuante thëngjijt e fundit…

Gazeta "Ushtima e maleve", gjatë kohës që e ka drejtuar Velo Cfarku, për rreth njëzet e pesë vjet, ka përcjellë një tirazh prej rreth 9 milion kopje, ku kanë lëvizur qinra mijëra emra, mjedise, personazhe, problematika, duke u bërë kështu – pavarësisht kufizimeve të kohës- një tribunë e mendimit dibran, në kërkim të shtigjeve të lirisë dhe drejtësisë shoqërore.

Takimi me të pas kaq vitesh ishte një takim virtual, takim në librari, ku janë renditur tre librat e tij publicistikë dhe ku lëviz një jetë e gjallë njerëzore, lëvizin kohët, mjediset, iluzionet, qarkullon limfa e mendimit të lirë të një epoke tjetër. Takimet e tjera në kafene nuk ishin gjë tjetër veçse një fillim miqsie, pas një shkëputje të gjatë.

Të gjitha këto I solla ndërmend, teksa shfletoja librin etij të ri "Të parën kemi Dibrën". Cilido lexues, veçanërisht gazetarët dhe bashkëpunëtorët e shumtë të shtypit periodik të dikurshëm, sapo të përfundojnë së lexuari këtë libër të gazetarit veteran dhe ish kryeredaktorit të gazetës "Ushtima e Maleve" Velo Cfarku, do të meditonte pë atë kujtesë që nuk shuhet, por kthehet në trajtë rrëfimi të ngjeshur dhe mbresëlënës për të tjerët, do të ndjente një soj detyrimi që të shkruante qoftë edhe pak radhë.

Kjo, sepse vetë tematika dhe problematika që ai rrok në shkrimet e tij, në idetë, qëndrimet dhe refleksionet që përcjell, tregojnë një nivel të spikatur gazetaresk, një sens realizmi të thellë, një zhbirim pikologjik e psiko-analitik të kohëve dhe personazheve që bën objekt trajtimi, për vetë përmbajtjen ku ndërthuret mjeshtërisht subjekti, rrëfimi dhe qëndrimi ndaj asaj që rrëfen, gjetjet e personazheve dhe trajtimi i problemeve, ku lexuesi ia del të rrokë thellësitë e jetës që ai na ofron, kohën, dibranët, fisnikërinë e njerëzve të thjeshtë, përkushtimin, bujarinë, shpirtin human në shtigjet e vështira të jetës e të kohës.

Ky libër i veçantë letrar-publicistik është një vështrim, retrospektiv, harmonik jo vetëm për Gollobordën, jo vetëm për Dibrën, por për trevat e veriut në përgjithësi, ku autorit i ka rastisur që të shkelë, për shkak të punës së tij si gazetar dhe drejtues shtypi, në kërkim të "lëndës së parë" të shkrimeve, mbresave dhe impresioneve gazetareske.

Velo Cfarku është një figurë e njohur në lëmin e publicistikës shqiptare, me një kontribut të spikatur në qëmtimin dhe vlersimin jo vetëm të historisë së Gollobordës, trevë prej nga vjen dhe të Dibrës, që e ka mbartur me vete si një gur sizifian, por të gjithë hapësirave etnike shqiptare, gjurmë të jetës dhe të bëmave të së cilave gjen në shkrimet dhe librat e tij.

Në kohën kur realiteti gazetaresk, më shumë se tek e vërteta, bazohej tek trilli dhe fantazia ilustrative, për të qenë në rregull me parimet e kohës, zëra të vërtetë publicistikë si ai i Velo Cfarkut, tregonin se kishte ardhur koha për ndryshim dhe se nuk mund të vazhdohej më me shtampa dhe formula steriotipe, jashtë realiteve të trishta që nënshkruante koha e pa kohë.

Libri i fundit që Cfarku ka hedhur në qarkullim ka një titull domethënës e kuptimplotë dhe shpreh botëformimin etnopsikik, shpirtëror dhe etnokulturor të autorit. Siç e thamë libri titullohet "Të parën kemi Dibrën", ku autori bën një udhëtim retrospektiv midis njerëzve, mjediseve, ngjarjeve dhe bëmave historike, por dhe të përditshmërisë, duke evidentuar pasurinë e madhe të botës së njerëzve të thjeshtë dhe të burrave të mençur të odave të Dibrës.

Duke sjellë portrete njerëzish që autori ka njohur në rrugën e tij gazetaresske, gjatë një pune të gjatë dhe plot pasion, copëza jete, vëzhgime dhe impresione të gjalla, Velo Cfarku na komunikon filozofinë e mbijeteës shpirtërore në male, kodet dhe zakonet e një treve si Dibra, që ka shkëlqyer në të gjitha kohët për sharmin e odës së burrave, mençurinë dhe prakticitetin e njerëzve, që nuk jeton thjeshtë për vete, por mbi të gjitha për vallen e shokëve, miqve dhe armiqve, që i rrethojnë, pra për të tjerët.

Në libër parakalojnë figura të njohura të kulturës, artit, sportit, odës së burrave të Dibrës, punëtorë, muratorë, njerëz të të gjitha shtresave dhe niveleve kulturore, të cilët i bashkon në libër filozofia e dashurisë për të bukurën, për progresin ekonomik, social dhe kulturologjik të kësaj treve kaq të përndezur nga shkëlqimi i urtësisë vitalitetit.

Autori bashkon në një rrëfim vertikal dhe retrospektiv mbresat dhe impresionet personale me të dëgjuarat nga të tjerët, portretin me vëzhgimin e hollë, refleskionin me analizën e goditur psiko-sociale, replikën me shijen e përzgjedhur dhe plot delikatesë të pikmentit letrar, me të cilin spërkat fjalët, fjalitë, frazat dhe shkrimet e tij.

"Të parën kemi Dibrën" është një libër i shkruar me një stilt ë përpunuar dhe me kolorit të pasur gjuhësor, pa fjalë të huaja dhe artifice, me një gjuhë të gjallë e të zhdërvjellët, pa zbulkurime dhe pa retorikë.

Autori bazohet në fakte të njohura historike apo të konfirmuara me gojë brez pas brezi, nga mbresat dhe kujtimet vetjake gjatë punës në terren si gazetar dhe drejtues gazete, nga vlerësimet e të tjerëve për pasurinë etnopsikike dhe etnokulturore të trevës së Dibrës, por dhe të trevave të tjera, ku shëtit kamera e tij vëzhguese dhe interpretuese.

Libri lexohet me një frymë dhe përbën një kontribut në publicistikën shqiptare, e cila ka nevojë të përthithë sa më shumë elemente nga mozaiku i spikatur i traditës, sidomos në vlerësimin e dukurive të aktualitetit tonë problematik.

---

vetëm për të blerë radio...

...Vitet rrodhën. Hidrocentrali punoi deri nga fundi i viteve '60-të kur u elektrifikua fshati tash me rrymë 220 volt.

Nuk ishte vetëm Brezhdani që ndërtoi hidrocentral në ato vite. Shumë fshatra që nga Golloborda e deri në Lurë ndërtuan hidrocentrale të vegjël, hidrocentrale që ndriçuan diku një fshat, diku dy fshatra e diku një lagje fshati.

Nuk po vazhdoj më tej me "dashurinë për dritën", dashuri që duhet të shkruhet e dokumentohet si vlerë jetësore dhe kulturore e dibranit në rrugën e vet të ngjitjes.

Nuk do të shkruaj as për hidrocentralet e vegjël, hidrocentrale që në vitet '80-të jepnin aq energji elektrike (diku 15 milionë kilovat-orë) të mjaftueshme (siç thuhej atëherë) për ti dhënë dritë të gjithë Dibrës (me përjashtim të minierës së Bulqizës). Nuk do të shkruaj (sepse kam shkruar disa herë) as për studimin e një grupi specialistësh të hidroenergjetikes që llogarisnin se po të ndërtohen hidrocentrale mbi kanalet ujitëse dhe mbi ujësjellësin e Korabit, energjia e përftuar shkonte në 220 milionë kilovat-orë, energji e mjaftueshme që e gjithë Dibra të gatuante dhe ngrohej me korrent.

Nisur nga këto, nga pasuria e pallogaritshme e energjisë elektrike që i vjen Dibrës nga shfrytëzimi i burimeve ujore të larta, të degëve të Drinit dhe të vijave ujitëse, kundërshtova publikisht politikën zyrtare (të djathtë e të majtë) për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, për mbytjen dhe shuarjen e Luginës së Dibrës, lugina më e madhe, më e bukur dhe më pjellore e maleve të Shqipërisë. Dhe kjo vetëm e vetëm që mos përmbytej Shkodra. Shyqyr që këto ditë dhjetori nuk është përmbytur Shkodra sepse me siguri do të rikthehej përsëri në faqet e para të gazetave "Skavica".

Mendimet e mia modeste i kam publikuar në disa gazeta, në gazetën "Rruga e Arbërit" dhe në librin tim "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!"...

Këto i nderuar Naim i bluajta imtë në "mullirin" e mallit dhe dashurisë tek më more e më çove me shkrimin tënd në hidrocentralin në ndërtim të Selishtës, tek bekoje "Dritën e Bardhë" tek uroje me shpirt "Dalsh faqebardhë o Ramazan Biba!", tek flisje me dashuri dhe respekt për punën e një inxhinieri të palodhur si Ramiz Plaku, tek ilustroje me fotografi atë që është bërë.

Bekuar qofsh or Naim Plaku. Bekuar për shkrimin, bekuar për penën, bekuar për dashurinë që përcjell për Dibrën...

Kisha kohë që nuk kisha lexuar një reportazh kaq jetësorë, kaq me dashuri.

Faleminderit!

Athinë, 20 dhjetor 2011

Reklamoni biznesin tuaj!

GAZETA "RRUGA E ARBËRIT"
VË NË DISPOZICION
HAPËSIRAT E NEVOJSHME
PËR REKLAMËN TUAJ!

Tel: **(04) 22 33 283**

Email: **rrugaearberit@gmail.com**

homazh

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes

Kur na mungon një mik fisnik

Vdekja e një njeriu krijon një boshllek për familjën, të afërmit, shokët por edhe për komunitetin ku ai kaluar një pjesë të mirë të jetës. Për të mbushur këto boshllëqe duhen kohe sipas kontributeve dhe vlerave që krijojnë njerëzit me punën e veprimtarinë e tyre shoqërore dhe familjare. Skënder Sulejman Cani ishte një prei burrav fisnik dhe me emër të mirë në Grykën e Madhe. Lindi më 1927 në një familje patriotike e të dëgjuar për bujari, besë e trimëri në Sofraçan. Gjyshi i tij Jakup Cani ka një kontribut të veçantë në historinë e Dibrës në luftën për liri e pavarësi për krah Mersim Demës, në kryengitjet e viteve 1910-1912. Shpesh herë shërbente edhe si përkthyes midis krerëve patriot të Dibrës me të dërguarit e Perandorisë Osmane në fundin e shekullit 19 dhe fillimet e shek 20. Përkrahu pa rezerva periudhën për demokratizimin e vendit përkrah Elez Isufit, Ramiz Dacit, Mehmet Duricit, Dan Camit, Halit Lleshit dhe Ramiz Alliut. Po kështu edhe babai I tij Sulejmani gjithë jetën e tij të shkurtër ia kushtoi atdheut për konsolidimin e pamvarsisë. Skënderi, mësimet e para i mori në shkollën e Zerqanit dhe Homeshit për të përfunduar në vitin 1942 Internatin e Kastriotit. Si fshat Sofraçani ka qenë një arenë lufte midis partizanëeve dhe pushtuesve të vendit italo-gjermanë. Më 17 korrik 1944 gjermanët dogjën fshatin dhe vranë 7 veta mes të cilëve dhe xhaxhai i Skenderit, Ramadan Cani (sot dëshmor i luftës NACL). Edhe pse në moshë të re Skënderi së bashku me vëllain e tij Shaqirin ndihmuan luftën. Ditën e sulmit të gjermanëve Skënderi dërgoi një një partizan të plagosur në Teqen e Bllacës me porosi të Këshillit Nacional-çlirimtar, duke njoftuar edhe shtabin partizan (Dali Ndreu) për pasojat e luftës në fshat, ndërsa Shaqiri ishte në mal me partizanët. Pas tre ditësh fshatin e gjetën të djegur e të braktisur. Tashmë duhet të punonin për zhdukjen e pasojave të luftës, për fillimin e jetës nga e para fillimisht duke ngritur një shtepi të re duke lënë kështu trojet e vjetra. Pas mbarimit të luftës Shaqiri filloi punë në Durrës e më pas në parkun e Sarandës si shofer. Dënohet me vdekje për sabotim.Kjo i krijoi probleme të mëdha familjes Cani të rrënuar nga lufta. Megjithëse i ri Skënderi nuk humbi shpresat për vëllain i cili për fat i shpëtoi pushkatimit dhe pas dy vjetësh lirohet nga burgu i Gjirokastrës. Përsëri rifillimi i jetës, Shaqiri sistemohet me punë në Ndërmarrjen Gjeologjike Bulqizë, ndërsa Skënderi me ndihmën e Qamil Dishës u sistemua ne punë në Ndërmarrjen e Grumbullimit Shupenzë si shef plani, në vitet 1962 -64 kryetar i Kooperativës Bujqësore Sopot dhe përsëri Përgjegjës i Agjensisë së Grumbullimit derisa doli në pension e vitin1986. Skënder Cani ishte pamburrje një nënpunës fisnik, shembull në sjellje, në shoqëri në fshat e kudo. I thjeshtë, i heshtur, i qetë, i përmbajtur e me zemër të madhe e i aftë profesionalisht. Ai krijoi një experiencë mjaft të dobishme në marrëdhënie me vartësit, kolegët eprorët për zgjidhjen e halleve të qytetarëve. Të gjithë ata që e njohën ndonëse nuk kishin lidhje apo marrëdhënie pune të flasin me admirim e me respekt për Skënder Canin. Familja që krijoi nga martesa (me Xhemile Xhafer Pashën nga Peladhia) ruajti dhe pasuroi traditën e origjinës bujare e patriotike të familjes. Ajo priti e përcolli me dashuri shumë udhëtar, shokë, miq dashamirës me zemër pa lodhje, me kohë pa kohë, në ditë të mira e të vështira. Bashkë rritën 7 fëmijë duke vënë në plan të parë shkollën. Ata u bënë inxhinierë, ekonomistë e mësues të dalluar në punë e në rrethet shoqërore dhe familjare. Vazhdimisht kjo familje është shquar për unitet dhe është marrë si shembull i mirë në Grykën e Madhe. Këtë dëshironin edhe për të tjerët në fshat dhe qytet. Këto virtyte i trashëguan dhe fëmijet e tyre. Në çdo kohë midis vëllezërve e motrave shfaqet dashuria, respekti e vllazëria në jetën e përditshme duke treguar fisnikërinë e prindërve. Pikërisht për këto vlera ndjejmë boshllëkun dhe mungesën e këtyre njerëzve të rëndësishëm gjithmonë midis nesh. Nga familja prej 3 vetash në 1940 sot familja numëron 55 antarë së bashku me nipërit dhe mbesat. Kanë mbaruar arsimin e lartë 37 dhe vahzdojnë 6 të tjerë. Me arsim të mesëm 8; inxhinierë 8, ekonomistë 14, gjuhë e huaj 4, artet 3, mjekësi 8, diplomac 1, mesuesi 6. Me 28 dhjetor 2010 ndahet nga jeta ky njeri fisnik. Shpeshherë shprehte kënaqësinë se brezat pas tij u shkolluan dhe u bënë më të zotët dhe më të vlefshëm për shoqërinë, dëshirë dhe objektiv i gjithe gjysheve dhe prindërve tanë. Të tillë njerëz do të kujtohen brez pas brezi nga fëmijët, të afërmit dhe bashkohësit të tij.



Skënder Sulejman Cani

Shaqir SKARRA

Respekt dhe mirënjohje për Bashkim Beqirin



Para pak ditësh u nda nga jeta Bashkim Beqiri.Lindi në Sllatinë në një familje patriotike e atdhetare. I ati i tij, mësuesi veteran Hajdar Beqiri ishte nip i Isuf Xhelilit. Jo vetëm familja e tij por dhe si fis shquhen si njerëz puntor, të ndershëm, korrekt në marrëdhënjet njerëzore. Bashkimi u shkollua për elektronikë në Politeknikumin "7 nëntori", sot Instituti "Harry Fultz" dhe punoi për vite me radhë pranë ndërmarjes së Postë-Telekomunikacionit Peshkopi dhe shumë vite në Sllatinë, Sllovë e Shumbat. U shqua vazhdimisht jo vetëm për aftësi e kompetencë profesionale, por edhe përkushtimin ndaj punës, cilësinë e shërbimit dhe administrimin me korektesë të vlerave materiale e monetare që administronte. Me të njëjtin përkushtim punoi edhe në Tiranë ku banoi vitet e fundit familjarisht. Krijoj një familje shembullore, që padyshim do ruajnë e kultivojnë traditat e prindërve. Vdekja e parakohshme hidhëroi jo vetëm motrat, bashkëshorten, vëllanë e fëmijët por edhe ne miqtë e shokët e tij që punuam e jetuam gjatë me të. Bashkim Beqiri la pas kujtimin e një jete shembullore me vlera që meriton vetëm respekt e mirënjohje.

Halil Robi

Dhjetë vjet pa njeriun tonë të mirë Halit Miklin



Në këto ditë të ftohta dhjetori, kur i vetëm po meditoja për vitet që kisha kaluar mes miqve e shokëve fare rastësisht m'u shfaq dhe një portret njerëzor, portreti i mikut dhe shokut tim të mirë Halit Mikli. Kanë kaluar dhjetë vjet që atëherë që është ndarë fizikisht nga jeta por ja sot mu shfaq i gjallë në kujtesën time, si ato vite ma parë kur djalë i ri e gjithë energji ishte i pari në sektorët më të vështirë dhe gjithmonë i papërtuar.Jemi rritur bashkë me Halitin, jemi nga i njëjti fshat(Muhurr) e ndaj kujtimet për të janë të shumta e kujtesa ime krejt padashur rrodhi në ato vite të hershme të moshës më të bukur që kishim unë, Haliti dhe mjaft shokë e miq tanë.Sot kanë kaluar dhjet vjet, dhjetë vjet që jemi ndarë me mikun dhe shokun tonë Halit Mikli. Dhjetë vjet nuk i thonë pak por për ne që punuam e jetuam me të, që ndamë të mirën dhe të keqen si i thonë fjalës na duket sikur e kemi ende pranë me atë buzëqeshjen karakteristike. Sot në këtë përvjetor na mungon shumë, na mungon jo vetëm Haliti por dhe këshillat e tij prej njeriu të mirë, vërejtjet dhe sugjerimet.Na mungon çdo gjë e mirë nga vyrtytet e sjelljet që kishte mes miqve e shokëve. Megjithatë ai në kujtesën tonë është e do mbetet gjithmonë pranë nesh.Kudo ndodhet midis nesh Halit Mikli.E sot në këtë përvjetor jo vetëm për fëmijët e tij, të afërmit por dhe për ne miq e shokë që punuam bashkë në ditë të vështira e kujtojmë me mall e respekt njeriun e mirë Halit Mikli. Ai lindi dhe u rrit në një familje të mirë, patriote e atdhetare të Muhurrit. Haliti edhe pse mbeti jetim në moshë të vogël u rrit në një mjedis të ngrohtë familjarë, nga përkujdesja e vazhdueshme e Islam Miklit, një emër ky vërtet i njohur jo vetëm në Muhurr por dhe në Dibër. Kështu që Halitit i ra fati që të futej herët në odën dibrane, të përfitonte shumë prej saj dhe ato që mori nga kjo shkollë e Dibrës i vuri në jetë në të gjithë sektorët e ndryshëm duke punuar me sakrifica të mëdha e ndershmëri të lartë. Haliti lindi dhe rriti plot 14 fëmijë.Jo pak për atë periudhë kohe por tek sejcili ushqeu dashurinë dhe respektin për njerëzit e në veçanti për më të mëdhenjtë, vyrtyte që këto ende i kanë fëmijët e Halitit. Një familje e madhe e me fëmijë të vegjël por në shtëpi kishte rregull dhe disiplinë se këto vyrtyte të mira i kishte skalitur vetë Haliti tek fëmijët e tij. Vonë kur fëmijët u rritën, u martuan dhe krijuan familjet e tyre Haliti krijoj një kompleks të madh shtëpish të reja e të bukura, tamam si një mini lagje qyteti, me pemë e lule të shumta. Por në kohën që duhej të jetonte e të gëzonte bashkë me fëmijët e tij, vjen dhe një moment që Halit Mikli në moshën 60 vjeçare ndahet nga jeta, ndahet në një moshë që kishte më shumë forca dhe energji për të dhënë për fëmijët e tij tashmë të rritur e të martuar. Megjithëse kanë kaluar dhjetë vjet që atëherë mbahet mend jo vetëm në Muhurr por dhe më gjërë. Nuk kishte ndodhur më parë që një pjesëmarrje prej mbi pesë mijë veta të mblidheshin bashkë për t'i dhënë lamtumirën e fundit, mikut, shokut, vëllait e prindit shembullor Halit Mikli. Erdhën nga ana e anës njerëz të ndryshëm në varrimin e tij, të njohur e panjohur. I tillë ishte dhe mbeti Halit Mikli, njeriu që i deshi njerëzit por dhe e deshën atë.

RUSTEM DEVA

Biblioteka e autorëve dibranë*







Këto dhe shumë botime të tjera të autorëve dibranë mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B"

Adresa: Rruga "Zenel Baboci", Pall. Ferar, Tiranë (Pranë Selvisë)
Tel. 00355 4 22 33 283.
Cel. 069 20 68 603
e-mail: mbbotime@gmail.com

* Janë reklamuar vetëm botimet që mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B"

-20%

cyan magenta yellow black

NË TREG KALENDARI

Dibra 2012

© "M&B" Botime dhe Studio Grafike.

Ideja dhe realizimi:
Miranda Goleci, Bujar Karoshi, Hysen Uka.

Për botimin ndihmuan:
Adam Kirk, Hajredin Toca, Defrim Methasani, Ismail Keta, Bashkim Lleshi, Doran Delia, Medi Koxhaj.

Nëse dëshironi të siguroni një kopje të kalendarit "Dibra 2012", mund të kontaktoni:
Në Tiranë, tel: (04) 22 33 283.
Në Peshkopi, tel: - 0218 - 4233
ose email: **mbbotime@gmail.com**

vetëm 250 lekë

cyan magenta yellow black